

UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU”
FAKULTETI I BIZNESIT



KËRKIM MBI EFEKTIN SINERGJIK TË METABOLIZMIT RAJONAL - NË PERFORMANCËN EKONOMIKE TË VENDIT

Në kërkim të gradës “**Doktor i shkencave**”

Manjola DULI

Tiranë, 2016

KËRKIM MBI EFEKTIN SINERGJIK TË METABOLIZMIT RAJONAL - NË PERFORMANCËN EKONOMIKE TË VENDIT

Kandidati

Manjola DULI

Udhëheqësi

Prof. Dr Mit'hat Mema

DEKLARATA E AUTORËSISË

© Copyright, Manjola DULI, 2016

Përmbajtja e këtij punimi është krejtësisht autentike.

Unë, e nënshkruara Manjola DULI, deklaroj se kjo temë përfaqëson punimin tim original, përveç rasteve të citimeve dhe referencave, si dhe nuk është përdorur më parë në këtë universitet apo në universitete të tjera.

Mendimet e shprehura në këtë temë janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë ato të Universitetit “Aleksandër Moisiu”.

Manjola DULI

Tiranë, 2016

TABELA E PËRMBAJTJES

Deklarata e autorësisë	iii
Lista e tabelave	vii
Lista e figurave	viii
Lista e shkurtimeve	ix
Mirënjohe dhe Falenderime	x
ABSTRAKT	xi
Kreu 1 Prezantim me problemin dhe nevoja për studimin e thelluar	14
1.1 Identifikimi i problemit	14
1.2 Ngritja e hipotezës.....	16
1.3 Qëllimi dhe Objektivat.....	17
1.4 Pyetjet Kërkimore	18
Kreu 2 Rishikimi mbi literaturën e fushës	19
2.1 Rishikimi i literaturës bazë	19
2.2 Politikat e BE-së për zhvillimin rajonal	24
2.3 Organizimi në zona/rajone	26
2.3.1 Rajonet statistikore NUTS.....	27
2.3.2 Rajonet statistikore LAU	28
2.4 Politikat dhe nstrumentet në kontekstin e zhvillimit rajonal.....	29
2.5 instrumentat e rajonalizimit.....	37
Kreu 3 Metodat dhe procedurat e kërkimit	41
3.1 Analiza faktoriale – Metoda që evidenton faktorët.....	41
3.2 Besueshmëria e përgjigjeve të intervistuarve.....	49
3.3 Pyetësi.....	50
Kreu 4 Rezultate dhe interpretime	52
4.1 Profili makro i rajoneve.....	52
4.1.1 Popullsia.....	52
4.1.2 Varfëria.....	55
4.1.3 Numri i bizneseve sipas rajoneve	60
4.2 Njohja me situatën përmes Analizës përshkruese	61

4.2.1	Seksioni A: të përgjithshme	61
4.2.2	Seksioni B: Përfshirja e ekonomisë në strategjinë rajonale të zhvillimit	62
4.2.3	Seksioni C: Shkalla e përfshirjes së ekonomisë në strategjinë sektoriale	64
4.2.4	Seksioni D: Kufizimet për zhvillimin e brendshëm rajonal ekonomik	65
4.2.5	Seksioni E: Zona prioritare për rritje ekonomike rajonale	67
4.2.6	Seksioni F dhe G.....	68
4.2.7	Seksioni H: Koordinimi i strategjisë rajonale me strategjinë kombëtare	69
4.2.8	Seksioni I: Zhvillimin e dialogut.....	71
4.2.9	Seksioni J: Vështirësi të ndryshme	72
4.2.10	Seksioni K: Sektori ekonomik	74
4.2.11	Seksioni L: Përfshirja në produktet turistike potenciale	75
4.2.12	Seksioni M: Aktivitetet për të realizuar një potencial turizmi	76
4.2.13	Seksioni N dhe O: Zhvillimi i bujqësisë me kategoritë e saj.....	77
4.2.14	Seksioni P: Produktet kryesore të SME.....	78
4.2.15	Seksioni Q: Potenciali i burimeve natyrore për zhvillimin lokal.....	79
4.3	Diskutime mbi sektorët prioritar të qarqeve.....	81
4.4	Cronbach alpha – Besueshmëria	85
4.5	Analiza sipas baseneve ujore.....	87
4.5.1	Baseni ujq Drin-Bunë.....	88
4.5.2	Baseni ujq i Matit.....	90
4.5.3	Baseni ujq Ishëm-Erzen	93
4.5.4	Baseni ujq i Shkumbinit.....	96
4.5.5	Baseni ujq Seman-Vjosë.....	98
4.6	Përmbledhje mbi basenet ujore	102
Kreu 5	Përfundimet dhe Rekomandime	104
5.1	Përfundime	104
5.2	Rekomandime.....	105
Bibliografia		108
Aneksë		110
Pyetëson		110
Pamje online e pyetësonit		113
Analiza faktoriale – Baseni ujq Drin-Buna (1).....		114
Fakt.....		114
Pritja.....		115
Sektori i Bujqësisë		117
Analiza faktoriale – Baseni ujq i Matit (2).....		119

<i>Fakt</i>	119
<i>Pritja</i>	120
<i>Spektori i Bujqësisë</i>	122
Analiza faktoriale – Baseni uxor Ishëm-Erzen (3)	124
<i>Fakt</i>	124
<i>Pritja</i>	125
<i>Spektori i Industirisë/manifakturës</i>	126
Analiza faktoriale – Baseni uxor i Shkumbinit (4)	128
<i>Fakt</i>	128
<i>Pritja</i>	129
<i>Spektori i Bujqësisë</i>	131
Analiza faktoriale – Baseni uxor Seman-Vjosë (5)	133
<i>Fakt</i>	133
<i>Pritja</i>	134
<i>Spektori i Turizmit</i>	135
Aneks 2 Modele zhvillimit rajonal	133
<i>Rasti i Kroacisë</i>	133
<i>Rasti i Austrisë</i>	146

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Gjykimi mbi vlerat e koeficientit cronbach alpha.....	49
Tabela 2. Shpërndarja të anketuarve sipas gjinisë dhe pyetjes nëse punojnë në administratën publike	62
Tabela 3. Shpërndarja e përgjigjeve të pyetjes B2 sipas qarqeve	63
Tabela 4. Rezultatet për pyetjen C1 sipas qarqeve	65
Tabela 5. Rezultatet për pyetjen D8 sipas qarqeve	66
Tabela 6. Shpërndarja e përgjigjeve të pyetjes E1 sipas qarqeve	68
Tabela 7. Shpërndarja e përgjigjeve të pyetjes H0 sipas qarqeve.....	70
Tabela 8. Shpërndarja e përgjigjeve të pyetjes I0 sipas qarqeve	72
Tabela 9. Shpërndarja e përgjigjeve të pyetjes J0 sipas qarqeve	73
Tabela 10. Shpërndarja e përgjigjeve të pyetjes Q1 sipas qarqeve.....	81
Tabela 7. Paraqitja e zhvillimit të sektorit sipas qarqeve, pyetja: A ka rajoni juaj zona prioritare ndërhyrje të cilat janë parashikuar për rritje ekonomike rajonale?	82
Tabela 8. Paraqitja e zhvillimit të sektorëve sipas qarqeve, pyetja: Sa dakord jeni që sektorët e mëposhtëm t'i zhvilloni në NJA tuaj?	83
Tabela 9. Krahasimi i rezultateve të analizës faktoriale mes situatës fakt dhe asaj të pritura lidhur me sektorin prioritar të basenit ujqor Drin-Bunë.....	88
Tabela 14. Rezultatet e analizës faktoriale për sektorin e Bujqësisë për basenin ujqor Drin-Bunë	90
Tabela 15. Krahasimi i rezultateve të analizës faktoriale mes situatës fakt dhe asaj të pritura lidhur me sektorin prioritar të basenit ujqor të Matit	91
Tabela 16. Përmbledhja e rezultateve të analizës faktoriale për sektorin e Bujqësisë për basenin ujqor të Matit.....	92
Tabela 17. Krahasimi mes vlerave fakt dhe atyre të pritura lidhur me sektorin prioritar të basenit ujqor Ishëm-Erzen	94
Tabela 18. Përmbledhja e rezultateve të analizës faktoriale për sektorin e Industri/manufakturë për basenin ujqor Ishëm-Erzen	95
Tabela 19. Krahasimi mes vlerave fakt dhe atyre të pritura lidhur me sektorin prioritar të basenit ujqor të Shkumbinit.....	97
Tabela 20. Përmbledhja e rezultateve të analizës faktoriale për sektorin e Bujqësisë për basenin ujqor të Shkumbinit.....	97
Tabela 21. Krahasimi mes vlerave fakt dhe atyre të pritura lidhur me sektorin prioritar të basenit ujqor Seman-Vjosë	100
Tabela 22. Përmbledhja e rezultateve të analizës faktoriale për sektorin e Bujqësisë për basenin ujqor Seman-Vjosë	101

Tabela 23. Përmbledhja e rezultateve të analizës faktoriale për sektorin e Bujqësisë për basenin ujqor Drin-Bunë	102
--	-----

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Popullsia gjithsej sipas qarqeve për vitet 2001, 2010 dhe 2016.....	54
Figura 2. Popullsia urbane sipas qarqeve për vitet 2001, 2010 dhe 2016.....	54
Figura 3. Popullsia rurale sipas qarqeve për vitet 2001, 2010 dhe 2016	55
Figura 4. Raporti i varfërisë për frymë sipas rajonit (majtas) dhe komunë/bashki (djathtas) në Shqipëri për vitin 2004. Burimi: World Bank (2007).....	56
Figura 5. Paraqitja grafike e përqindjes së varfërisë sipas rajoneve dhe viteve. Burimi INSTAT (2014).....	57
Figura 6. Hendeku i varfërisë sipas zonave dhe viteve. Burimi: INSTAT (2014)	57
Figura 7. Ashpërsia e varfërisë sipas zonave dhe viteve. Burimi: INSTAT (2014)	58
Figura 8. Përqindjet ndaj totalit të konsumit real për frymë sipas rajoneve dhe viteve. Burimi: INSTAT (2014).....	59
Figura 9. Madhësia mesatare e familjes sipas rajoneve dhe viteve. Burimi: INSTAT (2014).	59
Figura 10. Treguesit e varfërisë sipas LSMS së INSTAT (2012) sipas qarqeve. Burimi: Ministria për Çështjet Vendore (2014).	60
Figura 11. Ndërmarrjet aktive sipas qarqeve, gjendje në fund të vitit 2014.....	61
Figura 12. Të intervistuarit sipas gjinisë së tyre	62
Figura 13. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit B.....	63
Figura 14. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas një pyetje të seksionit C.....	64
Figura 15. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit C.....	65
Figura 16. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit D.....	66
Figura 17. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit E	67
Figura 18. Paraqitja grafike e përgjigjeve për pyetjen: A ka njësi juaj një plan operacional të përcaktuar me aktivitete, buxhete për zonat e ndërhyrjes prioritare?	68
Figura 19. Paraqitja grafike e përgjigjeve për pyetjen: A ka patur ndikim kriza ekonomike në tregun e zhvillimit tuaj rajonal?	69
Figura 20. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit H.....	70
Figura 21. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit I	71
Figura 22. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit J	73
Figura 23. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit K.....	74
Figura 24. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit L	75
Figura 25. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit M.....	76
Figura 26. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit N.....	77
Figura 27. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit O.....	78
Figura 28. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit P	79
Figura 27. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit Q.....	80

LISTA E SHKURTIMEVE

BE – Bashkimi European
EUROSTAT – Zyra e Statistikave të Bashkimit European
PBB – Prodhimi i Brendshëm Bruto
HBS – Anketa e Buxhetit të Familjeve
FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSTAT – Instituti i Statistikës
NJQV – Njësi e Qeverisjes Vendore
PPK - Plani i Përgjithshëm Kombëtar
LSMS – Anketa e e Matjes së Nivelit të Jetesës
QKR– Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Biznesit
ZHR – Zhvillim Rajonal
FZHR- Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
NUTS- Nomenklaturë e Njësive Territoriale për Statistikat

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Falenderimet i shkojnë individëve dhe institucioneve të cilët kontribuan në realizimin e këtij punimi doktore.

Do të falenderoj, në mënyrë të veçantë udhëheqësin e temës Prof. Dr Mit'hat Mema, për mundësinë që më krijoi për udhëheqjen e kësaj teme.

Gjithashtu, falenderime shkojnë për Prof. Dr Kristaq Kume, i cili ka kontribuar, për rritjen cilësore të kërkimit në këtë temë.

Unë gjithashtu, do të doja të falenderoja Departamentin e Programit dhe Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave, për vendosjen në dispozicion të një sërë materialeve dhe informacionesh.

Një kontribut të shtuar në këtë punim kanë dhënë dhe përfaqësuesit e Njësive të Qeverisjes Vendore NJQV në plotësimin e të dhënave për pyetësit të shpërndarë në secilën NJQV.

ABSTRAKT

Kam kënaqësinë t'ju paraqes kërkimin e parë gjithëpërfshirës të modelit të sinergjisë rajonal në Shqipëri, bazuar në ndarjen territoriale sipas baseneve ujëmbledhëse. Pavarësisht se ka pasur analiza të shumta në kontekstin e zhvillimit rajonal dhe lokal të vendit, ato ose janë hartuar me qëllim ndërmarrjen e veprimeve specifike, ose janë përqendruar në disa aspekte të veçanta të sektorëve të zhvillimit.

Qëllimi kryesor i kësaj doktrature është të nxisë një diskutim publik të mbështetur në fakte dhe të dhëna bazuar në intervista dhe analiza sasiore/ cilësore për të kontribuar në hartimin e politikave të zhvillimit rajonal në Shqipëri. Nuk është e çuditshme që në fund të këtij procesi Shqipëria do të duhet të adaptojë, përfshijë dhe praktikojë parimet e politikës së kohezionit të Bashkimit Europian. Perceptimi evropian i kohezionit social-ekonomik ka evoluar gjatë viteve, dhe me kalimin e kohës këtij objektiv i janë përkushtuar gjithmonë e më shumë burime, ndërkohë që ka një fokus të qartë në zonat më pak të zhvilluara, të gjitha rajonet pritet që, duke treguar gjithmonë kujdes me burimet e tyre (mjedisin), të zhvillojnë një ekonomi të qëndrueshme dhe eficiente në burime, të bazuar në njohuri dhe risi, duke nxitur kështu punësim të lartë (Strategjia “Europa 2020”).

Politika publike e zhvillimit rajonal në Shqipëri, është përballur me sfida themelore të tilla, si niveli i ulët i performancës së administratës lokale, strukturat ekonomike të vjetëruara në shumicën e rajoneve, cilësia e dobët e infrastrukturës, mungesa e vizionit për zhvillimin ekonomik sipas burimeve lokale, infrastruktura e pamjaftueshme mjedisore etj, zhvillimi jo i balancuar i faktorëve të mësipërm ka krijuar një zhvillim të disbalancuar rajonal, duke kufizuar mundësinë për përfshirje të qëndrueshme të rajoneve si pjesë e një ekonomie globalisht konkurruese. Politikat publike të zhvillimit, kohezionit rajonal në Shqipëri mund të kenë një qasje të mençur, duke kombinuar avantazhet e identifikuar dhe burimet e kufizuara rajonale në funksion të zhvillimit ekonomik kombëtar. Kjo nuk mund të bëhet ndryshe përveç se duke studiuar faktet, duke kuptuar modelet dhe rastet e dështimit apo suksesit të zhvillimit, dhe duke propozuar veprimet e duhura, që do të bazohen mbi konsensusin e grupeve të shumta të interesit, si dhe bazuar në analiza të mirefillta studimore.

Metabolizmi i zhvillimit rajonal është një çështje thelbësore ndërsektoriale me ndikim të drejtpërdrejtë në performancën ekonomike të një vendi. Ai përshkon të gjithë sektorët dhe aspektet e zhvillimit në një numër të dhënë territoresh. Qasja aktuale për zhvillimit rajonal në Shqipëri shprehet e paqartë ndërsa në Europë varet nga vendi, në të cilin kryhen analizat shumëdimensionale dhe zhvillohen strategji, politika në lidhje me faktorë mjedisorë dhe social-ekonomikë të përcaktuar sipas territorit.

Në këtë punim doktrature, është ndjekur gjerësisht qasje e cila bazohet duke vëzhguar dhe studiuar, ecurinë e të një grupi të gjerë treguesish zhvillimor në Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV). Si rezultat, janë paraqitur disa tipologji zhvillimore rajonale dhe rekomandime të përgjithshme në lidhje me zhvillimin e politikave publike të metabolizmit të zhvillimit rajonal, bazuar në gjashtë basene ujore.

Aktualisht metabolizmi i zhvillimit rajonal (lme fokus zhvillimin ekonomik) në Shqipëri nuk është i rregulluar nga një kuadër ligjor, ndërkohë që disa procese po planifikohen dhe zbatohen sipas instrumentit të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve (FZHR). Ligji mbi Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore përcakton se NJQV janë përgjegjëse për strategjitë e tyre të zhvillimit, fondet për financimin e bashkive vijnë nga taksat lokale (të ardhurat e veta) dhe transfertat nga buxheti qendror, një fakt i rëndësishëm me ndikim në zhvillimin rajonal paraqet dhe ekzistenca e një procesi të vazhdueshëm decentralizimi.

Përsa i përket nivelit të qeverisjes në Shqipëria ka dy të tilla: nivelin qendror dhe nivelin vendor. Në nivelin vendor dallohen 61 bashki sipas reformës territoriale të miratuar në vitin 2014, të cilat kategorizohen si njësi të nivelit të parë të qeverisjes vendore dhe qarqet, të cilat janë njësitë e nivelit të dytë të qeverisjes vendore dhe ku marrin jetë strategjitë rajonale. Strukturat që zgjidhen e votohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, gjenden dhe në nivelin qendror dhe atë lokal. Por, këshillat e qarqeve përbëhen nga përfaqësues të deleguar nga njësitë lokale të nivelit të parë. Territori shqiptar është i organizuar në 12 Qarqe dhe 61 Bashki. Nuk ka as rajone administrative dhe as rajone të vetëqeverisura në Shqipëri, që t'i korrespondojnë nivelit të klasifikimit NUTS 2¹. Qarqet janë ekuivalenti i nivelit NUTS 3.

Përveç analizës së situatës social-ekonomike rajonale, instrumentit të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve (FZHR), në këtë punim i përkushtohet një kapitull të veçantë si dhe modelit të zhvillimit rajonal të vendeve të BE-së. Meqënëse Shqipëria ndodhet në fazat e para të integritimit në Bashkimin Europian, është e qartë që nevojitet të zhvillohet një politikë e kohezionit të brendshëm social-ekonomik (e metabolizmit rajonal). Kjo mund të bëhet vetëm nëpërmjet studimeve të detajuara të situatës aktuale, prirjeve dhe modeleve mbizotëruese të zhvillimit, dhe për pasojë nëpërmjet një diskutimi të gjerë se si të stimulohen më mirë veprimet e zhvillimit rajonal.

Në këtë kontekst kjo temë doktorature, vjen si një studim krahasues në kontekstin e decentralizimit dhe rajonalizimit me politikat e vendeve të Europës, për analizimin e “praktikave më të mira” të testuara në “ekonomitë më të avancuara në tranzicion”, me qëllimin për të hapur një “dritare” të re njohurishë dhe mundësi për krijimin e modeleve të duhura, të qëndrueshme të politikës së ardhshme të fuqizimit ekonomik nëpërmjet rajonalizimit në Shqipëri.

Ky punim synon sigurimin e provave të besueshme për një diskutim të tillë, me qëllim përfshirjen e rezultateve në politikat publike me fokus kohezionin social dhe zhvillimin e ekonomisë. Aspektet e zhvillimit rajonal në këtë punim grupohen sipas dimensioneve të tyre të dallueshme sektoriale dhe paraqiten në kapitujt kryesor të mëposhtëm:

- Kapitulli 1: Përmbledhje. Prezantim me problemin duke përfshirë tipologjinë e rajoneve, si dhe ndikimet e përgjithshme në politika.
- Kapitulli 2: Rishikimi mbi literaturën, duke vlerësuar literaturën e huaj dhe të vendit
- Kapitulli 3: Metodologjia paraqitja dhe shpjegimi i qasjes analitike.

¹ Nomenklaturë e Njësive Territoriale për Statistikat; rajonet NUTS 2 referohen specifiku nga politika e kohezionit e BE-së

- Kapitulli 4: Rezultatet & Interpretimet, vlerësime të nxjerra nga analizimi i pyetësorëve. Hendeqet e sotme të zhvillimit dhe si dhe ndryshimet e parashtruara në të ardhmen analizohen në tri këndvështrime në nivel (NJQV, qarku, baseni ujëmbledhës), për të bërë më të kuptueshme sfidat kryesore në këto nivele të dallueshme krahasimi.

Po ashtu, për lehtësi referimi, në faqet e para të publikimit paraqiten tabela e përmbajtjes së lëndës, si edhe listat e tabelave, grafikëve dhe hartave për çdo tregues (indikator).

Qëllimi kryesor i punimit të kësaj doktorature është, të informojë politikbërsit në Shqipëri të cilët hartojnë strategji, akte ligjore, plane zhvillimi etj, rreth problemeve të zhvillimit rajonal në Shqipëri, si dhe zbulimet dhe vëzhgimet tona të përdoren për hartimin e një kornize politike gjithëpërfshirëse, të metabolizmit rajonal në funksion të performancës ekonomike të vendit .

KREU 1

PREZANTIM ME PROBLEMIN DHE NEVOJA PËR STUDIMIN E THELLUAR

1.1 IDENTIFIKIMI I PROBLEMIT

Megjithë zhvillimet, që ka marrë rajonalizimi me fokus fuqizimin ekonomik në Shqipëri, vihet re se, duke analizuar të dhënat statistikore të deritanishme ka progres në rritje, por përsëri niveli i ecursë produktive ekonomike që ka sjell kjo politikë në Shqipëri në krahasim me vendet e Europës është akoma i ulët.

De jure në Shqipëri, rajonalizimi ka paraqitur një ecuri në drejtim të mekanizmave, ndërsa praktikisht ekzistojnë vetëm instrumentat dhe jo politikat e mirfillta publike me fokus krijimin e sinergjise rajonale për një zhvillim ekonomik. Deri tani, vendi nuk ka zbatuar një politikë rajonale zhvillimi, Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal SNZHR (2007) fillimisht, trajtonte strukturën e nevojshme rajonale, planifikimin strategjik rajonal dhe proceset e manaxhimit, ndërkohë që mekanizmat financiarë u zhvilluan në mënyrë të pavarur nëpërmjet politikave fiskale (grantet konkurruese, që prej vitit 2010 nën Fondin e Zhvillimit Rajonal). Kjo strategji ashtu sic dhe draft Ligjin për zhvillimin rajonal, nuk u miratuan për t'u zbatuar .

Më tej, në 2009-2010 është realizuar një punë e rëndësishme, konkretisht: studim i pabarazive rajonale, përgatitja e një koncepti që sjell konvergjencë të politikave të brendshme dhe evropiane të Zhvillimit Rajonal (ZHR), dhe sidomos përgatitjet institucionale dhe programe për përcaktimin IPA III dhe NUTS II².

Megjithëse, në vitin 2014 u miratua reforma e re territoriale Ligj nr. 115/2014 datë 31.7.2014 Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë por fhe këtu vihet re se ka një mungesë të ndërlidhjes së zhvillimit rajonal dhe të decentralizimit , nuk janë analizuar dhe vlerësuar nga afër, dhe në të vërtetë, nuk ka një konsensus të politikbërësve se në çfarë niveli duhet aplikuar politika e zhvillimit rajonal. Një tjetër fakt kryesor është që integrimi në BE, që është një zgjedhje strategjike për Shqipërinë, do të kërkojë përshtatjen e parimeve dhe praktikave të politikave rajonale (të kohezionit) të BE-së, brenda kornizës politike të zhvillimit rajonal të vendit.

²Drafti “Regional Management in Albania” përgatitur nga Mr. Martin Ivancsics. Dhjetor 2014.

Aktualisht, në Shqipëri nuk ka një platformë të qartë dhe koherente për ZHR, dhe as institucione të qarta me rolet përkatëse të ZHR të përcaktuara mirë³. Shqipëria nuk ka kornizat ligjore, rregullatore dhe institucionale, as kapacitetin institucional dhe mekanizmat e financimit që ti i ngjajnë sistemit të sofistikuar të planifikimit të ZHR në vendet anëtare të BE-së. Ka vetëm një bazë ligjore të pjesshme që mund të formojnë një paketë të legjislacionit⁴, e cila mund të shërbejë si bazë për zhvillimin rajonal. Megjithatë, kjo bazë është jo e plotë dhe jo e qartë në orientimin e sinergjise rajonale.

Qasja e zhvillimit rajonal duke filluar nga viti 2010 e në vazhdim është orientuar kryesisht në bazë të prioriteteve që ka patur secila qeveri në përcaktimin e objektivave, të fokusit gjeografik, strategjisë, aktorëve dhe mjeteve për realizimin e objektivave. Më specifikisht, objektivat zhvillimor rajonal kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë në fokus ndërhyrjet sektoriale sipas nevojave të rajoneve, të përqëndruar jo në fuqizimin e potencialeve rajonale si element të zhvillimit ekonomik por në përmirësime fizike të pjesësme infrastrukture.

Aktualisht, vihet re një mungesë e lidhjes funksionale të përdorimit të rajonalizimit territorial në funksion të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar. Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) në Shqipëri janë të interesuara pak apo aspak për rritjen e fondeve lokale nga vetë njësitë, punohet nëpërmjet modelit të fondeve të cilat do të përmirësojnë transfertat bashkiake nëpërmjet granteve, sesa nëpërmjet bashkëpunimit rajonal me qëllim qëndrueshmërinë socio-ekonomike. Aktualisht ky lloj orientimi i NJQV sjell një zhvillim sporadik, të cinguar ekonomik rajona - kombëtar.

Ndërkohë që Shqipëria është në hapat e parë të një procesi ndryshimi në drejtim të zhvillimit rajonal dhe në pamje të parë duket sikur ka një rrugë të përcaktuar, por nga ana tjetër është vështirë të ndërtohet një sistem të qëndrueshëm socio – ekonomik rajonal, pa pasur një model të mirfilltë zhvillimi ekonomik rajonal të unifikuar në të gjitha qarqet të përcaktuar me ligj, pasi NJQV dhe Qeveria janë dy komponentët e nevojshëm që ky sistem të funksionojë.

Pushteti qëndror në Shqipëri ka tentuar ta ndryshojë situatën që në vitin 2000, me miratimin e ligjit të decentralizimit apo me miratimin e reformës territoriale viti 2014, por të dy komponentët e mësipërm ligjor, janë thjesht instrumenta të politikave dhe nuk kanë mundur të sjellin një model mirfilli për zhvillimi e qëndrueshëm ekonomik rajonal në Shqipëri. Megjithatë, eksperiencat e vendeve të BE na sjell një sër shembujsh pozitivë nga jashtë Shqipërisë si vendet Balltike apo Kroacia, të cilat kanë një infrastrukturë financiare dhe teknologjike më të zhvilluar se Shqipëria në kontekstin e zhvillimit ekonomik rajonal.⁵

Ky është një motiv shtytës, për analizimin e situatës të zhvillimit rajonal me fokus zhvillimin ekonomik në rajon, si dhe për dizejnimin e një modeli të shprehur fillimisht nëpërmjet sinergjis që krijohet ndërmjet rajoneve në funksion të fuqizimit ekonomik rajonal në Shqipëri.

Për momentin, ajo që kërkohet sot në Shqipëri është zhvillimi i një modeli të standarizuar për zhvillimin ekonomik rajonal, si dhe një debati i thellë dhe gjithëpërfshirës në lidhje me përfitimet nga zhvillimi rajonal i harmonizur. Ky debat mund të çojë në një ndryshim rrënjësor në këtë sektor dhe rrjedhimisht me përfitime ekonomike për shoqërinë tonë.

³Ibid faqe 6.

⁴ Disa nga ligjet dhe aktet nënligjore kryesore përfshijën: Kushtetuta e Shqipërisë, Ligji mbi qeverisjen vendore, Ligji mbi taksat lokale, Ligji mbi planifikimin territorial, Ligjet e Buxhetit dhe aktet nënligjore mbi ZHR, Akti nënligjor mbi shërbimet sociale/mbrojtjen, Ligji mbi shërbimet spitalore, Kodi rrugor dhe Ligji mbi mbrojtjen e mjedisit.

⁵ Pjesë e aneksit nr 2

1.2 NGRITJA E HIPOTEZËS

Sinergjia e zhvillimi rajonal, në kontekstin e politikës së zhvillimit ekonomik në Shqipëri ka qenë dhe mbetet një çështje e rëndësishme e për zhvillimin social – ekonomik në vend.

Ky punim doktriture fokusohet në situatën aktuale të zhvillimit sektorial rajonal, kombinuar me analizën e faktorëve ekonomikë e socialë që sigurojnë shkëputjen e shoqërive të sotme nga stadi i prapambetjes drejt përparimit ekonomik dhe barazisë shoqërore përkrah me vendet e zhvilluara. Studime të tilla janë shumë aktuale në kushtet e sotme të zhvillimit të ekonomisë, sidomos në kontekstin shqiptar.

Këto studime sot po i drejtojnë përpjekjet e tyre edhe drejt konceptimit të një modeli të ri ekonomik në kushtet e globalizimit dhe hapjes së tregjeve. Në këtë kontekst të gjitha studimet rreth dilemave të Shqipërisë, për gjetjen e modeleve ekonomike sa më konkurruese apo të politikave ekonomike sa më të përshtatshme, duhet të kombinohen edhe me analizën e efekteve të integritimit ekonomik në BE. Problematikat e pabarazisë, varfërisë, rritjes ekonomike, gjetjes së burimeve të reja të financimit të rritjes ekonomike, formulimi i politikave ekonomike që ulin pabarazinë dhe nxitin rritjen dhe zhvillimin ekonomik, projektimi i modeleve ekonomike, identifikimi i avantazheve ekonomike për rritjen, janë gjithnjë e më të pranishme jo vetëm në interesat shkencore të studiuesve, por edhe në objektivat ekonomike të qeverive.

Ky drejtim kërkimor së pari synon të orientojë politikat publike dhe të realizojë studime në fushën e analizës e të burimeve të rritjes ekonomike. Së dyti, në identifikimin e sektorët të mundshëm për zhvillim bazuar në ndarjen territoriale sipas baseneve ujëmbledhëse. Së treti, në ndërtimin e modeleve ekonomike të rritjes së qëndrueshme në sigurimin e një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Politika publike e zhvillimit rajonal, është një politikë ndërsektoriale, cka do të thotë se sinergjia rajonale përfshihet në pjesën më të madhe të sektorëve kombëtar, me ndikim të drejtëpërdrejtë në drejtim të performancës ekonomike të territorit.

Aktualisht ka një qëndrim të dyzuar nga ana e politikbërësve në Shqipëri, në lidhje me progresin e pritshëm nga sinergjia e zhvillimit rajonal sot. Disa nga detyrat kyce janë: të zhvillohen dhe zbatohen programe projekte rajonale apo të hartohet një kuadër gjithëpërfshirës i një politike publike në funksion të orientimit të sinergjisë rajonale? Kjo është një nga dilemat më të mëdha pasi dhe qasja aktuale për zhvillimin rajonal në Evropë, bazohet në zhvillimin e territorit, mbi të cilin kryhet analiza shumëdimensionale si dhe strategji specifike në lidhje me faktorët socio-ekonomike dhe mjedisor.

Hipoteza e këtij studimi është: Nëse Shqipëria do të ketë një performancë më të mirë ekonomike, hartuesit e politikave publike, duhet të krijojnë një orientim të qartë zhvillimor sektorial për secilin NJQV, Qark (pjesë e gjashtë baseneve ujëmbledhës). Kjo do të thotë krijimin e një modeli zhvillimor të qëndrueshëm në funksion të maksimizimit të sinergjisë rajonale në nivel kombëtar.

1.3 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Ky studim, është një përpjekje për të vlerësuar gjendjen aktuale të zhvillimit rajonal me fokus zhvillimin ekonomik në Shqipëri, duke e krahasuar me vendet e rajonit.

Qëllimi është, të identifikojmë nivelin e sinergjisë rajonale në funksion të performancës ekonomike, trendet kryesore aktuale dhe të pritshme për secilën NJQV, përcaktimin e një modeli të mundshëm ekonomik rajonal për të ardhmen në Shqipëri, në sinkron dhe me eksperiencat ndërkombëtare, si një model për orientimin e politikave publike.

Qëllim i mësipërm do të realizohet pasi të merren në shqyrtim një sër faktorësh të cilët në thelbë janë sektorët zhvillimor për secilën NJQV të cilat do të konsiderohen me kujdes në zhvillimin e modelit për politikatat e zhvillimit ekonomik rajonal- kombëtar.

Më konkretisht, rritja ekonomike në shumicën e vendeve është rrjedhojë e rritjes në disa qendra urbane dinamike me dendësi të lartë ekonomike (dmth, me përqendrim të lartë të aktivitetit ekonomik). Kjo bën që rajonet e prapambetura të përfitojnë kur distanca nga vendet me dendësi të lartë ekonomike është e reduktuar; dhe vendi në tërësi përfiton më shumë në afatgjatë në qoftë se kufijtë me zonat fqinje (p.sh. politikatat tregtare kufizuese) reduktohen ose eliminohen. Kjo duke marrë edhe si modele shqyrtimi atë që na jep eksperiencat e vendeve të rajonit (Banka Botërore 2013).

Në funksion të qëllimit të mësipërm punimi ka si **objektiv kryesor:**

Analizën e ecursisë dhe situatës aktuale dhe të pritshme për secilin sektor, NJQV, Qark, Basen ujëmbledhës në funksion të performancës ekonomik në Shqipëri, bazuar në analizën e bërë, të nënvizojë disa implikime të rëndësishme politike, si dhe mundësitë e përdorimit të këtij modeli për një periudhë afatmesme.

Krahas objektivit kryesor punimi ka edhe disa **objektiva të tjerë** si më poshtë.

- **Identifikimin i situatës** të politikave dhe instrumentave të zhvillimit ekonomik rajonal në Shqipëri, në përputhje me mendimin strategjik për të hyrë në BE për të promovuar zhvillimin rajonal.
- **Analizë krahasuese** e përdorimit të zhvillimit rajonal, me fokus zhvillimin ekonomik në Shqipëri midis NJQV, Qarqeve, baseneve ujëmbledhës duke shtjelluar dhe faktorët përkatës lidhur me nivelin e ndryshëm të përdorimit të zhvillimit socio-ekonomik mes këtyre vendeve.
- **Të argumentojë avantazhet dhe përfitimet** e politikbërsëve, nga përdorimi i këtij modeli për zhvillimin ekonomik rajonal duke analizuar karakteristikat specifike të rajoneve, e parë edhe në kuadrin e procesit të integritetit ekonomik.

Në përfundim studimi **do të sigurojë një model**, rekomandime të vlefshme, si për politikbërsit, institucionet e qeverisjes qendrorë, lokal dhe biznesin.

1.4 PYETJET KËRKIMORE

Bazuar në objektiva, kemi grupuar pyetjet si më poshtë:

Identifikimin i situatës të politikave dhe instrumentave të zhvillimit ekonomik rajonal në Shqipëri, në përputhje me mendimin strategjik për të hyrë në BE për të promovuar zhvillimin rajonal.

- Cili është kuadri ligjor dhe insticional për zhvillimin rajonal në Shqipëri?
- Cilat janë politikat e BE-së për zhvillimin rajonal?
- Cilat janë disa nga modelet e zhvilluara në vendet e BE-së?
- Cili është koncepti i NUTS dhe si lidhet ai me zhvillimin rajonal në Shqipëri?

Analizë krahasuese e përdorimit të zhvillimit rajonal, me fokus zhvillimin ekonomik në Shqipëri midis NJQV, Qarqeve, baseneve ujëmbledhës duke shtjelluar dhe faktorët përkatës lidhur me nivelin e ndryshëm të përdorimit të zhvillimit socio-ekonomik mes këtyre vendeve.

- Cilat janë të dhënat në nivel makro për popullsinë, varfërinë & ekonomine (sipas rajoneve)?
- Cilët janë sektorët prioritarë për rritje ekonomike?
- Cilët janë sektorët faktik që zhvillohen aktualisht në secilën NJQV, Qark, Basen ujëmbledhës?
- Cilët janë sektorët e pritshëm të cilët duhet të zhvillohen në të ardhmen për secilën NJQV, Qark, Basen ujëmbledhës?

Të argumentojë avantazhet dhe përfitimet e politikbërsëve, nga përdorimi i këtij modeli për zhvillimin ekonomik rajonal duke analizuar karakteristikat specifike të rajoneve, e parë edhe në kuadrin e procesit të integritimit ekonomik.

- Cilat janë avantazhet e zhvillimit të sektorëve sipas Baseneve ujëmbledhës bazuar në analizën faktoriale?
- Cilët janë sektorët që mund të performojnë maksimalisht për secilin basen, në ekonominë kombëtare?
- Cilat janë rekomandimet që bazohen në rezultatet e këtij studimi për zhvillimin e sinergjisë rajonale?

KREU 2

RISHIKIMI MBI LITERATURËN E FUSHËS

2.1 RISHIKIMI I LITERATURËS BAZË

Në këtë cështje bëhet një përmbledhje apo sintez e mendimit të studjuesv apo autorëve të cilët janë marr me problematiken e zhvillimit rajonal. Synimi është që përmes kësaj të bëhet një anaizë e problemit të sinergjisë rajonale ne funksion të zhvillimit ekonomik, duke shfrytësuar konsideratat teorike. Përvec kësaj bëhet dhe një evidentim i avantazheve dhe disavantazheve te secilit model të propozuar nga teoria⁶.

Fundi i viteve 1980 futi në përdorim një term të ri në literaturën shkencore socio-ekonomike, termin -zhvillim i qendrueshëm . Ky term u mirëprit gjerësisht, si një sinonim për situatën nëpër të cilën po kalonte ekonomia botërore, transformimin nga socializmi në kapitalizëm⁷.

Rajonalizimi është tendenca e re botërore me ndikim të ndërsjellë në qeverisje, territor dhe zhvillim. i ka rrënjët në teorinë klasike ekonomike të vendndodhjes por lindjen e vërtetë e njeh në vitet `50 të shekullit të kaluar në SHBA. Nën suazën e “nation state”, në vitet `50-`80, zhvillimi rajonal i balancuar dhe i subvencionuar nga qeveria, njohu periudhën e artë si në nivel politik, ashtu edhe akademik.

Keating (1998) e përkufizon rajonalizimin si “një nivel i ndërmjetëm territorial dhe qeverisës, ku pamvarsisht emertimit në të gjejnë vend: gjeografia, kohezioni ekonomik, identiteti kulturor dhe historik, struktura administrative, identiteti popullor, mobilizimi ekonomik territorial në funksion të ekonomisë rajonale dhe kombëtare ”.⁸ *Rajoni* është një lloj specifik territori. Rajoni është një koncept i patrajtshëm dhe fleksibël sepse mbulon një varietet nivelesh territoriale dhe me përmbajtje sociale të ndryshme dhe të ndryshueshme. Rajoni është një nivel i ndërmjetëm midis shtetit dhe lokalitetit; mund të organizohet sipas kriterëve gjeografike dhe mund të jetë homogjen (p.sh., pellgu ujëmbledhës) apo nyjor (p.sh., kryqëzim korridoresh komunikimi apo elementesh të rëndësishme gjeografike); mund të jetë rajon ekonomik i përcaktuar në bazë të karakteristikave të përbashkëta të

⁶ te dhena tw mbledhura nga studime te ndryshme si: <http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.470.7818&rep=rep1&type=pdf>
<http://www.cabdirect.org/abstracts/19651801416.html;jsessionid=0E211AE8DE80B46686C773B32AFCCF5E>
<https://arxiv.org/ftp/arxiv/papers/0911/0911.3425.pdf>
<ftp://papers.econ.mpg.de/egg/discussionpapers/2004-36.pdf>

⁷ Jam plotësisht e vetëdijshme që kjo deklaratë mund të jetë shumë e diskutueshme, por e kam zgjedhur atë sepse është koncize; megjithëse vihet re në këtë periudhë që vendet e EQL në këtë periudhë përpiqen të bëjnë ndryshime nga një shoqëri e kufizuar drejt një organizimi social fiskal më demokratik.

⁸ Dokumenti Rajonalizimi i Shqiperise perkundrejt reformes territorial 2010.

prodhimit dhe/ose ndërveprimit të tregjeve të punës; mund të organizohet në bazë të karakteristikave sociale dhe në këtë rast do të kishim rajone funksionale; mund të jetë rajon kulturor dhe historik, pra i lidhur ngushtë me identitetin; mund të jetë rajon administrativ, në bazë të të cilit qëndron modeli i qeverisjes dhe forma dhe eficientia e ofrimit të shërbimeve publike; etj.

Të gjitha këto forma jo vetëm që mund të mos lidhen nga pikëpamja hapësinore, por edhe mund të kontradiktojnë. Rasti tipik është ai i Europës së Bashkuar, ku kufijtë e rajoneve historike nuk respektojnë kufijtë e shteteve. Atje ku elementet gjeografikë, të kohezionit ekonomik, identitetit kulturor, aparatit administrativ, identitetit popullor dhe mobilizimi territorial koinçidojnë me njëri-tjetrin, kemi rajonalizëm të fortë (Keating, 1998). E megjithatë, për shkak të papërcaktueshmërisë së tyre, rajonet mbeten sisteme të hapura dhe mjaft fleksibël.

Analizat dëshmojnë se NJQV-të me më tepër potencial (përgjithësisht me popullsi më të dendur e me numër më të lartë të aktiviteteve ekonomike) kanë mundësi të gjenerojnë më tepër të ardhura dhe rrjedhimisht të ofrojnë më tepër shërbime.

Literatura dhe praktika ndërkombëtare konfirmon se madhësia optimale për arritjen e eficientisë së shërbimeve publike, është tek njësitë vendore me popullsi nga 25,000 banorë deri në 250,000 banorë (McKinlay Douglas Limited, 2006; Holzer et al., 2009).

Pikërisht duke iu referuar këtyre treguesve mund të themi se niveli i pabarazive të krijuara si rezultat i pamundësive të njëjta të NJQV-ve për të ofruar shërbime lidhet ngushtë me madhësinë (sipërfaqen, popullsinë, dendësinë) dhe kapacitetet e NJQV-s

ë. Veç kësaj analizat dëshmojnë se politikat subvencionuese ndaj njësive të vogla vendore nëpërmjet skemave të transfertave dhe ekualizimit fiskal në thelb nuk kanë ndihmuar në zhdukjen e pabarazive duke mos garantuar një zhvillim të qëndrueshëm.

Nevoja dhe avantazhet për një zhvillim rajonal të qëndrueshëm është njohur gjerësisht nga faktori i brendshëm politik, dhe i rekomanduar fuqishëm nga partnerët më të rëndësishëm ndërkombëtarë të Shqipërisë si dhe nga organizatat ndërkombëtare përfshirë Komisionin e BE-së dhe Këshillin e Evropës.

Plurel (2010) e përkufizon zhvillimin rajonal ekonomik – rajonalizimin “proces nëpërmjet të cilit rajonet marrin nivele të caktuara të autonomis dhe autoritetit të tyre politik, qeverisës dhe ekonomik”. Ky punim konsideron si definicionet më të mira për zhvillimin e qëndrueshëm/zhvillimin rajonal konceptin nga Brundtland Commission (1987) dhe raportet e tjera të “Eordl Commission on Environment and Development (1987)”, “International Council for Local Environment Inisiativa (1999)”; John PEZZEY’s raprti i Bankës Botërore (1992). Libri I Peter ROGERS’ “Një hyrje në zhvillimin e qëndrueshëm(2008)”. Raportin studimor “World Development Report 2009: Reshaping Economic Geography”.

Më konkretisht, në literaturat e mësipërme gjejmë konceptin që rritja ekonomike në shumicën e vendeve është rrjedhojë e rritjes në disa qendra urbane dinamike me dendësi të lartë ekonomike (dmth, me përqendrim të lartë të aktivitetit ekonomik). Kjo bën që rajonet e prapambetura të përfitojnë kur distanca nga vendet me dendësi të lartë ekonomike është e reduktuar; dhe vendi në tërësi përfiton më shumë në afatgjatë në qoftë se kufijtë me zonat fqinje (p.sh. politikat tregtare kufizuese) reduktohen ose eliminohen.

Fokusi, fillestar ka qenë trazicioni ekonomik, me ndryshimin e të drejtës mbi pronësinë dhe me liberalizimin e ekonomisë, ndërsa decentralizimi orientonte plotësisht transformimin fiskal dhe social të ekonomive lokale rajonale dhe kombëtare.

Problemet e zhvillimit rajonal & decentralizimit, u bënë problemet kryesore në mesin e viteve 90 për vendet e Europës Jug- Lindore (EJL) duke u bërë të qarta, mbas publikimit të kriterëve të Kopenhagenit lidhur me atë se çfarë priste BE nga vendet që aspironin të bashkoheshin me BE-në. Gjithashtu, gjatë kësaj kohe u bë evidente dhe rëndësia e rajonalizimit si politikë e zhvillimit ekonomik kombëtar.

Nëse, do ti referohemi konceptit të zhvillimit të qendrueshëm /rajonal në Europë ka një sër dokumentash si:

(the EU strategy for sustainable development) të cilat paraqesin kuadrin logjik institucional të zhvillimit të kësaj politike në vendet e BE-së si European Social Fund and the Cohesion Fund. Brussels, COM (2004) ;Regional Policy Goes East: Essays on Trends and Lessons Learned for Regional Development Policy in Central and Eastern Europe (Hudak, Huitfeldt, Meegan, 1999); Regulation (EC) no. 1059/2003 of the European Parliament and of the Council, dated 26 May 2003, on the establishment of “A Common Classification of Territorial Units for Statistics (NUTS).” Europe 2020: A European Strategy for Smart, Sustainable, and Inclusive Growth, August 2010. Governing Cities: Policy Highlights, Organization for Economic Cooperation and Development, 2014; EC (2014) Instrument for Pre-Accession Instrument (IPA II) – Indicative Strategy Paper for Albania (2014 – 2020); Identification of Project Selection Models for the Romanian Regional Operational Program, 2014-2020. Agenda 21 (United Nations Environment Program (UNEP, 1992), shumica e qeverive të botës e kanë njohur Agendën 21 (midis tyre dhe Shqipëria) e cila orienton politikat kryesisht drejt zhvillimit të qendrueshëm mjedisor.

Nëse do ti referohemi të literaturës së botuar nga institucione të ndryshme publike dhe organizma ndërkombëtarë në Shqipëri do të përmendnim: Strategjia Kombëtare për Zhvillim & Integritet 2015-2020 (2016) ;Plani kombëtar për Stabilizim Asocim (2006); Progres raporti për implementimin e Statistikave kombëtare të implementuara nga INSTAT (Yearbook 2013–2020); Regional Disparities in Albania” prepared under “Integrated Support for Decentralization Project: working for Regional Development”, Tirana, November 2010. Raporti i Bankës Botërore dhe i Kombeve të Bashkuara për Shqipërinë (2010- 2013);Raporti UNDP për hendekun ndërmjet qarqeve (2010): Pina Bregdeti/ Pina Durrana Plani Kombëtar i zhvillimit të territorit (2016);Strategjite lokale të zhvillimit të Territorit (2015) ;“Strategjia ndër-sektorale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020”;Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”(2015): ligji 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”;“Programi kombëtar i reformës ekonomike 2014-2020”

Një nga studimet më të fundit që përputhet me qasjen metodike të zhvilluar në këtë punim është dhe Studimi i DLDP-së (Programi për Zhvillimin Lokal dhe Decentralizimin)

Programi për qeverisjen vendore DLDP i financuar nga qeveria zvicerane, në vitin 2013 ndërmori një studim mbi “zonat funksionale” në Shqipëri në 5 qarqet e Durrësit, Lezhës, Shkodrës, Dibrës, Kukësit.

Koncepti i zonës funksionale, në kontekstin e këtij studimi, përdoret për të përkufizuar një hapësirë ku ndërveprimet ndërmjet banorëve dhe bashkëpunimi ndërmjet enteteve qeveritare janë të shpeshta dhe të dendura. ‘Zona funksionale’ i referohet nocionit që të kuptuarit e një hapësire -- e cila do niveli që mund të jetë (bashki, qark dhe kështu me radhë) - nuk duhet të përcaktohet përgjatë vijave administrative apo historike, por në bazë të asaj se si ndodhin ndërveprime të ndryshme brenda asaj hapësire për qëllime ekonomike (punësimi, konsumi, tregjet, të ardhurat), qëllime sociale (shëndetësia, arsimi) dhe bashkëpunimi midis institucioneve vendore.

Arsyeja për të cilën rajoni është forma e territorit që do të merret në konsideratë në propozimet e mëposhtme, është lidhja midis shtetit dhe rajonit dhe rikonfigurimi i rolit të këtij të fundit në nivel botëror. Sipas Keating, në formën tradicionale të manaxhimit të territorit, marrëdhënia e rajoneve me tregun global dhe regjimet ndërkombëtare realizohet përmes shtetit. Rajonet siguronin mbështetje politike për shtetet dhe në këmbim, shtetet subvenciononin ekonominë rajonale dhe siguronin mbrojtje. Në erën e globalizmit, rajonet vazhdojnë të ruajnë marrëdhënien e tyre të ndërsjelle me shtetin dhe qeverisjen përkatëse, por shteti ka humbur monopolin e tij mbi marrëdhëniet e rajonit me tregjet dhe regjimet botërore. Pozicioni i rajoneve në tregjet botërore nuk përcaktohet më nga kanalet politike, por nga avantazhet konkurruese të rajoneve dhe aftësia e tyre për t'i shfrytëzuar me sukses këto avantazhe.

Pra, kemi një kapërcim nga *koncepti statik i avantazhit krahasues në konceptin dinamik të avantazhit konkurrues*, ku politikëbërësit, përmes një politike aktive dhe marrëdhëniesh komplekse publike-private, maksimalizojnë kapacitetin e territorit të tyre për të konkurruar dhe këtë e bëjnë duke shtuar burimet dhe mobilizuar energjitë lokale. Rajoni është hapësira më e përshtatshme territoriale ku mund të realizohet marrëdhënia e mësipërme, sepse mënjanon tendencat negative të konkurrencës në baza territoriale shumë fragmentare, ofron koordinim të politikave në nivel rajonal dhe më efikas, koordinon investimet kapitale për infrastruktura etj.

Sërish sipas Keating, sa më sipër argumenton se aktualisht rajonet kanë rikonfiguruar politikën e territorit duke fituar një zë të ri në politikëbërje. Kemi të bëjmë me një rend të ri dhe shumë kompleks, në të cilin rajonet kanë shpërthyer/rilindur si “*vende të reja të politikëbërjes*” dhe si aktorë të pavarur në rendin botëror. Sigurisht, që rajonet nuk kanë zëvendësuar shtetin; kjo nuk do të ndodhë. Por rajonet ndikojnë në punën e shtetit dhe tani që “*nation state*” po rikonfigurohet si rezultat i proceseve globale, rajonet po shfaqen sërish fuqishëm në jetën politike, duke modifikuar pushtetin dhe autoritetin e “*nation state*”.

Në këtë diskutim, rajoni mund të konsiderohet si shkalla më e përshtatshme territoriale, bazë e këtij ndryshimi të marrëdhënieve ekonomike dhe institucionale. Kjo ndodh për disa arsye (Herschel & Newman, 2002):

- Rajoni është *njësi territoriale fleksibël* dhe pozicionohet mes shkallës kombëtare dhe lokale, duke luajtur rolin e ndërmjetësit;
- Rajoni përmban *identitete kulturore dhe historike homogjene*, dhe duke ushqyer ndjenjën e fortë të përkatësisë ushtron *presione politike* dhe ndikon në krijimin e përfaqësive të rëndësishme politike;
- Rajoni inkurajon *ekonomi të shkallës* dhe konkurrencë të shëndetshme;
- Rajoni është hapësirë për mbrojtje të *marrëdhënieve sociale*;
- Rajoni është bazë për *barazi ekonomike* hapësinore dhe *përfitime mjedisore*

Nga analiza e studimeve, raporteve të mësipërme vihet re që, rajonalizimi në Shqipëri nxorri në pah se motivet politike të qeverisë qendrore dhe vendore shpesh ishin në konflikt me njëra-tjetrën. Në këtë kohë pritej që qeverisja vendore të ishte e etur për të marrë menaxhimin e taksave vendore dhe burimeve të veta të të ardhurave të tyre, por vihej re e kundërta, politikanët lokal ishin më të ineresuar për të siguruar transferim grantesh nga qeverisja qendrore për zhvillimin rajonal, më tepër se sa të interesoheshin për mbledhjen e taksave vendore me qëllim nxitjen e ekonomive të shkallës.

Proceset e decentralizimit, rajonalizimi në vetvehte nuk kanë qenë të lehtë dhe vende të ndryshme janë bashkuar bazuar në nivelin e tyre të “shkallëzimit” të trazicionit. Shtetet Balltike dhe vendet e Europës Qendrore janë konsideruar si “vende/ekonomi” me trazicion me të “avancuar” që kanë bërë

shumë për të reformuar ekonomitë e tyre. Të gjitha këto vende janë bërë pjesë e Bashkimit Europina, në Maj të vitit 2004.

Situata është e ndryshme në vendet e Europës Jug- Lindore, gjithashtu dhe në Shqipëri, në krahasim me vendet e tjera të Europës në tranzicion, në këto vende ecuria e proceseve të rajonalizimit të qëndrueshëm me fokus performancën ekonomike, vazhdon të ngjehet në status quo e viteve 2000, me përmirësime të pjesëahmë por jo përfundimtare në lidhje me shfrytëzimin maksimal të burimeve për një zhvillim rajonal të qëndrueshëm. Në vendet e rajonit bën një përjashtim Kroacia e cila aktualisht është pjesë e Bashkimit Europian si dhe Ish Jugosllavia me nxitjen e reformave me qëllim nxitjen ekonomike.

2.2 POLITIKAT E BE-SË PËR ZHVILLIMIN RAJONAL

Është e rëndësishme, sidomos në kontekstin e integritetit europian, që ti vendosim pabarazitë rajonale të Shqipërisë dhe problemet e zhvillimit të vendit në një perspektivë më të gjerë. Për këtë arsye, në këtë kapitull ne bëjmë referenca në politikat e BE-së si dhe disa krahasime të rëndësishme me vendet e BE-së, për të nxjerr disa konkluzione, të cilat ndikojnë në realitetet e zhvillimit të metabolizmit rajonal ekonomik të vendit.

Të dhënat janë marrë kryesisht nga modele të politikave të zhvillimit rajonal të ndjekura nga vendet e BE-së apo vendet Çështjet kryesore që janë trajtuar nën perspektivën ndërkombëtare janë elementet strukturor të rritjes ekonomike nëpërmjet orientimit të rajoneve ⁹

Politika rajonale e Bashkimit Europian përfshin një sërë instrumentesh politike dhe financiare për të adresuar pabarazitë ekonomike dhe sociale në Komunitet¹⁰. Instrumente në këtë kuadër janë hartuar dhe zbatuar që në vitin 1957, por vetëm në vitin 1986 u hodhën themelet e politikës së kohezionit. Politika e re u bazua në parime si: fokusimi tek rajonet më të varfëra, programimi shumë-vjeçar, orientimi strategjik i investimeve dhe përfshirja e partnerëve lokale dhe rajonalë. Traktati i Mاستrihtit, 1992, dhe traktati i rishikuar për Komunitetin hynë në fuqi në vitin 1993 dhe materializuan fondin e kohezionit, komitetin e rajoneve dhe prezantuan parimin e subsidiaritetit. Kjo u përkufizua si faza e konsolidimit 1994-1999. Në vitin 2004, 10 vende të reja anëtare iu shtuan BE.

Bashkimi Europian, është një burim i rëndësishëm financimi për zhvillimin rajonal e parë nga ky kontekst Shqipëria është një nga vendet më të vogla për nga popullsia dhe sipërfaqja. Ajo mund të krahasohet me shumë rajone NUTS II në BE, të cilat janë subjekt parësor i politikës social-ekonomike të kohezionit të BE-së. Në shumë aspekte pabarazitë e zhvillimit në Shqipëri mund të konsiderohen më tepër si lokale, sesa si rajonale e si rrjedhim me pak ndikim nga perspektiva e jashtme. Ka shumë faktorë të rëndësishëm jashtë që e diferencojnë Shqipërinë nga vendet anëtare të BE-së, vendet kandidate apo vende të tjera, për sa i përket performancës ekonomike. Pavarësisht rritjes së konsiderueshme dhe të qëndrueshme në dekadën e fundit, Shqipëria është ende mbrapa jo vetëm vendeve të BE-së, por edhe shumicës së vendeve kandidate dhe potencial kandidate, ashtu si edhe tregohet nga të dhënat e krahasueshme të Eurostat.

Është e rëndësishme të theksohet se BE-ja nuk ka bazë ligjore për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal, masa të tilla janë lënë në diskrecionin e shteteve anëtare individuale, duke ndjekur parimin e subsidiaritetit.

Karakteristikat kryesore të sistemeve të planifikimit të zhvillimit rajonal të vendeve anëtare të BE-së në përgjithësi përfshijnë: (i) një akt të zhvillimit rajonal; (ii) planifikimi i rajoneve dhe zonave me nevoja specifike të zhvillimit; (iii) një ministri / ose institucion tjetër qeveritar përgjegjës për zhvillimin rajonal; (iv) një strukturë kombëtare këshillimore për zhvillimin rajonal (Këshilli Kombëtar për Zhvillimin Rajonal); (v) strukturat këshillimore rajonale për zhvillimin rajonal (Këshillat e Zhvillimit Rajonal); (vi) proceset me pjesëmarrje rajonale të planifikimit të zhvillimit në nivel kombëtar dhe rajonal; (vii) një dokument kombëtar strategjik për zhvillimin rajonal (Strategjia Kombëtare për Zhvillim Rajonal); (viii) dokumentet e planifikimit të zhvillimit rajonal (Planet e Zhvillimit Rajonal); (ix) organet e zbatimit kombëtar (Agjencitë Kombëtare Rajonale të Zhvillimit të

⁹ Pjesë e aneksit 2

¹⁰ Komuniteti ose Bashkimi Europian

ose njësitë e specializuara brenda ministrisë përgjegjëse për zhvillimin rajonal); (x) organet e zbatimit nën-kombëtar (Agjencitë e Zhvillimit Rajonal); (xi) burime të veçanta për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal (Fondi i Zhvillimit Rajonal); (xii) kritere për ndarjen e burimeve për zhvillimin rajonal në rajonet dhe zonat më të pafavorizuara; (xiii) sistemet e monitorimit dhe vlerësimit¹¹. Si rezultat, në nivel të shteteve anëtare individuale, çdo qeveri ka një qasje unike për zhvillimin rajonal, në përputhje me faktorët kontekstualë, p.sh, kontributi ekonomik i qyteteve në GDP, kuadri specifik i qeverisjes dhe administrimit të çdo vendi etj.

BE-ja nuk ka miratuar një model të vetëm të pastër për zhvillimin rajonal. Në përgjithësi, BE-ja ka prioritet investimet që synojnë rritjen e konvergencës midis shteteve anëtare, politikisht dhe ekonomikisht. Në të njëjtën kohë, që nga Strategjisa e Lisbonës në vitin 2000, BE-ja ka rifokusuar disa nga përpjekjet e saj kryesore në nxitjen e rritjes ekonomike dhe konkurrencës rajonale. Sipas një raporti të 2009, "Politika rajonale nuk shihet më si një mjet për të ndihmuar rajonet të arrijnë deri në mesataren e Bashkimit, pavarësisht rëndësisë që ai ka. Konkurrenca duke u zhvilluar sipas linjave rajonale në tregun botëror dhe ekonomitë e suksesshme rajonale janë ato që janë bërë lojtarët e vërtetë në rrjetin e prodhimit botëror"¹².

Në mënyrë të ngjashme, prioriteti i parë i Agjendës Territoriale të BE-së 2020 (AT 2020) - i miratuar në 2011 si dokumenti kryesor udhëzues i përpjekjeve të zhvillimit rajonal të BE-së është përmirësimi i zhvillimit territorial policentrik dhe të balancuar.¹³ Nga njëra anë, TA 2020 vë në dukje rëndësinë e qendrave të mëdha urbane si nxitës të rritjes ekonomike në rajonet e tyre dhe për të gjithë BE-në. Në të njëjtën kohë, TA 2020 thekson rëndësinë e zhvillimit të qyteteve më të vogla për të reduktuar polarizimin territorial të performancës ekonomike.

Si pasojë, mesazhe të tilla sugjerojnë që kuadri i zhvillimit rajonal të BE-së ka evoluar me kalimin e kohës drejt një kombinimi më të ndërlikuar të ndërhyrjeve që synojnë rritje të qëndrueshme dhe të balancuar. Gjithashtu, politikat e kohezionit të 2014-2020 janë aktualisht në bazë të prioritetëve të "Europa 2020", e cila është një strategji për të ndihmuar Evropën të dalë më e fortë nga kriza dhe për të përgatitur ekonominë e BE-së për dekadën e ardhshme.

Komisioni European-krahu ekzekutiv i Bashkimit Evropian, ka identifikuar tre drejtimet kyçe për zhvillim, që do të mbështeten përmes veprimeve nga BE dhe nivelet kombëtare: (i) rritja e inteligjencës (nxitja e njohurive, inovacionit, arsimit dhe të shoqërisë dixhitale), (ii) rritja e qëndrueshme (për të bërë prodhimin BE-së më të gjelbër dhe me burime më efikase ndërsa rrit aftësinë konkurruese), dhe (iii) rritja përfshirëse (ritja e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore të tregut, përvetësimi i aftësive, dhe lufta kundër varfërisë). Për të arritur këto tri prioritetet, KE ka propozuar pesë objektiva të ndërlidhura për BE-në për t'u arritur deri në 2020, duke përfshirë: punësimin, Kërkim dhe Zhvillim (R&D), ndryshimet klimatike dhe efikasiteti i energjisë, arsimit dhe varfëria. Kjo përpjekje do të mbështetet edhe nga shtatë iniciativa për të nxitur përparimin në çdo temë

¹¹Raport i 2 mbi Analizën e Kuadrit Ligjor përgatitur nga Agjencia Austriake e Zhvillimit, nëpërmjet Programit EC IPA për 2008-ën. Kjo është një iniciativë e ndërmarrë nga Departamenti i Programeve të Zhvillimit, Financimit dhe Ndihmës së Huaj (DPDFFA) në Shqipëri.

¹²http://ec.europa.eu/regional_policy/sources/docgener/presenta/international/external_en.pdf

¹³<http://www.eu-territorial-agenda.eu/Reference%20Documents/Final%20TA2020.pdf>

prioritare¹⁴. E parë nga konteksti shqiptar, këto orientime të BE-së janë një faktor kyç në adresimin e politikave kombëtare rajonale.

Politika Rajonale e BE-së është realizuar përmes tri fondeve kryesore: Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF), Fondi i Kohezionit (CF) dhe Fondi Social European (ESF). Së bashku me Fondin Evropian Bujqësor për Zhvillim Rural (EAFRD) dhe Fondin Detare Evropian dhe të Peshkimit (EMFF), ato përbëjnë Fondet Strukturore Europiane dhe të Investimeve (ESI). Programi i investimit i kësaj periudhe i FEZHR përqendrohet në katër tema kryesore: (i) inovacionin dhe kërkimin shkencor; (ii) teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK); (iii) mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME-të); dhe (iv) nxitjen e një ekonomie të ulët të karbonit. Llojet e investimeve mund të jenë: në SME-të për të krijuar dhe ruajtur vende pune të qëndrueshme, në të gjitha llojet e ndërmarrjeve në fushën e inovacionit dhe kërkimit, ekonomi e ulët e karbonit, si dhe TIK ku janë të përfshirë SME-të, në infrastrukturë duke ofruar shërbimet themelore në energji, mjedis, transport, dhe TIK, por edhe në infrastrukturën sociale, shëndetësore dhe arsimore, dhe në zhvillimin e potencialeve endogjene¹⁵

Europa 2020 ka një fokus më të madh në zhvillimin urban dhe rajonal si dhe promovimin e zhvillimit të integruar territorial. Dy instrumentat e rinj të zhvillimit territorial të propozuar nga BE për periudhën tjetër të financimeve mund të ofrojnë një bazë të mirë për realizimin e qasjes së zhvillimit të integruar territorial, dhe tërheqjen e financimeve nga fondet programet operacionale.

- **Metoda e zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti (community-led local development- CLLD)**- duke reflektuar kryesisht metodën e Liderit për zonat rurale dhe duke e zgjeruar atë për të gjitha fondet CSF dhe territore të tjera - i dedikohet iniciativave lokale të zhvillimit nga poshtë-lart për territore të caktuara nën-rajonale, që janë zbatuar nga ana e komunitetit lokal përmes partneritetit publik-privat (Banka Botërore).
- **“Investimi i integruar territorial”** mund të shërbejë për mbledhjen e financimeve, nga më shumë se një aks prioritar të një ose më shumë programeve operative në një skemë të integruar të financimit territorial. Këto pjesë të akteve prioritare janë zbatuar në mënyrë të përbashkët dhe është e mundur të nën-delegohet menaxhimi dhe implementimi në organe të ndërmjetme, përfshirë autoritetet lokale, agjencitë rajonale të zhvillimit ose Organizata Jo Qeveritare (OJQ).

2.3 ORGANIZMI ME ZONA/RAJONE

Shqipëria është e ndarë në katër shtylla kryesore sipas karakteristikave territoriale, Përsa i përket nivelit të qeverisjes në Shqipëria ka dy të tilla: nivelin qendror dhe nivelin vendor. Në nivelin vendor dallohen 61 bashki sipas reformës territoriale të miratuar në vitin 2014, te cilat kategorizohen si njësi të nivelit të parë të qeverisjes vendore dhe qarqet, të cilat janë njësitë e nivelit të dytë të qeverisjes vendore dhe ku marrin jetë strategjitë rajonale. Territori shqiptar është i organizuar në 12

¹⁴ Europe 2020: Një strategji Europiane Për rritje të inteligjencës, rritje të qëndrueshme dhe rritje përfshirëse, Gusht 2010.

¹⁵ http://ec.europa.eu/regional_policy/thefunds/regional/index_en.cfm/

Qarqe dhe 61 Bashki, nuk ka as rajone administrative dhe as rajone të vetëqeverisura në Shqipëri, që t'i korrespondojnë nivelit të klasifikimit NUTS 2¹⁶, qarqet janë ekuivalenti i nivelit NUTS 3 në bazë të numrit të popullsisë dhe rreformës territoriale paraqitet ndarja si më poshtë vijon:

Organizim Qeverisje	Organizim Planifikimi ¹⁷	Organizim Statistikor ¹⁸	Organizim zhvillimor
12 Qarqe	8 rajone ndërkufitare ¹⁹	NUTS 1: Shqipëria ²⁰	4 Zona të Zhvillimit të Rajonal
12 Prefektura	6 rajone ekonomike kombëtare	NUTS 2: 3 rajone ²¹	
36 Rrethe	4 rajone të specializuara	NUTS 3: 12 qarqet ²²	
61 Bashki		LAU 2 - nivel lokal ²³	
Qytete-Fshatra			

2.3.1 RAJONET STATISTIKORE NUTS

Ndarja e territorit në rajone sipas standarteve/niveleve NUTS behet për qëllime statistikore. Standardi është zhvilluar nga Bashkimi Evropian. Shqipëria është e përfshirë në Nomenklaturën e njësive territoriale për statistika (Nomenclature of Territorial Units for Statistics NUTS) duke qenë vend kandidat i Bashkimit Evropian.

Level	Minimum	Maximum
NUTS 1	3 mln	7mln
NUTS 2	800 mijë	3 mln
NUTS 3	150 mijë	800 mijë

¹⁶ Nomenklaturë e Njësive Territoriale për Statistikat; rajonet NUTS 2 referohen specifikisht nga politika e kohezionit e BE-së

¹⁷ Përcaktimi i rajoneve sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar

¹⁸ Ndarja e territorit në rajone sipas standarteve/niveleve NUTS behet për qëllime statistikore. Standardi është zhvilluar nga Bashkimi Evropian. Shqipëria është e përfshirë në Nomenklaturën e njësive territoriale për statistika (Nomenclature of Territorial Units for Statistics NUTS) duke qenë vend kandidat i Bashkimit Evropian.

¹⁹ Rajonet ndërkufitare burojnë nga politikat e kohezionit të Komisionit Evropian dhe asistencën që jepet në kuadër të instrumentit të asistencës së Bashkimit Evropian IPA

²⁰ NUTS 1: 3mln – 7 mln banorë

²¹ NUTS 2: 800 mijë - 3mln banorë (Shqipëria Veriore: Dibër, Durrës, Kukës, Lezhë, Shkodër; Shqipëria Qendrore: Tiranë, Elbasan; Shqipëria Jugore: Berat, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Vlorë)

²² NUTS 3: 150 mijë – 800 mijë banorë. (VKM 1030, datë 15.12.2010 “Për zbatimin e nomenklaturës “Shqipëria në 3 (tri) rajone NUTS II”, sipas Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS), të Bashkimit Evropian)).

²³ Për të plotësuar kërkesat për statistika në nivel lokal, Eurostat ka ngritur një sistem të Njësive Administrative Lokale (LAU) në përputhje me NUTS. Në nivelin lokal, janë përcaktuar 2 nivele (LAU): a) niveli i sipërm LAU (niveli LAU 1, niveli i mëparshëm NUTS 4) është përcaktuar për pjesën më të madhe, por jo për të gjitha vendet; b) niveli i ulët LAU (niveli LAU 2 dikur niveli NUTS 5) përbëhet nga bashki ose njësi ekuivalente në 28 shtetet anëtare të BE-së.

- NUTS-1: Shqipëria
- NUTS-2: 3 rajone jo-administrative
- NUTS-3: 12 qarqet

Referuar VKM nr. 1030, datë 15.12.2010 “Për zbatimin e nomenklaturës “Shqipëria në 3 (tri) rajone NUTS II”, sipas Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) , të Bashkimit Europian, Shqipëria është ndarë të 3 rajone statistikore, NUTS-2, si me poshte:

1. Shqipëria Veriore

Dibër
Durrës
Kukës
Lezhë
Shkodër

2. Shqipëria Qendrore

Elbasan
Tirana

3. Shqipëria Jugore

Berat
Fier
Gjirokastrë
Korçë
Vlorë



2.3.2 RAJONET STATISTIKORE LAU

Për të plotësuar kërkesën për statistikat në nivel lokal, Eurostat ka ngritur një sistem të **Njësive Administrative Lokale** (LAUs) në përputhje me NUTS. Kjo është një ndarje në nivel të ulët administrativ, dhe renditet më poshtë krahines/qarkut, rajonit, nivelit qendror.

Jane percaktuar 2 nivele të Njësive Administrative Lokale në nivel lokal:

- Niveli i sipërm LAU (niveli **LAU 1**, dikur niveli NUTS 4) është percaktuar vetëm për shumicën, por jo të gjitha vendet.
- Niveli i ulët LAU (niveli **LAU 2**, dikur niveli NUTS 5) përbëhet nga bashki ose njësi ekuivalente në 28 shtetet anëtare të BE-së.

Meqenëse për LAUska ndryshime të shpeshta, Eurostat ndjek zhvillimin e saj nga viti në vit. Nëse është e mundur, Eurostat merr të dhënat plotësuese themelore administrative me

anë të listave vjetore të LAU-ve, përkatësisht popullatës së përgjithshme dhe sipërfaqes në nivel LAU 2

Rrjedhimisht, përcaktimi i zonave funksionale zhvillimore sipas ndarjes administrative territoriale dhe krijimi i nje strukture qeverisjes përkatëse për Shqipërinë është shumë e rëndësishme. Si rezultat, sfida kryesore për Shqipërinë në kontekstin e metabolizmit rajonal bazuar në orientimet e BE –së është zhvillimi dhe zbatimi i programeve të integruara. Në mënyrë ideale, planet e zhvillimit të integruar (PZHI) sygjerohet të përfshijnë një plan gjithëpërfshirës të veprimit, me një listë të projekteve që do të financohen nga burime të BE-së, si dhe nga buxheti lokal dhe kombëtar.

Këto programe duhet të shqyrtojnë mënyrat për të përfituar sipërfaqe më të mëdha metropolitane dhe sektorë të shumtë për të mundësuar sinergji optimale. Në këtë kuptim, instrumentet e reja të planifikuara nën ushtrimin e ardhshëm të programimit të BE, të tilla si Investimet Territoriale të Integruara, duhet të shfrytëzohen për të siguruar mekanizmat e duhur të financimit dhe zbatimit për programet e integruara.

2.4 POLITIKAT DHE INSTRUMENTET NË KONTEKSTIN E ZHVILLIMIT RAJONAL

Në Shqipëri, kemi qeverisje të dekoncentruar dhe të decentralizuar me institucione, që shkojnë në favor të decentralizimit dhe zhvillimit lokal. Ndërkohë, po flitet gjithnjë e më shumë për zhvillimin rajonal dhe për institucionet e propozuara për këtë qëllim. Në nivel institucional, *dekoncentrimi* kryhet përmes institucionit të Prefektit, që operon në nivel qarku nga pikëpamja hapësinore administrative dhe drejtoritë rajonale të ministrive të linjës dhe drejtorive në nivel rrethi. Ministrinë e linjës, si ajo e Arsimit, Mjedisit, Bujqësisë, Shëndetësisë etj, hartojnë politikën përkatëse dhe kalojnë fondet për zbatimin e këtyre politikave në institucionet përkatëse të dekoncentruara. Prefekti kontrollon ligjshmërinë e aktivitetit vendor dhe koordinon veprimtarinë mes nivelit vendor dhe atij qendror.

Deri tani, vendi nuk ka zbatuar një politikë publike të mirëfilltë për zhvillimin rajonal, nuk ka një platformë të qartë dhe koherente për zhvillimin ekonomik të rajoneve, dhe as institucione të qarta me rolet përkatëse të përcaktuara. Shqipëria nuk ka kornizat ligjore, rregullatore dhe institucionale, që ti i ngjajnë sistemit të sofistikuar të planifikimit për një ekonomi shkallë si në vendet anëtare të BE-së. Aktualisht politikën për zhvillimin rajonal e gjejmë të materializuar në instrumentat ligjor që lidhen me territorin apo decentralizimin pjesë e demokracisë dhe fuqizimit të autonomisë së pushtetit vendor.

Decentralizimi i qeverisjes në Shqipëri nisi në fillim të viteve '90-të, kur qeveritë vendore për herë të parë u zgjodhën në mënyrë demokratike. Pavarësisht se nuk mund të flasim ende për autonomi administrative apo fiskale, reformat e vitit '92 vendosën bazën për krijimin e autoriteteve vendore demokratike, të cilat ngadalë u përgatitën për të marrë më tepër përgjegjësi e funksione. Ratifikimi pa kushte i Kartës Europiane të Vetëqeverisjes Vendore (8548/1998) dhe miratimi i Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore (8652/2000) shënojnë momentin e dytë të rëndësishëm në decentralizimin e qeverisjes, duke krijuar kornizën për decentralizimin e plotë administrativ e fiskal. Ndërkohë ndarja e përcaktuar me vendim qeverie në vitin 1992 u bazua kryesisht në trashëgiminë e organizimit territorial të sistemit komunist, duke transformuar ish kooperativat e bujqësore në njësi vendore të quajtura komuna dhe qytetet në bashki.

Të dyja këto dokumente përcaktojnë si një prej objektivave kryesore të reformave të decentralizimit në Shqipëri.

Ndarja aktuale administrativo-territoriale me 12 qarqe, 61 bashki, është miratuar me ligjin Ligj nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Sipas këtij ligji Rrethi si njësi territoriale dhe nëndarje e qarkut, është suprimuar në kushtet kur numri i bashkive është zvogëluar në 61 të tilla. Në disa raste territori i bashkive, përkon edhe me kufijtë e rretheve si dhe mesatarisht çdo qark përbëhet nga 5 deri në 6 bashki.

Përpara reformës administrative territoriale të vitit 2014, vendi ndahej në 12 qarqe, 65 bashki dhe 308 komuna, miratuar me ligjin Nr.8653 datë 31.7.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Në thelb, ndarja administrative e vitit 2000 përpiket të ruajë kufijtë historikë të bashkive, komunave, rretheve apo prefekturave (duke iu referuar fillim shekullit XX) duke shkrirë kufijtë administrativë të rretheve me ato të qarqeve.

Ky ligj së bashku me ligjin Nr. 8652 datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe ligjin Nr.8654 datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Tiranë” ishte e pjesë e paketës ligjore të reformës së decentralizimit që u miratua në vitin 2000.

Ligji i ndarjes administrativo-territoriale 8653/2000 përveç ndryshimit dhe futjes së qarkut si njësi e re që zëvendësoi ish-rrethet, për nivelin e bashkive dhe komunave ruajti në thelb ndarjen e përcaktuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.269 datë 25.6.1992.

Kjo paketë reformash, që përcaktoi kornizën kryesore të decentralizimit të qeverisjes në Shqipëri, u ndërtua mbi supozimin se njësitë e qeverisjes vendore, të cilat s’do të kishin mundësi për të ofruar më vete funksionet dhe përgjegjësitë e transferuara, do të përdornin alternativën e ofruar prej Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore për t’u bashkuar me njëra tjetrën, apo për t’u angazhuar në bashkëpunime ndërvendore. Mbi këtë supozim u hartuan edhe ligjet dhe udhëzimet që plotësuan kornizën e decentralizimit fiskal dhe administrativ, e u dizenjuan transfertat ndërqeveritare dhe grantet deri në vitin 2006. Megjithatë, me përjashtim të ndonjë rasti, bashkime vullnetare të NJQVve nuk kanë ndodhur në këta 14 vjet funksionim të njësive të qeverisjes vendore.

Në këto kushte, në vitin 2003 u rimor diskutimi mbi reformën administrativo territoriale, dhe referuar një dokumenti politik përgatitur prej Këshillit të Europës, në vitin 2004 u hartua një draft ligj për riorganizimin administrativo-territorial të vendit. Projektligji përcaktonte një sërë kriteresh, që në thelb synojnë plotësimin e objektivit të sipërpërmendur për njësi të qeverisjes vendore të afta të gjenerojnë të ardhura dhe të ofrojnë në mënyrë eficiente funksionet e përcaktuara nga ligji. Draft ligji nuk gjeti konsensusin politik dhe si i tillë nuk u miratua nga parlamenti.

Viti 2005 shënon një tjetër moment të rëndësishëm në procesin e decentralizimit të qeverisjes, dhe me ndryshimin e qeverisë ndryshon edhe qasja strategjike në procesin e decentralizimit fiskal. Sistemi i transfertave ndërqeveritare e granteve u reformua, duke prezantuar ekualizimin thuajse të plotë fiskal si instrumentin që do të zgjidhte problemin e njësive të vogla dhe shumë të vogla vendore për të gjeneruar të ardhura dhe ofruar shërbime për qytetarët. Kjo qasje, e arsyetuar me ruajtjen dhe përmirësimin e demokratizimit të qeverisjes, krijoi në fakt konfuzion në lidhje me atë që përcaktohej në strategjinë e decentralizimit si qeverisje e mirë dhe efektive.

Në të vërtetë, synimi për krijimin e njësive më të mëdha vendore, që ofrojnë shërbime në mënyrë më eficiente e përdorin më mirë burimet financiare dhe i përgjigjen nevojës së përfaqësimit më pranë qytetarit (demokratizimi i qeverisjes) përbën temën kryesore mbi të cilën është përqëndruar diskutimi i deritanishëm.

Si në vitin 1992, ashtu edhe në vitin 2000, ndarja administrativo-territoriale nuk u bazua në studime apo analiza të thelluara të kapacitetit dhe aftësive të njësive të qeverisjes për të kryer funksionet dhe kompetencat e decentralizuara.


Reforma e madhe e decentralizimit në vitin 2000, u bazua në konceptin e decentralizimit simetrik të funksioneve dhe kompetencave pra duke mos bërë dallim në madhësinë e njësive të qeverisjes vendore apo kapacitetet e tyre për kryer këto funksione.

Kalimi drejt modelit të qeverisjes nëpërmjet decentralizimit pas vitit 1992 dhe reformës së decentralizimit administrativ dhe fiskal që u miratua me ligjin organik të qeverisjes vendore në vitin 2000, natyrshëm do duhej të shoqërohej me një ndryshim në stukturën e organizimit administrativo-territorial të vendit. Shumica e studimeve dhe analizave për qeverisjen vendore në Shqipëri pas viti 2000, evidentuan fragmentimin e madh të territorit dhe numrin shumë të madh të NJQV-ve, që kanë popullsi shumë të vogël dhe burime dhe kapacitete shumë të ulta. Fragmentimi i territorit si dhe njësitë e vogla të qeverisjes vendore renditeshin ndër arsyt kryesore të inefiçencës së lartë në kryerjen e shërbimeve publike në nivel vendor dhe mos arritjen e objektivave të reformës së decentralizimit nga pjesa më e madhe e njësive të qeverisjes vendore në Shqipëri, si dhe mungesës së zhvillimit të ekonomisë rajonale dhe ekonomisë së shkallës në tërësi.

Megjithëse, në vitin 2014 u miratua reforma e re territoriale vihet re se aktualisht ekziston akoma një mungesë të ndërlidhjet së zhvillimit rajonal dhe të decentralizimit, nuk janë analizuar dhe vlerësuar nga afër, dhe në të vërtetë, nuk ka konsensus se në çfarë niveli duhet aplikuar politika e zhvillimit rajonal. Megjithatë, kjo bazë është jo e plotë dhe jo e qartë në orientimin e zhvillimit ekonomik rajonal.

Modeli i zhvillimit rajonal i zbatuar nga viti 2009 e në vazhdim ²⁴(sipas skemës së mëposhtme) orientohet skematikisht nga i)objektivat ii)fokusi gjeografik iii)strategjia iv)aktorët dhe mjetet, nëse do ti marr në konsideratë secilin prej tyre dalim në konkluzionin se aktualisht përvec përfshirjes së aktorëve dhe mjeteve sic janë grantet të cilat jepen nga pushteti qendror për atë lokal elementët orientues si politikat, strategjitë apo objektiva konkrete për zhvillimin rajonal nuk ekzistojnë.

²⁴ Dokumenti I platforms se zhvillimit rajonal



Skema – Orientimi i politikës së zhvillimit rajonal


Ekzistencën e konceptit të metabolizmit rajonal, përvce në miratimin e instrumentave ligjor organizativo-institucional të mësipërm gjithashtu e gjejmë dhe në instrumentat e zhvillimit të territorit. në politikat dhe në konceptin e zhvillimit fizik të territorit . Territori është më tepër se sa një linjë në hartë, është një karakteristikë thelbësore e jetës politike dhe sociale. Ai siguron kornizën e duhur për ndërveprim politik, social, marrëdhënie ekonomike dhe identitet. Për shtetin modern, territori është i rëndësishëm në dy aspekte: fuqizon shtetin si një parim dominimi dhe kontrolli – autoriteti dhe legjitimiteti i shtetit kufizohet në baza territoriale; strukturon sistemin e përfaqësimit dhe të pjesëmarrjes brenda tij. Gjithashtu, territori inkurajon ndërveprimin ekonomik dhe formaton në mënyrë të ndërsjellë strukturën e tregjeve, është një faktor në riprodhimin e kulturës, gjuhës, zakoneve dhe bazë për identitetin dhe solidaritetin kolektiv. Sipas Durkheimit, "... kriteri territorial është kyç në ndarjen e punës dhe organizimin e shoqërisë dhe sa më sipërfaqësore të jetë ndarja dhe

kufijtë territoriale, aq më i avancuar është një popull” (Keating, 1998). Edhe me zhvillimin e teknologjisë dhe të formave të avancuara të komunikimit, territori nuk e humbet vendin e tij qendror. Në fakt, rëndësia e tij sociale është riformatuar si rezultat i lidhjeve të tij të ngushta me politikën. Territori është baza kryesore për mobilizim politik, identitete politike, përfaqësim politik, përgjegjshmëri politike dhe politika publike.

Në këtë kontekst, konceptin territorial e gjejmë të zhvilluar si pjesë e politikave publike në Shqipëri nëpërmjet hartimit të Planit të Përgjithshëm Kombëtar (PPK) ²⁵ i cili paraqet 3 tipologji rajonesh:

- 1.1. Rajone NDERKUFITARE
- 1.2. Rajone EKONOMIKE KOMBETARE
- 1.3. Rajone TE SPECIALIZUARA

1.1. Rajonet ndërkufitare burojnë nga politikat e kohezionit të Komisionit Europian dhe asistencën që jepet në kuadër të instrumentit të asistencës së Bashkimit Europian IPA (Shqipëri-Greqi, Shqipëri-Maqedoni, Shqipëri – Kosove, Shqipëri- Mal I Zi). PPK paraqet **8 rajone** me karakter të tilla.



Harta1. Tipologjitë e rajoneve sipas (PPK)


1.2. Rajone ekonomike kombetare

Aktualisht si një rajon i tillë i mirefillte përformon vetëm rajoniekonomik Tirane Durres, por Plani Kombëtar 2030 përcakton projekte strategjike për fuqizimin edhe të **6 rajoneve** të tjera me rëndësi kombetare.

- Portat e veriut (rajoni Shkoder-Lezhe dhe Kukes-Has-Tropoje)
- Motori qendror (Rajoni ekonomik Tirane-Durres)
- Rajoni ekonomik Vlore-Berat-Lushnje-Fier

²⁵ Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) miratuar në qershor 2016

- Rajoni Ekonomik Elbasan-Pogradec-Korce
- Porta Jugore e Shqipërisë (rajoni ekonomik Gjirokaster-Sarandë)



Harta 2. Rajonet ekonomike

1.3. Rajone te specializuara

Diber-Mat-Bulqize

Rajoni ka tipare komplekse si të turizmit malor, natyror dhe atij balnear. Por vlerat e specializimit të këtij rajoni qëndrojnë në nxjerrjen dhe përpunimin e minerareve, zhvillimin e industrisë dhe teknologjisë përpunuese të minerareve.

Malesi e Madhe Tropoje

Ky është një nga rajonet me pak të aksesuara deri me sot por me vlera të larta për zhvillimin e turizmit malor; Boga, Thethi, Lugina e Valbonës, Maja e Jezercës dhe liqenet artificiale të Firezës dhe Komanit janë ndër zonat më peisazhistike të rajonit.

Mirdite-Puke-Fushe Arrez


Vlerat e specializimit të këtij rajoni qëndrojnë në

nxjerrjen dhe përpunimin e minerareve, zhvillimin e industrisë dhe teknologjisë përpunuese të minerareve. Gjithsesi rajoni ka tipare të vecanta natyrore peisazhistike që duhen ruajtur e zhvilluar në komplementaritet për rritjen e cilësisë së jetës.

Skrapar-Permet-Kelcyre

Profili turizëm natyror aventurës, bujqësi dhe blegtari.

Zhvillimi i industrisë përpunuese ushqimore



Harta 3. Rajonet e specializuara

Sic u theksua dhe më lartë në veçanti, copëzimi i territorit ka krijuar pabarazi të theksuara ndërmjet bashkive, rajoneve dhe sektorëve zhvillimor rajonal duke bërë që zhvillimi të ekonomisë rajonale të një tipar të theksuar asimetric; ndonëse kompetencat dhe autoritetet janë transferuar në mënyrë plotësisht simetrike.

Bashkëpunimi ndërvendor, si një zgjidhje e ndërmjetme për vende të ngjashme me tablo të copëzuara të qeverisjes vendore, nuk ka funksionuar për vite me radhë në Shqipëri, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme të disa partnerëve ndërkombëtarë për të mbështetur nisma të ngjashme. Po ashtu, bashkitë dhe komunat nuk kanë qenë të gatshme të delegojnë kompetencat e tyre as në nivelin e dytë

të qeverisjes vendore, në rastet kur shërbimet apo projektet nuk kanë rezultuar eficiente për njësi aq të vogla.

Mungesa e vullnetit të zyrtarëvevëndorë për të deleguar pushtetin e tyre, krahas sjelljes së ngurtë dhe shumë burokratike të administratës qendrore i kanë penguar format e bashkëpunimit vullnetar ndërmjet njësive. Kjo situatë ka prodhuar ndërçës të vazhdueshme për njësitë vendore, në veçanti për polet erëndësishme të zhvillimit ekonomik si qytetet më të mëdha të vendit, të cilat janë përballur me një *fait accompli* në zhvillimin kaotik dhe të dendur urban në komunat përreth tyre; çka ka sjellë një ngarkesë të pajustificuar në infrastrukturën dhe shërbimet e ofruara prej tyre.

Nga ana tjetër, njësitë në skajet më të largëta të vendit janë përballur me mungesën e plotë të instrumenteve për të ndikuar zhvillimin, duke u reduktuar në agjenci paguese të administratës vendore dhe pagesave të varfërisë, të gjitha me fonde nga buxheti i shtetit.

Argumentet e mëposhtme mbështeten në veçanti nga përfundimet e analizës së situatës së qeverisjes vendore për problemet e mundshme të krijuara nga mungesa e qartë e politikave specifike orientues drejt një ekonomie shkalle të qëndrueshme²⁶:

- Ndryshimet demografike të dekadës së fundit kanë sjellë ndryshime drastike të popullësisë duke krijuar “boshatisje” të një pjese të rajoneve veriore me ndikim;
- Niveli i lartë i fragmentimit të NJQV-ve ka penguar thellimin e mëtejshëm të decentralizimit, si rezultat i mungesës së kapaciteteve dhe pamundësisë për të ofruar shërbime me eficiencë të lartë;
- Niveli i lartë i fragmentimit të NJQV -ve ka bërë që edhe demokratizimi i qeverisjes, që ishte objektivi kryesor i ndarjes territoriale të vitit 2000, të mos rezultojë i suksesshëm;
- Procesi i decentralizimit të qeverisjes gjithashtu ka bërë hapa mbrapa. Ai ka rezultuar asimetrik në nivel vendor duke krijuar pabarazi mes NJQV-ve në ofrimin e shërbimeve për qytetarët;
- Gjatë viteve të fundit është rritur pesha e shpenzimeve administrative në nivel vendor, po ashtu si edhe vlera absolute, pavarësisht rënies së shpenzimeve në përgjithësi. Njësitë më të vogla vendore kanë tendencën të kenë buxhete të dominuara nga shpenzimet e personelit;
- Një numër i madh njësish vendore nuk mbledhin asnjë të ardhur të vetën dhe nuk ofrojnë shërbime për qytetarët e tyre.
- Fragmentimi i shërbimeve publike (transporti publik, ujësjellësit, trajtimi i mbetjeve urbane, etj.), kryesisht si rezultat i potencialit të ulët të NJQV-ve për të gjeneruar të ardhura dhe kryer investime;
- Fragmentimi i NJQV-ve i pasuar edhe nga procesi i lënë përgjysmë i decentralizimit ka krijuar një sërë pabarazish të ndjeshme mes NJQV-ve, të cilat pavarësisht disa përpjekjeve për t’u adresuar nëpërmjet granteve ekualizuese kanë nevojë të zgjidhen përfundimisht;

²⁶ Argumenta plotësues sipas Ligj nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

2.5 INSTRUMENTAT E RAJONALIZIMIT

Aktualisht në Shqipëri institucionet publike qendrore apo lokale procedojnë në funksion të rajonalizimit nëpërmjet një sërë instrumentash si: Karta e Autonomisë Vendore, Kushtetuta e shtetit shqiptar, Legjislacioni për pushtetin vendor, Legjislacioni ende draft për zhvillimin rajonal, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.

Karta e Autonomisë Vendore²⁷: Pushteti që u jepet njësive vendore është i plotë dhe përjashtimor²⁸ dhe nuk preket nga autoritete të tjera qendrore dhe rajonale, përveçse nëse në ligj specifikohet ndryshe.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: Qeverisja vendore në Shqipëri ngrihet sipas parimit të decentralizimit dhe ushtrohet në bazë të parimit të autonomisë vendore. Qarku, si niveli i dytë i qeverisjes vendore, përbëhet nga disa njësi bazë të qeverisjes vendore me lidhje tradicionale, ekonomike dhe sociale dhe të interesave të përbashkëta. Qarku është njësi ku ndërtohen dhe zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikën shtetërore.

Ndër instrumentet kryesore të financimit në Shqipëri, Fondi i Zhvillimit Rajonal (FZHR) është instrumenti kyç financiar për zhvillimin rajonal. FZHR është një instrument i themeluar nga Qeveria Shqiptare. Funksionimi i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR), për herë të parë u bazua në ligjin nr. 10190, datë 26.11.2009, "Për buxhetin e shtetit 2010". Duke filluar nga viti 2009, (FZHR) është bërë pjesë e ligjit të përvitshëm të buxhetit. Para ngritjes së FZHR ka funksionuar Grantet Konkurruese, për të cilat ka shërbyer si organ vendimmarrës Komiteti për Shpërndarjen e Grantit Konkurrues. FZHR përbëhet nga grantet konkurruese për infrastrukturën lokale, qendrat urbane, arsimin (arsimi bazë, parauniversitar dhe arsimi universitar, shëndetësinë, objektet kulturore, sistemin ujësjellës-kanalizime, ujëjitjen dhe kullimin, pyllëzimin. Qëllimi i ngritjes së FZHR-së ka qenë: Mbështetja e Njësive të Qeverisjes Vendore dhe institucioneve si Universitetet dhe Bordet e kullimit me grante për projekte investimesh, sipas fushave të miratuara. Vendimmarrja për fondet e FZHR kryhet nga Komiteti për Zhvillimin Rajonal, i ngritur sipas ligjit nr. 10190, datë 26.11.2009. Ky komitet kryesohet nga Kryeministri, me anëtarët e mëposhtëm: FZHR ka kontribuar me rreth 40-50 milionë euro në vit për projekte të investimeve publike

Qëllimi përfundimtar i FZHR është rritja e aftësisë konkurruese të rajoneve, duke siguruar që rajonet të kenë një zhvillim të qëndrueshëm social-ekonomik të komuniteteve, duke përdorur burimet e tyre unike, në mënyrë që vendi të bëhet më konkurrues në nivel global. Gjithashtu, FZHR ka për qëllim të rrisë kohezionin rajonal, duke reduktuar pabarazitë e larta në shfrytëzimin e burimeve, produktivitetin dhe standardet sociale dhe mjedisore. Praktikën e tanishme të FZHR, megjithë mbështetjen e tyre financiare në formë të ndryshme për disa nga nevojat dhe prioritetet e vendosura nga qeveritë lokale, kanë kufizimet e tyre në promovimin e një koncepti të zhvillimit lokal dhe


²⁷ Ratifikuar nga parlamenti shqiptar në vitin 1998.

²⁸ Pushteti ekskluziv

rajonale dhe ekonomike të shkallës, në kërkesat për standardet e programimit dhe të cilësisë teknike të projekteve, në kufizimin brenda disa fushave të investimeve të infrastrukturës si dhe në kriteret e aplikuar të vlerësimit socio-ekonomik. Sistemi i FZHR është mjaft kompleks dhe ende nuk është në përputhje me kërkesat e BE-së në kontekstin e IPA dhe Fondeve Strukturore." (ISD, 2010). Sipas vlerësimit për FZHR nga projekti "Integrated Support for Decentralization" (ISD) në 2010²⁹, FZHR është një instrument kryesisht fiskal dhe nuk është qeverisur nga një politikë specifike ose orientim i qartë strategjik. Edhe pse sistemi është përmirësuar (përmes kriterëve të rishikuar në 2012), ky aspekt i FZHR-ndë duhet arritur. Përveç kësaj, "në lidhje me ndërhyrjet BE/IPA në zhvillimin rajonal, FZHR tregon karakteristikat e kufizuara të programit, të tilla si: justifikimin i kufizuar i ndërhyrjes, mungesa e treguesve të arritjeve dhe monitorimi i dobët, mungesa e vlerësimit të duhur, etj" (ISD, 2010). Që nga viti 2010, Departamenti i Programit të Zhvillimit, Financimit dhe Ndihmës së Huaj (DPDFFA) ka punuar në përmirësimin e sistemit konkurrues të FZHR (dmth kriteret e saj). Gjatë 2011-2012, aplikimi i projekteve pwr grante wshtw zhvilluar një sistem elektronik on-line të aplikimit nëpërmjet internetit. Sistemi është bërë funksional në fund të dhjetorit 2012³⁰.

Gjatë 2010-2013 qasja e ndjekur nga FZHR u orientua drejt përmbushjes së nevojave të infrastrukturës bazë të NJQV-ve, promovimit të zonave të pafavorizuara, Shihni figurën më poshtë, e cila ofron një pasqyrë të FZHR ndër vite:

Figura 5. Fondi i Zhvillimit Rajonal ndër vite




*2009 – 2015 FZHR i implementuar

²⁹ "Integrated Support for Decentralization Project" është një projekt i financuar nga EU-UNDP. Përfutuesi direkt i projektit është Ministria e Integrimit. Projekti është implementuar nga United Nations Development Programme (UNDP), Zyra për Shqipërinë me asistencë teknike (2009 – 2012) nga ECORYS, OPM dhe Co-PLAN consortium.

³⁰ Raporti 3 mbi Zhvillimin Rajonal: Institutional Capacity Mapping and Financing Mechanisms përgatitur nga Austrian Development Agency, nëpërmjet Programit të EC IPA për 2008. Kjo është një iniciativë e ndërmarrë nga Departamenti i Programit të Zhvillimit, Financimit dhe Ndihmës së Huaj (DPDFFA), në zyrën e Kryeministrit të Shqipërisë.

Në mënyrë skematike, evolimi i programeve të FZHR si dhe objektivave, paraqitet në vijim:



FZHR ka potencialin për të qenë i zhvilluar dhe i pajisur me një qasje bazuar në program dhe indikatorë të performancës, për të plotësuar mbështetjen e BE-së për zhvillimin rajonal. Konsolidimi i mëtejshëm i FZHR si një instrument për ZHR kërkon jo vetëm një orientim strategjik të zhvilluar mirë dhe një lidhje të mirë me kërkesat e BE për ZHR, por edhe përmirësimin e qasjes konkurruese (nevojitet më shumë punë për këtë kriter), thjeshtimin e strukturës institucionale (shumë aktorë marrin pjesë në zbatimin e disa funksioneve), dhe një qëndrim të qartë në lidhje me përfshirjen e qarqeve. Përveç kësaj, FZHR ka nevojë për zgjerim, përmirësim të fokusit në fushat prioritare dhe projektet rajonale, funksione më të mira të menaxhimit dhe transparencë më të madhe. FZHR duhet të rishikohet dhe të modelohet si instrumenti themelor për të ndërtuar kapacitetin thithës të aktorëve nën-kombëtare për fondet e zhvillimit, së bashku me ndonjë burim të jashtëm (të BE-së, donatorëve bi-lateral dhe donatorë të tjerë ndërkombëtar)³¹.

Në këtë këndvështrim, FZHR duhet të jetë në një linjë me kuadrin strategjik të BE-së për zhvillimin rajonal dhe, siç tregohet në përvojën ndërkombëtare, duhet të jetë e bazuar në një reformë të jashtme. Investimet publike duhet të fokusohen fillimisht në polet e rritjes, si motori i ekonomisë së vendit, dhe në fazat e mëvonshme mund ti jepet prioritet politik objektivit të barazisë hapësinore, në mënyrë që investimet të drejtohen në rajonet e prapambetura.

Duke u bazuar në atë që theksuam më lart mund të pohojmë që në një kohe kur Shqipëria ka hyre në rrugën e rajonalizimit por në kwtw proces krijohen edhe momente që kërkojnë reflektim dhe riadresim përmes masash korrektive. Në këtë kontekst 1) Analiza e mësipërme paraqet tre sfida kryesore për shoqërinë dhe politikën shqiptare:

³¹ibid faqe 12

1. Të bashkohemi me tendencën botërore – rajonalizimi, çka do të mundësonte integrimin shoqëror me vendet drejt të cilave tentojmë të shkojmë;
2. Të Integrohem në BE – sigurisht së pari përmes respektimit të marrëveshjeve dhe afateve;
3. Të Korrigjojmë ecurinë e Decentralizimit, për të arritur qëllimet e synuara të tij në një kohë më të shkurtër dhe me sa më pak kosto për shoqërinë shqiptare.

Adresimi i këtyre sfidave kërkon që aktorët të kenë së pari një kuptim të përbashkët mbi çështje të Rajonalizimit, Zhvillimit Rajonal, etj. Kjo do të na vendoste në baza të njëjta analize, diskutimi dhe vendimmarrjeje. Më tej, janë **3 alternativa politike** midis të cilave mund të zgjedhim:

1. **Statukuo (Status Quo), Zhvillim Rajonal:** Kjo alternativë nënkupton: ruajtjen e sistemit të qeverisjes së pandryshuar dhe si rezultat edhe instrumentet përkatëse të pandryshuara; forcim të kapaciteteve të administratës me qëllim përmbushjen e suksesshme të qëllimeve të decentralizimit dhe thithjen dhe manaxhimin e fondeve për zhvillim rajonal; thithje të fondeve nga BE dhe integrim në BE. Sistemi i pandryshuar i qeverisjes lidhet me ruajtjen e strukturës së qeverisjes vendore dhe të rolit dhe përgjegjësisë të njësive vendore të të dyja niveleve, dhe sigurisht, edhe të institucioneve të dekoncentruara. Nuk kryhet reformë territoriale.
2. **Perspektive Territoriale:** Kjo alternativë është e njëjtë me alternativën e parë, përveç faktit se lejon të kryhet reformë territoriale. Në këtë alternativë, ndryshimi është i pjesshëm.
3. **Rajonalizim:** Kjo alternativë nënkupton një ndryshim radikal në sistemin e qeverisjes dhe çdo aspekt tjetër të lidhur me të, sigurisht, pa prekur parimin e decentralizimit dhe të subsidiaritetit. Ndryshimi i sistemit të qeverisjes lidhet me qeverisjen vendore dhe/ose formën e dekoncentrimit në Shqipëri. Reforma territoriale vjen si një rrjedhojë natyrore e ndryshimit të sistemit të qeverisjes, dhe lloji i reformës do të varet nga forma e re e qeverisjes. Nuk preket parimi i decentralizimit dhe i subsidiaritetit, por lihet vend për rajonalizim. Nuk ndryshon fakti që punohet në drejtim të forcimit të institucioneve, thithjes së fondeve nga BE dhe integritetit në BE.

Të tria alternativat mund të zërthehen në *skenarë* të mundshëm për t'u zbatuar. Cilado qoftë alternativa e zgjedhur, ajo nuk duhet të jetë e imponuar, por të respektojë interesat e aktorëve dhe të marrë parasysh se secili nga skenarët në çdo alternative ka kosto aktuale dhe afatgjata. Peshimi i tri alternativave jep përgjigje në nivel politikash për qeverinë. Të tria alternativat kanë impakt politik, ekonomik dhe në territor. Alternativa e parë nuk sjell ndryshim aktual, por shoqërohet me koston afatgjatë të mos-ndryshimit. Alternativa e dytë, si rezultat i ndryshimit të pjesshëm, shoqërohet me kosto afatgjata dhe afatshkurtra, zgjidh disa probleme por mund të krijojë të reja. Alternativa e tretë shoqërohet me koston afatshkurtër të ndryshimit.

Ky i fundit implikon riorganizim territorial dhe kufijtë territorialë duhet të jenë rezultat dhe përkthim në territor i zgjedhjeve në rang politikash ekonomike dhe sociale. Sigurisht që forma e rajonalizimit në Shqipëri dhe riorganizimi territorial mund të kryhen sipas opsioneve të ndryshme, të cilat për lehtësi analize mund të grupohen në tri rangje: ruajtje e gjëndjes ekzistuese, perspektivë territoriale dhe rajonalizim bazuar në basenet ujëmbledhëse. Cilado qoftë alternativa e zgjedhur, ajo duhet të vijë përmes debatit konsensual, bazuar në një analizë të strukturuar sipas kritereve, koston dhe vullnetit në vendimmarrje.

KREU 3

METODAT DHE PROCEDURAT E KËRKIMIT

3.1 ANALIZA FAKTORIALE – METODA QË EVIDENTON FAKTORËT

Qëllimi i këtij disertacioni është evidentimi i sektorëve që çojnë në rritjen ekonomike të rajoneve në Shqipëri. Për t'i gjetur këto faktorë mund të përdoret analiza faktoriale. Çfarë është analiza faktoriale? Analiza faktoriale është një teknikë, që ka si qëllim kryesor përcaktimin e strukturës lidhëse të variablave në një analizë. Është më se e kuptueshme se variablat luajnë një rol kyç në çdo analizë multivariate. Në gjuhën e thjeshtë, analiza faktoriale ka mjetet për të analizuar strukturën e marrëdhënies së brendshme (korrelacionet) të një numri të madh variablash, duke përcaktuar grupin e variablave që kanë lidhje të fortë ndërmjet tyre, të njohur si *faktorë*. Këto grupe variablash (faktorësh), janë supozuar të prezantojnë dimensionet e të dhënave. Nëse kërkohet vetëm të reduktohet numri i variablave, atëherë këto dimensionet mund të çojnë në krijimin e matësve të rinj: nga shumë variabla në disa faktorë. Gjithsesi, nëse ekziston një bazë konceptuale për kuptimin e lidhjeve mes variablave, atëherë dimensionet mund të kenë kuptim për çfarë kolinariteti paraqet. Një dimension mund të korrespondojë me konceptin që nuk mund të jetë adekuat duke u përshkruar vetëm nga një matës.

Guido Tabellini, në një material diskutimi me titull “Culture and institutions: economic development in the regions of Europe” i botuar nga CESIFO në vitin 2005, ka përdorur analizën e komponentit kryesor për t'i dhënë zgjidhje problemit të tij. Abdoulkarim Esmaeili dhe Zainab Shokoohi në vitin 2012, në një artikull të revistës Energy Policy, me titull “Assessing the effect of oil price on world food prices: Application of principal component analysis”. Edhe këta autorë e kanë përdorur këtë analizë për të identifikuar faktorët kryesor të problemit të çmimit botëror të naftës. Po ashtu, James B. Ang dhe Warwick J. McKibbin kanë botuar në vitin 2007 një artikull në revistën prestigjioze Journal of Development Economics me titull “Financial liberalization, financial sector development and growth: Evidence from Malaysia”. Në këtë artikull autorët kanë përdorur analizën e komponentit kryesor për të realizuar një pjesë të qenësishme të kërkimit të tyre. Edhe Kenneth Temkin dhe William M. Rohe kanë përdorur analizën e komponentit kryesor në studimin e tyre. Ata kanë shkruar një artikull me titull “Social Capital and Neighborhood Stability: An Empirical Investigation” në revistën Housing Policy Debate në vitin 1998.


Analiza faktoriale është *eksploruese* dhe *konfirmuese*. Garson (2008) i përshkruan kështu të dy metodat:

- *Analiza faktoriale eksploruese* kërkon të zbulojë strukturën që qëndron poshtë një grupi relativisht të madh të variablave. Supozimi *à priori* i hulumtuesit është se çdo tregues mund të lidhet me çdo faktor. Kjo është forma më e zakonshme e analizës faktoriale. Nuk ka asnjë

teori paraprake dhe përdoren ngarkesat e faktorit për të përcaktuar me intuitë strukturën e faktorit të të dhënave.

- *Analiza faktoriale konfirmuese* synon të përcaktojë nëse numri i faktorëve dhe ngarkesave të variablave (treguesve) të matura në to konfirmon atë që pritet në bazë të teorisë së parakrijuar. Variablat tregues janë përzgjedhur në bazë të teorisë së mëparshme dhe analiza e faktorit është përdorur për të parë nëse ata peshojnë siç parashikohet në numrin e pritshëm të faktorëve. Supozimi *à priori* i kërkuesve është që secili faktor (numri dhe emërtimi i të cilit mund të jetë specifikuar *à priori*) është i lidhur me një nëngrup të specifikuar të variablave tregues. Një kërkesë minimale e analizës faktoriale konfirmuese është se supozohet paraprakisht numri i faktorëve në model, por zakonisht edhe studiuesi do të parashtrojë pritjet për atë se cilët variabla do të peshojnë (ngarkojnë) në cilët faktorë. Studiuesi kërkon për të përcaktuar, për shembull, nëse matësit e krijuar për të përfaqësuar një variabël latent shkojnë me të vërtetë së bashku.

Etapat e analizës faktoriale janë shtatë, të cilat ilustrohen nga figura në vijim.

Faza 1

Çfarë presupozon secila fazë:

1) Faza 1: Problemi i kërkimit

Pyetja që shtrohet është: analiza do të jetë eksploruese apo konfirmuese? Nëse analiza faktor është përdorur për reduktimin e të dhënave dhe/ose përmbledhjen e tyre, studiuesi duhet gjithmonë të ketë parasysh mbështetjen konceptuale të variablave dhe të përdorë gjykimin ashtu si për përshtatshmërinë e variablave për analizën e faktorit. Natyrisht, përdorimi i analizës faktoriale si një teknikë e përmbledhjes së të dhënave është bazuar në të paturit e një baze konceptuale për çdo variabël të analizuar. Por edhe nëse përdoret vetëm për reduktimin e të dhënave, analiza faktoriale është më efikase kur dimensionet e përcaktuara konceptualisht mund të përfaqësohen nga faktorët që rrjedhin.

E megjithatë analiza do të jetë *analizë eksploruese*. Është e arsyeshme të mendojmë se poshtë nënfaktorëve të grupuar sipas kriterëve të caktuara (përmbajtjes së tyre, fushave, politikave publike të cilave u përkasin apo kriterëve të tjera që janë parë të arsyeshme në grupimin e tyre), të konfirmuara nga literatura, përvoja apo kushtet konkrete të vendit, mund të ketë vlerësime të investitorëve që shkojnë në një drejtim të caktuar apo që mund të marrin prej tyre një vlerësim të caktuar e, për pasojë, që mund të formojë faktorë apo përkufizime më të gjera të asaj që ata përfaqësojnë.

Objektivat e analizës faktoriale. Në këtë analizë ne jemi të interesuar:

- si për *zbulimin e konstrukteve latent ('të fshehura')* poshtë të dhënave të marra nga përgjigjet e investitorëve;
- ashtu dhe për *përmbledhjen e të dhënave dhe krijimin e matësve të rinj* të përbërë për t'i përdorur ata në teknika të tjera të analizës.

2) Faza 2: Projektimi i analizës së faktorit

Objekt i analizës do të jetë struktura e variablave dhe jo e të anketuarve. Si e tillë, analiza faktoriale është *analizë e llojit R*.

Variablat që do të përfshihen në analizë janë variabla shkalle. Këta variabla cilësorë janë matur nëpërmjet pyetjes së agjentëve publik dhe privat. Vlerësimi i perceptimit të tyre për secilin variabël është bërë me shkallën Likert me 5 nivele.

Madhësia e mostrës. Sipas Hair et al. (2010) duhet të ketë më shumë vëzhgime sesa variabla. Madhësia minimale absolute e mostrës duhet të jetë 50 vëzhgime. Në rastin e këtij disertacioni janë bërë 95 vëzhgime.

3) Faza 3: Supozimet në analizën faktor

Normaliteti, lineariteti, dhe homoskedasticiteti. Supozimet themelore statistikore ndikojnë analizën faktoriale në masën që ato ndikojnë në korrelacionet e gjeneruara. Shmangiet nga normaliteti, homoskedasticiteti, dhe lineariteti mund të zvogëlojnë korrelacionet mes variablave (Hair et al., 2010).

Në analizën faktoriale supozohet *normalitet* i kombinimeve lineare të shumëfishta (multivariate), d.m.th. që variablat, dhe kombinimet lineare të variablave, janë të shpërndara normalisht. Gjithashtu nënkupton se marrëdhëniet mes çifteve të variablave janë *lineare*.

Për aq kohë sa analiza e komponentit kryesorë dhe analiza faktoriale përdoren në mënyrë përshtatshme si mënyra të përshtatshme për të përmbledhur marrëdhëniet në një grup të madh të variablave të vëzhguar supozimet lidhur me shpërndarjet e variablave nuk janë të aplikueshme. Nëse variablat janë të shpërndarë normalisht, zgjidhja përmirësohet. Nga pikëpamja statistikore, largimet nga normaliteti, homoscedasticiteti, dhe lineariteti zbatohen vetëm në masën që ato zvogëlojnë korrelacionet e vërejtura. Në fakt, disa nivele (shkallë) të *multikolinearitetit* janë të dëshirueshme, sepse objektivi është për të identifikuar grupe të ndërlidhura të variablave.

Përshtatshmëria e matricës së korrelacionit R për analizën e faktorit. Matrica e korrelacionit R është tabela që tregon interkorrelacionin mes të gjithë variablave. Cilësia e këtyre korrelacioneve është indikacioni i parë dhe shumë i rëndësishëm për analizën faktoriale.

Mastësi i përshtatshmërisë së mostrave. Matës që llogaritet si për matricën e plotë të korrelacionit dhe për çdo variabël individual duke vlerësuar përshtatshmërinë e aplikimit të analizës së faktorit.

Homogjeniteti i mostrës. Mostra duhet të jetë homogjene.

Lidhjet konceptuale. Supozimet themelore konceptuale të analizës faktoriale lidhen me grupin e variablave të përzgjedhur dhe mostrën e zgjedhur.

4) Faza 4: Përzgjedhja e një Metode Faktoriale

Analiza faktoriale e komponentit është më e përshtatshme kur reduktimi i të dhënave është një shqetësim kryesor, ndërsa analiza faktoriale e përbashkët është më e përshtatshme kur objektivi kryesor është për të identifikuar dimensione të fshehura ose konstrukte që përfaqësojnë variablat origjinale

Specifikimi i Matricës Faktoriale. Përcaktimi i numrit të faktorëve për t'u mbajtur. Nuk ka një kriter të vetëm për përcaktimin e numrit të faktorëve. Kriteret që përdoren më shpesh në literaturë janë:

- *Rregulli i Kaiser-it ose Kriteri i vlerave të veta.* Sipas këtij kriteri mbahen të gjithë komponentët me vlerat e veta më të madhe se 1. Ai mund të mbivlerësojë ose nënvlerësojë numrin e vërtetë të faktorëve; shumica e të dhënave të studimeve simuluese sugjeron se ai zakonisht mbivlerëson numrin e vërtetë të faktorëve. Këtu janë përcaktuar numri i faktorëve mbështetur në literaturë.
- *Testi i pjerrësisë.* Testi i pjerrësisë i Cattell-it paraqet në një diagramë faktorët (në boshtin e abshisave) dhe vlerat e veta përkatëse të tyre në boshtin e ordinatave). Vlerat e veta paraqiten në rend zbritës, fillojnë nga më e larta në faktorin e parë dhe deri te më e vogla në faktorin e fundit. Kjo zbritje zakonisht nuk është uniforme. Në këtë kurbë kërkohet pika e parë e infleksionit. Mbahen aq faktorë sa janë para pikës së infleksionit. Kjo mënyrë ka kritikët e saj të cilët theksojnë se pika e infleksionit mund të përcaktohet në mënyrë subjektive. Kriteri i pjerrësisë mund të rezultojë në më pak ose më shumë faktorë se kriteri Kaiser. Por gjithsesi nuk ka konsensus nëse faktori ku është pika e infleksionit duhet mbajtur apo jo.
- *Kriteri i variancës së shpjeguar.* Sipas këtij kriteri, varësisht nga qëllimi i studimit, mbahen aq faktorë sa të shpjegojnë një përqindje të caktuar të variancës. Kjo përqindje varion nga 50 % deri në 80-90 %, por nuk ka asnjë prag gjerësisht të pranuar. Në

shkencat shoqërore, ku informacioni është shpesh më pak i saktë, është e zakonshme që të konsiderojmë një zgjidhje si të kënaqshme kur llogaritet për 60 për qind të variancës së përgjithshme (dhe në disa raste edhe më pak).

- *Testi i vlefshmërisë së numrit të faktorëve.* Për të verifikuar nëse zgjedhja e numrit të faktorëve është e vlefshme përdoret matrica e mbetjeve të korrelacionit, që është matrica e diferencave midis korrelacioneve të riprodhuara dhe aktuale. Sa më të ulëta ose të parëndësishme të jenë këto korrelacione, aq më shumë shanse ka që zgjedhja e numrit të faktorëve të jetë ‘e duhura’.

Përzgjedhja e një Metode Rrotullimi.

Duke qenë se do të krijohen matës të rinj të përbërë që matin një koncept të shumanshëm (që nuk mund të matet me një karakteristikë të vetme) dhe që do t'i përdorim gjithashtu në teknika të tjera të analizës multivariate (shumëfaktoriale, do t'i përdorim si variabla të pavarur në analizën e regresionit logjistik), faktorët kërkohen të pavarur nga njëri-tjetri. Rrotullimi ortogonal (kënddrejtë) na jep faktorë të palidhur me njëri-tjetrin, prandaj do të përdorim këtë lloj rrotullimi.

5) Faza 5: Interpretimi i Matricës së Faktorit të Rrotulluar

A mund të gjenden ngarkesa të rëndësishme? Nuk ka një kufi të vetëm që një ngarkesë të konsiderohet e rëndësishme dhe variabli me atë ngarkesë të konsiderohet pjesë e faktorit në të cilin variabli e ka ngarkesën. Pika e ndërprerjes është arbitrare dhe është caktuar shpesh sipas llojit të disiplinës ku bëhet kërkimi (shoqërore, shkencë ekzakte, etj.), kontaktit të kërkimit, llojit të të dhënave të përdorura, etj. Kështu, pragu i poshtëm në shkencat shoqërore pothuajse në të gjitha studimet pranohet 0.3. Studiuesit sugjerojnë se ngarkesat më të mëdha se 0.71 (50% variancë e mbivendosur) janë konsideruar të shkëlqyera, 0.63 (40 % variancë e mbivendosur) shumë të mira, 0.55 (30% variancë e mbivendosur) të mira, 0.45 (20 % variancë e mbivendosur) jo të këqija, dhe 0.32 (10% variancë e mbivendosur) të varfër.

A janë të mjaftueshme përbashkësitë? A përfshihen të gjithë variablat në zgjidhje? Ka dy mënyra për ta identifikuar këtë: (1) të identifikohet ndonjë variabël që i mungon të paktën një ngarkesë e konsiderueshme; dhe (2) të shqyrtojmë përbashkësitë e secilit variabël.

6) Faza 6: Rispesifikimi i modelit faktorial

Nëse është e nevojshme, bëhet rispesifikimi i modelit faktorial. Nevoja lind në këto raste: (i) kur një variabël nuk ka asnjë ngarkesë të rëndësishme; (ii) edhe me një ngarkesë të rëndësishme, përbashkësia e një variabëli gjykohet se është tepër e ulët; ose (iii) një variabël ka më shumë se një ngarkesë të rëndësishme (një ndër ngarkim).

Rekomandohet kombinim i mjeteve të mëposhtme, të listuara nga ekstremi më i vogël tek më i madhi:

- *Injoroni variablat problematikë dhe interpretoni zgjidhjen në konditat e reja;*
- *Vlerësoni secilin prej atyre variablave për fshirje të mundshme;*
- *Përdorni një metodë alternative rrotullimi;*
- *Pakësoni/ rritni numrin e faktorëve të mbajtur;*
- *Modifiko llojin e modelit të faktorit të përdorur (komponenti kundrejt faktorit të përbashkët).*

Zgjedhja e opsioneve është në varësi të qëllimit të studimit dhe rezultateve të deritanishme të analizës, por kuadri konceptual mbetet primar në zgjedhjen e mjeteve/kombinimit të mjeteve.


Emërtimi i faktorëve

Emërtimi i faktorëve është një proces jashtëzakonisht i rëndësishëm. Ai duhet të mbështetet së pari në kuadrin konceptual. Variablat me ngarkesa më të larta do të kenë ndikim më të madh mbi emrin apo emërtimin e zgjedhur për të përfaqësuar një faktor. Shenjat interpretohen ashtu si në çdo koeficient tjetër korrelacioni. Duke qenë se kemi përdorur rrotullimin ortogonal shenjat kanë të bëjnë vetëm me marrëdhënien e nënfaktorit (variablit) me komponentin ose faktorin dhe jo me faktorët e tjerë.

7) Faza 7: Vlefshmëria i Matricës faktoriale

Në varësi të objektivave të studimit, ka mënyra të ndryshme për “të mbledhur” rezultatet e variablove individuale që formojnë një faktor (ose komponent). Këto mënyra, varësisht nga fakti se përse do përdoren (p.sh. për zbatim të mëvonshëm të teknikave të tjera statistikore), janë:

- *Përzgjedhja e variablove me ngarkesën më të lartë të faktorit si një përfaqësues zëvendësues për një dimension të veçantë të faktorit;*
- *Zëvendësimi i grupit origjinal të variablove me një grup krejtësisht të ri, më të vogël të variablove të krijuar ose nga shkallëzimet përmbledhëse ose rezultatet e faktorit.*



3.2 BESUESHMËRIA E PËRGJIGJEVE TË INTERVISTUARVE

Në pyetësorët e përdorur për këtë disertacion ka disa pyetje për të matur të njëjtin variabël. Për shembull, janë përdorur pyetjet P1, P2 dhe P3 për të matur të njëjtën gjë, variablin X1. Në raste të tilla ka dy mundësi, ose përgjigjet mes pyetjeve kanë pajtueshmëri, ose ato janë kontradiktore. Nëse përgjigjet e pyetjes P1 pajtohen me përgjigjet e dy pyetjeve të tjera, atëherë të tre pyetjet e masin saktë variablin X1. Por nga ana tjetër, ekziston problemi që përgjigjet e marra te pyetja P1 të mos pajtohen me përgjigjet e marra nga pyetjet P2 dhe P3. Nëse shfaqet kjo divergjencë në përgjigjet e marra mes këtyre pyetjeve, atëherë kemi të bëjmë me problemin e besueshmërisë së të dhënave. I intervistuari ka dhënë përgjigje të ndryshme për pyetje që synojnë të matin të njëjtën gjë. Kjo mund të vijë nga disa arsye, por më e shpeshta është se i intervistuari mund të mos jetë serioz me pyetësin, duke e plotësuar atë pa i kushtuar vëmendjen e duhur.

Për të kontrolluar besueshmërinë e të dhënave sugjerohet të përdoret një matës statistikor. Besueshmëri do të thotë që një matës duhet të pasqyrojë në mënyrë të qëndrueshme konstruktin që ai është duke matur. Në këtë disertacion është përdorur koeficienti Cronbach's Alpha për të bërë analizën e besueshmërisë së të dhënave të grumbulluara. Në përgjithësi është rënë dakord mbi kufirin e poshtëm të pranueshëm për Cronbach's Alpha që është 0.70 edhe pse ai mund të zvogëlohet në 0.60 në hulumtimin eksplorues. Kur përdoren shkallë të tipit 1 deri në 5, që njihet si shkalla Liker, është e domosdoshme për të llogaritur dhe raportuar koeficientin Cronbach's Alpha për besueshmërinë e konsistencës së brendshme. Një alfa e lartë tregon se (nën)faktorët e përfshirë në një shkallë ose grup janë të lidhur dhe mund të formojnë një grup kompakt.

Në logjikën e mësipërme, është e nevojshme që faktorët e formuluar nga kombinime variablash, të kontrollohen për nivelin e tyre të besueshmërisë. Një rregull praktik që përdoret për shumicën e situatave dhe që tregon se sa e besueshme është konsistenca e shkallës në varësi të rezultatit të koeficientit Cronbach's Alpha është si në tabelën më poshtë:

Tabela 1. Gjykimi mbi vlerat e koeficientit cronbach alpha

α	$\alpha > 0,9$	$\alpha > 0,8$	$\alpha > 0,7$	$\alpha > 0,6$	$\alpha > 0,5$	$\alpha < 0,5$
Konsistenca	E shkëlqyer	E mirë	E pranueshme	E diskutueshme	E dobët	E papranueshme

3.3 PYETËSORI

Pyetësor u drejtohet individëve që punojnë në administratën publike vendore dhe atyre që kanë informacione lidhur me zhvillimin e rajoneve. Pyetësori u plotësua online në masën rreth 90% nga përfaqësuesit e NJQV, kryesisht përfaqësues së zyrës së urbanistikës, koordinim zhvillimit etj.

Pamje online e pyetësit

← → ↺ <https://docs.google.com/forms/d/1sKXbnZ68aoYieulT12HDAePeJa5Aps72V1kYQlyGkyg/viewform> 🗑️ ☆

Pyetësor për zhvillimin e rajoneve

Ju lutemi, plotësoni këtë pyetësor në mënyrë sa më objektive të jetë e mundur, i cili nuk do u marrë shumë kohë. Qëllimi i tij është vetëm për qëllime kërkimore, duke ruajtur fshehtësinë dhe analiza e të dhënave bëhet vetëm e grupuar.

NEXT 5% complete

Never submit passwords through Google Forms.

This form was created inside of Agricultural University of Tirana. Report Abuse - Terms of Service - Additional Terms

Google Forms

Windows taskbar icons: Windows, Search, File Explorer, Edge, Mail, Calendar, Photos, OneDrive, Word, Excel, PowerPoint, Chrome, Task View.

Pyetësi është ndërtuar me 17 pjesë apo seksione. Në seksionin e parë janë bërë pyetje të përgjithshme dhe filtruese, ndërsa në seksionet e tjera është pyetur për faktorët që mund të përcaktojnë zhvillimin e rajoneve në Shqipëri.

Me synimin për të hetuar sa më shumë lidhur me sektorët ekonomik, në pyetësor janë integruar pyetje të veçanta vetëm për një sektor të caktuar. Këto pyetje në shumicën e rasteve përfaqësojnë edhe dimensionet e një sektori ekonomik. Për shembull, seksioni i pyetjeve L kanë të bëjnë vetëm me sektorin ekonomik të *Turizmit*. Pyetja kryesore e tij është “Në çfarë shkalle është e përfshirë NJA juaj në produktet turistike potenciale (qark/ bashkine tuaj)?” Intervistuesi duhet të përgjigjet nga 1 deri në 5 për secilën nga dimensionet e mëposhtme:

- L1 Agroturizëm?
- L2 Turizëm kulturor/fetar
- L3 Turizëm malor veror
- L4 Turizëm malor dimëror
- L5 Turizëm i rërës dhe detit

Pak më ndryshe funksionon me sektorin ekonomik të *Bujqësisë*, për të cilin janë integruar në pyetësor pyetje të shpërndara në dy seksione. Këto seksione janë N dhe O. Seksioni N ka këtë pyetje kryesore “Cilat janë produktet kryesore për zhvillimin bujqësor dhe rural/peshkimi ne rajonin tuaj (qark/bashki)?” Alternativat e mëposhtme lidhen me dimensionet e sektorit të bujqësisë.

- N1 Zhvillimi i prodhimeve blektorale
- N2 Zhvillimi i prodhimeve bujqësore (fruta, perime)
- N4 Bletari

Po ashtu, seksioni O ka këtë pyetje kryesore lidhur me dimensionet e zhvillimit të sektorit të Bujqësisë. Seksioni O ka si pyetje qendrore “Cilat janë sipas jush aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për të realizuar një potencial rural, bujqësor në (Qarkun/ bashkinë tuaj)?” Në vijim ilustrohen të gjithë dimensionet e këtij seksioni, ku intervistuesi jep vlerësimin e tij nga 1 deri në 5:

- O1 Përmirësimi i aftësive profesionale për agrobujqësi
- O2 Përmirësimi i nivelit të subvencioneve bujqësore
- O3 Përmirësimi i infrastrukturës së tregut të produkteve rajonale
- O4 Promovimi i produkteve bio
- O5 Rritja e lidhjes ndërmjet turizmit dhe përpunimit të produkteve bujqësore
- O6 Përmirësimi i infrastrukturës publike edhe shërbimeve përveç infrastrukturës rrugore
- O7 Përmirësimi i infrastrukturës së transportit publike rurale

Në mënyrë të ngjashme është vepruar edhe me sektorët e tjerë të ekonomisë. Versionin e plotë të 17 pyetjeve mund të gjendet në Aneks. Po ashtu, atje gjendet edhe një pamje online e tij.

KREU 4

REZULTATE DHE INTEPRETIME

4.1 PROFILI MAKRO I RAJONEVE


4.1.1 Popullsia

Lëvizja e popullsisë është një nga fenomenet më prezentë në jetën ekonomike dhe sociale në Shqipërinë e pas vitit 1991. Gjatë viteve 1991-2016, janë shfaqur dy forma lëvizje të popullsisë: lëvizja e popullsisë jashtë dhe brenda Shqipërisë. Të dy format shoqërohen me efekte sociale dhe ekonomike të popullsisë, duke ndikuar drejtpërdrejtë në mirëqenien e individëve.

Lëvizjet e popullsisë jashtë Shqipërisë përbëjnë një rëndësi të veçantë për t'u studiuar, mirëpo nuk është objekt i këtij disertacioni. Me interes të veçantë për këtë disertacion është forma e dytë e lëvizjes së popullsisë: brenda vendit, njohur ndryshe si migrimi i popullsisë. Faktorët që çojnë në migrimin e popullsisë janë të shumtë, por nga më të rëndësishmit janë: kushtet e jetesës, mundësia për t'u punësuar, infrastruktura dhe qasja ndaj shërbimeve publike dhe private. Jo të gjithë rajonet e Shqipërisë reflektojnë standarde të njëjta përsa i përket kushteve të jetesës apo faktorëve të tjerë që u listuan më sipër. Nëse një rajon nuk reflekton standarde të mira të faktorëve të mësipërm, atëherë shtohen shanset që popullsia e atij vendi të migrojë drejt një vendi tjetër, ku këto standarde janë më të mira.

Popullsia rezidente në Shqipëri shënon rënie duke iu referuar nivelit të censusit paraardhës dhe për herë të parë popullsia është e përqëndruar më tepër në zonat urbane. Rreth 2/3 e NJQV-ve pësojnë një ndryshim të popullsisë me rreth 25%. Kjo lëvizje ka patur efektet e saj në njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri, një pjesë prej të cilave është dashur të akomodojë nevojat në rritje të banorëve për shërbime, ndërsa një pjesë e njësive vuajnë pasojat e largimit të banorëve të tyre.

Gjithashtu, vihet re se në dhjetë – njëmbëdhjetë vitet që pasuan paketën e reformave të decentralizimit të ndërmara në vitin 2000, një sërë ndryshimesh demografike, sociale dhe ekonomike kanë ndodhur në vend. Harta demografike e Shqipërisë ka dryshuar si rezultat i lëvizjeve migruese të njerëzve brenda dhe jashtë vendit sic paraqitet dhe më poshtë.



Harta 1 Ndryshimet demografike : Burimi INSTAT, Census 2001:Census 2011

Një nga lëvizjet e popullsisë shumë evidente është lëvizja e saj nga zonat rurale drejt zonave urbane të Shqipërisë. Kryesisht, një lëvizje e tillë e popullsisë bëhet për arsyet e parashtruara më lartë. Në vijim ilustrohen grafikisht tre momente kryesore të popullsisë së qarqeve të Shqipërisë për vitet 2001, 2010 dhe 2016. Kalimi nga një vit në tjetrin jep idenë e lëvizjes së popullsisë, dhe krahasimi me popullsinë gjithsej, rurale dhe urbane e bën më të qartë këto flukse lëvizëse të popullsisë.

Kështu, në vijim ilustrohet në mënyrë grafike popullsia e qarqeve të Shqipërisë për tre momentet kryesore. Tendencat e popullsisë sipas qarqeve për tre momente kohore (viti 2001, 2010 dhe 2016), jepen në grafikun e mëposhtëm. Bie në sy se shumica e qarqeve kanë reflektuar një rënie të numrit të popullsisë dhe vetëm disa prej tyre kanë shënuar rritje të saj. Konkretisht, vetëm qarku i Durrësit dhe ai i Tiranës kanë shënuar rritje të popullsisë, kur kalohet nga viti 2001 në vitin 2010 apo në vitin 2016. Ritmi i rritjes së popullsisë në qarkun e Durrësit konstant mes viteve 2001-2010 dhe 2010-2016, ndërkohë që nuk mund të thuhet e njëjta gjë për rastin e qarkut të Tiranës. Popullsia në Tiranë është rritur më shumë në periudhën 2001-2010 se sa në vitet 2010-2016. Normale që këtu duhet të kemi parasysh se horizonti kohor i krahasimit nuk është i njëjtë, por përsëri e gjithë kjo jep një ide për madhësitë e lëvizjeve të popullsisë.




Figura 1. Popullsia gjithsej sipas qarqeve për vitet 2001, 2010 dhe 2016

Grafiku i mësipërm ilustronte popullsinë gjithsej të Shqipërisë, ndërkohë që interes përbën edhe lëvizja e popullsisë urbane sipas qarqeve. Grafiku i mëposhtëm përpiqet për të krijuar një ide për këtë kategori. Bie në sy luhatja shumë e vogël e popullsisë për disa qarqe siç janë: Berati, Dibra, Elbasani, Fieri, Gjirokastra, Kukësi, Shkodra. Për kontrast, qarqet që kanë më shumë lëvizje të popullsisë urbane janë Durrësi, Tirana, Lezha dhe Vlora. Ndryshe nga situata të popullsisë gjithsej, kalimi nga viti 2001 deri në vitin 2016, të popullsisë urbane shihet rritja e saj jo vetëm në qarqet Tiranë dhe Durrës, por edhe në qarkun Fier, Lezhë dhe Vlorë. Ka shumë gjasa që kjo rritje e popullsisë urbane të vij si pasojë e lëvizjes së popullsisë rurale drejt zonave urbane të këtyre qarqeve.




Figura 2. Popullsia urbane sipas qarqeve për vitet 2001, 2010 dhe 2016

Për kontrast me grafikun e mësipërm, në grafikun e mëposhtëm ilustron lëvizja e popullsisë rurale për qarqet e Shqipërisë. Ashtu siç edhe u prit nga vëzhgimi i dy grafikëve të mësipërm, duket se popullsia rurale ka rënë në të gjitha qarqet e Shqipërisë, kur kalohet nga viti 2001 në vitin 2016. Kjo lëvizje e popullsisë sugjeron se politikat e ndjekura për zhvillimin e rajoneve nuk janë ato të duhurat. Politikatat e zhvillimit të rajoneve duhet medoemos të përfshijnë aspektet e rajoneve. Kujtojmë se

lëvizjet e popullsisë për vendin pritës përkthehet, mes të tjerave, edhe një fuqi punëtore dhe një kapacitet më të madh në shfrytëzimit të burimeve prodhuese.




Figura 3. Popullsia rurale sipas qarqeve për vitet 2001, 2010 dhe 2016

4.1.2 Varfëria

Banka Botërore në vitin 2004, në përpjekje për t'i ardhur në ndihmë politikave, konceptoi dhe ndërtoi hartat e shpërndarjes së varfërisë, duke u mbështetur në të dhënat e INSTAT mbi Anketat e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS). Dy nga tre hartat e kompozura janë paraqitur në vijim. Bie në sy një përqendrim i varfërisë në zonat veri-lindore. Është interesant pozicioni i rajonit të Tiranës te harta e parë dhe te harta e dytë. Te harta e parë, Tirana raportohet në nivele të ulëta të raportit të varfërisë për frymë, ndërsa te harta e dytë aty vërehen edhe nivele që kapin ekstremin negativ.




Figura 4. Raporti i varfërisë për frymë sipas rajonit (majtas) dhe komunë/bashki (djathtas) në Shqipëri për vitin 2004. Burimi: World Bank (2007).

Grafiku i mëposhtëm ilustron ecurinë në vite të varfërisë sipas rajoneve: Tiranë (kryeqyteti i vendit), zona bregdetare, zona qendrore, zona malore dhe gjithsej. Në grafik janë marrë në konsideratë dy tregues që raportohen nga Instituti i Statistikave: i varfër (*poor*) dhe tej i varfër (*Ex. poor*). Në një pamje të shpejt, bie në sy se nga vitit 2002 deri në vitin 2012 këto dy tregues kanë pësuar një reduktim. Në vitet e para të paraqitur në figurë, zona malore reflekton vlerat më të thella të këtyre treguesve. Konkretisht, në vitin 2002 treguesi *poor* për zonën malore është 44.5% të popullsisë që jeton aty, e cila përbën 18.6% më shumë se në zonën qendrore (44.5% – 25.6%). Por në vitin 2012 treguesi *poor* te zona malore ka performuar një korrelacion negativ në relacion me rajonet e tjera. Është zona e vetme ku është evidentuar një tkurrje e mëtejshme e këtij treguesi, duke rënë në nivelin 15.3%, nga 26.6% që ka qenë në vitin 2008. Kjo mund të ketë ardhur prej shumë arsyes. Ka gjasa që lëvizja e popullsisë drejt zonave urbane të ketë një ndikim përcaktues në këtë sjellje të treguesit. Ashtu siç e përmendëm, në të gjitha zonat e tjera përjashtuar zonën malore, në vitin 2012 është përkeqësuar ky tregues. Përveç lëvizjes së popullsisë mund të jetë edhe ndikimi i krizës financiare të viteve të fundit me të cilën po përballen vendet fqinje me Shqipërinë, por edhe brishtësia e ekonomisë shqiptare dhe kufizimet e theksuar buxhetore (ndihma financiare) për zbatimin e politikave për zbutjen apo luftimin e varfërisë. Provimi apo jo i këtyre dy hipotezave mbetet për t'u studiuar në të ardhme. Në të njëjtën linjë shprehet edhe raporti i Bankës Botërore (2007). Thuhet se në njëjtën tendencë ka pasur edhe treguesi *Ex. poor*, vetëm se në vlera më të moderuara. Është shqetësues fakti se viti i fundit i përfshirë në analizë (viti 2012) reflekton një përkeqësim të të dy treguesve. Kjo mund të shërbejë si një sinjal për politikëbërsit, të cilët duhet t'i paraprijnë një përkeqësimi të mëtejshëm të tyre. Mbase një rrugë është përqendrimi te politikat e nxitjes apo

stimulimit të rritjes ekonomike, e cila shkon në pajtim edhe me rekomandimet e Bankës Botërore (2007). Sipas studimeve të mëparshme, rritja ekonomike është kontributori më i madh në zbutjen e varfërisë në Shqipëri (Banka Botërore, 2007).




Figura 5. Paraqitja grafike e përqindjes së varfërisë sipas rajoneve dhe viteve. Burimi INSTAT (2014).

Por çfarë ka ndodhur me hendekun dhe me ashpërsinë e varfërisë? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje kemi sjellë dy grafikët në vijim. Treguesi i hendekut të varfërisë është ilustruar në grafikun në vijim për zonat dhe në vite për dy kategoritë: *poor* dhe *Ex. poor*. Në përgjithësi, hendeku i varfërisë ka ndjekur ecurinë e varfërisë në tërësi, që u ilustrua në grafikun e mësipërm. Le të përqendrohemi te zona bregdetare, e cila ka manifestuar përkeqësim më të lartë të hendekut të varfërisë krahasuar me zonat e tjera në vitin 2012. Nga një vlerë gati e papërfillshme (0.2) në vitin 2008 është rritur në vlerën 3.7 në vitin 2012. Do ishte me shumë interes të studiohej se cilët janë ato faktorë që kanë përcaktuar një sjellje të tillë të hendekut të varfërisë, por në këtë studim nuk jemi ndalur në këtë aspekt.




Figura 6. Hendeku i varfërisë sipas zonave dhe viteve. Burimi: INSTAT (2014)

Ashpërsia e varfërisë në Shqipëri sipas zonave dhe viteve është ilustruar nga grafiku në vijim. Edhe ky tregues korrelohet me varfërinë në tërësi dhe po ashtu edhe me hendekun e varfërisë, sidomos për kategorinë *poor*. Nëse ndalemi te zona qendrore, për kategorinë *poor* në dy evidencat e para (viti 2002 dhe 2005), ashpërsia e varfërisë ka qenë në nivelin 1.8 e pasuar me një rënie prej 1.3 (= 1.8 – 0.5) në vitin 2008 dhe për të përfunduar në vlerën 0.9 në vitin 2012. Interesant është fakti se për zonat bregdetare dhe malore, kategoria *Ex. poor* për vitet 2005, 2008 dhe 2012 mbetet në të njëjtët nivele prej 0.1 dhe për zonën Tirana është 0.




Figura 7. Ashpërsia e varfërisë sipas zonave dhe viteve. Burimi: INSTAT (2014)

Një pamje më të thelluar mbi ecurinë e varfërisë, mbështetur në metodat tradicionale të matjes së saj, mund të merret nga konsumi real për frymë. Grafiku në vijim ilustron këtë tregues sipas rajoneve për Shqipërinë për katër momente kryesore: viti 2002, 2005, 2008 dhe 2012. Është shqetësues fakti që pesha më e madhe e shpenzimeve për konsum destinohet për ushqime, që nënkupton edhe një nga nevojat bazë për t'u plotësuar. Ka një reduktim të lehtë me kalimin e viteve, por shtrirja e të dhënave në një horizont më të gjerë mund të jap më shumë informacion lidhur me tendencën e këtij treguesi. Në të gjithë rajonet, zëri i shpenzimeve bazë ka një prirje të qartë për rritje, ndërkohë që shpenzimet për pajisje afatgjata zënë një peshë thuajse të papërfillshme.




Figura 8. Përqindjet ndaj totalit të konsumit real për frymë sipas rajoneve dhe viteve. Burimi: INSTAT (2014).³²

Një nga treguesit për metodën MPI është numri i pjesëtarëve në një familje. Grafiku i mëposhtëm na vjen në ndihmë për të krijuar një ide të sjelljes së tij sipas rajoneve. Rajoni malor kryeson mes rajoneve të tjera me një mesatare prej 5 anëtarësh në familje dhe me një prirje të lehtë për reduktim. Kjo ka shumë gjasa të ketë një rol të rëndësishëm me përqindjen e varfërisë, si rrjedhojë me ashpërsinë dhe hendekun e saj. Rajoni i Tiranës paraqet një mesatare prej 3.7 anëtarë për familje, që njëherësh krahasuar me rajonet e tjera është edhe niveli më i ulët.




Figura 9. Madhësia mesatare e familjes sipas rajoneve dhe viteve. Burimi: INSTAT (2014).

Paketa statistikore LSMS e INSTAT është bazë e mirë për analiza të shumanshme dhe që shfrytëzohet nga shumë institucione të interesuara. Ministria për Çështjet Vendore u përqendrua te kjo databazë statistikore për të kryer një analizë sipas qarqeve të Shqipërisë. Raportet e studimit të ministrisë përpiqen të bëjnë një analizë shumë të detajuar duke pasqyruar treguesit për secilin qark. Nga këto raporte pasqyrohet edhe gjendja e varfërisë për qarqet dhe kjo pasqyrohet në **Error! Reference source not found..** Vihet re se nuk ka ndryshime shumë të mëdha mes qarqeve. Qarku i

³² Ku, a – Për ushqim, b – Për konsum jo-ushqimor, c – Për shërbimet bazë, d – Për edukim, e – Për pajisjet afatgjatë.

Kukësit rezultojnë me nivelin më të lartë të varfërisë (21.8%) krahasuar me qarqet e tjera të vendit. Gjirokastra dhe Korça reflektojnë nivelet më të ulëta të treguesve të varfërisë. Menjëherë pas vjen Qarku Elbasan. Për më shumë konsideroni figurën. Në rang kombëtar LSMS raporton një thellësi të varfërisë në nivelin 2.9%, ndërsa ashpërsia është nivelin 1.0%. Ndryshe nga shifrat e deritanishme që kemi shfrytëzuar, pasqyra që shprehëm në këtë paragraf është në shërbim të një pamje sa më të qartë mbi shpërndarjen e varfërisë jo më vetëm sipas rajoneve, por edhe sipas qarqeve të vendit.




Figura 10. Treguesit e varfërisë sipas LSMS së INSTAT (2012) sipas qarqeve. Burimi: Ministria për Çështjet Vendore (2014).

Gjithsesi, baza e të dhënave të anketave të INSTAT janë marrë dhe përthith nga indeksi MPI, që po e trajtojmë në vijim. Kjo bëri të mundur që të dhënat e marra jo vetëm pas vitit të pranimit të metodës MPI institucionet ndërkombëtare, por edhe ato të viteve të mëhershme të futeshin dhe analizoheshin nga mekanizmi i indeksit shumëpërmasor të varfërisë.

Raporti studimor i përgatitur nga Boeckhout dhe bashkëpunëtorët (2010) është një studim që duhet marrë parasysh falë kontributit të tyre në fushën e pabarazive të vëzhguara nga në dritën e Indeksit të Zhvillimit Rajonal. Edhe ky studim shkon krah për krah me studimet e LSMS. Po ashtu, në këtë vijë shkojnë edhe raportet e analizës në shërbim të reformës territoriale në Shqipëri të raportuar Ministria për Çështjet Vendore (2014). Këto analiza janë shumë të frytshme dhe me një vështrim të përgjithshëm për secilin qark të Shqipërisë, por fokusi i tyre nuk është varfëria.

4.1.3 Numri i bizneseve sipas rajoneve

Numri i bizneseve aktive në Shqipëri në fund të vitit 2014 ishte 112,537 biznese, ku pjesa më e madhe e tyre (52% e totalit) janë vendosur në qarqet Tiranë dhe Durrës. Në figurën e mëposhtme jepet shpërndarja e këtyre bizneseve sipas qarkut për dy kategori: biznese shqiptare dhe biznese të huaja e të përbashkëta. Grafiku është ndërtuar në mënyrë të tillë që të kapet edhe madhësia e bizneseve të huaja e të përbashkëta, duke vendosur minimumin në boshtin e ordinatave vlerën 88%.

Kjo shpjegon faktin se pse pjesa që zënë *bizneset e huaja e të përbashkëta* për Tiranën është “më e madhe” se pjesa e *bizneseve shqiptare*. Në të vërtetë ajo pjesë zë gati 8% (=100% - 92%).




Figura 11. Ndërmarrjet aktive sipas qarqeve, gjendje në fund të vitit 2014

4.2 NJOHJA ME SITUATËN PËRMES ANALIZËS PËRSHKRUESE

Në vijim është bërë analiza përshkuese për seksionet kryesore të pyetësorit, shoqëruar me paraqitje grafike dhe me tabela të kryqëzuara. Një parashtrim i tillë synon të familjarizojë lexuesin me natyrën e kërkimit dhe mund të konsiderohet si hapi i parë drejtë analizës së thelluar.

4.2.1 Seksioni A: të përgjithshme

Seksioni A i pyetësorit kompozohet nga 4 pyetje të përgjithshme, të cilat janë:

- Në cilin qark banoni?
- Cila është bashkia juaj?
- Cila është gjinia juaj?
- A punoni në administratën publike?

Shpërndarja e të intervistuarve është thujse e barabartë mes dy gjinive, përse kohë edhe përqindja që zënë secila gjini është gati 50%. Konkretisht, 49% e të intervistuarve janë meshkuj, ndërsa 51% e tyre janë femra.




Figura 12. Të intervistuarit sipas gjinisë së tyre

Tabela në vijim informon mbi shpërndarjen e të anketuarve sipas pyetjes: “Cila është gjinia juaj?” dhe “A punoni në administratën publike?” Ata që nuk punojnë në administratën publike, por që kanë informacion lidhur me zhvillimin e rajoneve, zënë 36.8% të të gjithë të intervistuarve. Më në detaje, 58.3% e të intervistuarve femra janë punonjës në administratën publike. Vetëm 31.9% e të anketuarve meshkuj të intervistuar nuk punojnë për administratën publike, por kanë dijeni për zhvillimin rajonal në Shqipëri. Në fakt, kjo është përqindja më e vogël mes katër kombinimeve të mundshme të dy pyetjeve të parashtruara.

Tabela 2. Shpërndarja të anketuarve sipas gjinisë dhe pyetjes nëse punojnë në administratën publike

		Cila është gjinia juaj?					
		Femër		Mashkull		Total	
		Count	Column N %	Count	Column N %	Count	Column N %
A punoni në administratën publike?	Jo	20	41.7%	15	31.9%	35	36.8%
	Po	28	58.3%	32	68.1%	60	63.2%
	Total	48	100.0%	47	100.0%	95	100.0%

Në vijim jepet një përshkrim i përgjigjeve të mbledhura për secilin seksion të pyetësorit. Do të paraqitemi me prezantimin grafik të të gjitha pyetjeve. Secila pyetje raportohet sipas kategorive *aspak* deri *plotësisht*. Në këtë mënyrë kuptojmë se në cilin krah anojnë pjesa më e madhe e përgjigjeve dhe peshën specifike të secilës kategori. Së bashku me këtë paraqitet mesatarja përkatëse, e cila llogaritet sipas formulimit:

$$Mes = \frac{\sum_{k=1}^5 k \cdot X_k}{\sum X_k}$$

ku me k shënohen kategoritë e vlerësimit nga 1 (*aspak*) deri në 5 (*plotësisht*), X_k tregon numrin e rasteve që kanë dhënë vlerësimin e k -të. Kjo formulë garanton që mesatarja të jetë një vlerë mes shifrës 1 dhe 5, pra $Mes \in [1; 5]$. Mesatarja e llogaritur tregon se cili është vlerësimi i përgjithshëm që jepet për secilën pyetje: sa më pranë vlerës 1, aq më i ulët është vlerësimi i dhënë dhe, nga ana tjetër, sa më pranë vlerës 5, aq më i lartë është vlerësimi i dhënë.

4.2.2 Seksioni B: Përfshirja e ekonomisë në strategjinë rajonale të zhvillimit

Nga anketimi bie në sy se kur ekspertët janë pyetur lidhur me shkallën se sa ekonomia e njësisë së tyre është pjesë e strategjisë rajonale të zhvillimit, kryesisht japin një vlerësim nën mesatare. Mund

të veçohet pohimi sipas të cilit strategjia është e zhvillimit të njësisë përkatëse e përfshinë ekonominë si instrument për zhvillimin rajonal. Vlerësimi më i dobët raportohet për aspektin se strategjia rajonale nuk i referohet instrumentit të rritjes ekonomike.




Figura 13. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit B

Vlera mesatare për çdo pyetje jepet në kolonën e fundit të grafikut, ku shënimi “Mes” nënkupton pikërisht këtë vlerë. Kështu, mesatarja e përgjigjeve për pohimin “[Strategjia/ plani i zhvillimit rajonal përfshijnë shtyllat kryesore të rritjes ekonomike?” është 2.9 nga 5 gjithsej.

Tabela 3. Shpërndarja e përgjigjeve të pyetjes B2 sipas qarqeve

	Në dijeninë tuaj, në çfarë shkalle ekonomia është pjesë e strategjise rajonale të zhvillimit (per NJA tuaj)? [Nese po, strategjia juaj e perfshin ekonomin si nje instrument per zhvillimin rajonal?]				
	Aspak	Pak	As pak, as shumë	Shumë	Plotësisht
Berat	*	*	*		
Dibër		*	*	*	*
Durrës		*	*	*	*
Elbasan		*	*	*	*
Fier	*	*	*		*
Gjirokastrë		*	*	*	
Korçë	*		*	*	
Kukës		*	*	*	
Lezhë	*	*		*	*
Shkodër		*	*	*	
Tiranë	*	*	*	*	*
Vlorë	*		*	*	

Tabela e mësipërme paraqet shpërndarjen e përgjigjeve të dhëna sipas qarqeve vetëm për pyetjen B2, e cila është “Në dijeninë tuaj, në çfarë shkalle ekonomia është pjesë e strategjisë rajonale të zhvillimit (për NJA tuaj)? [Nëse po, strategjia juaj e përfshin ekonomin si një instrument për zhvillimin rajonal?].” Shenja * në qelizat e tabelës nënkupton se nga qarku përkatës është gjendur një intervistues që ka dhënë vlerësimin përkatës në krye të kolonës.

Nga shqyrtimi i rezultateve shohim se qarqet Berat, Fier, Korçë, Lezhë, Tiranë dhe Vlorë vlerësohen në nivelin më të ulët (*aspak*) lidhur me përfshirjen e ekonomisë si një instrument për zhvillimin rajonal. Nga ana tjetër anketimi raporton se qarqet që e kanë përfshirë ekonominë në strategjinë e njësive administrative si instrument për zhvillimin rajonal dhe kanë dhënë vlerësimin më të lartë (*plotësisht*) janë Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Lezhë dhe Tiranë. Në qarqet Fier, Lezhë dhe Tiranë ka njësi administrative që raportojnë nivelet ekstreme të vlerësimit të shkallës së përfshirjes së ekonomisë në strategjinë rajonale të zhvillimit. Pra, në këto qarqe ekzistojnë njësi administrative që e vlerësojnë me nivelin më të lartë përfshirjen e ekonomisë në strategjinë e zhvillimit rajonal, por nga ana tjetër ka edhe njësi administrative që e vlerësojnë në nivelet më të ulëta.

4.2.3 Seksioni C: Shkalla e përfshirjes së ekonomisë në strategjinë sektoriale

Duke përmbledhur rezultatet në rang vendi, anketimi tregon se pak më shumë se gjysma (rreth 59%) e rasteve ekspertët janë shprehur se njësia përkatëse zotëron një plan të veçantë sektorial për zhvillimin rajonal të zonës.




Figura 14. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas një pyetje të seksionit C

Ata që iu përgjigjën pozitivisht pyetjes lidhur me ekzistencën e një plani specifik sektorial për zhvillimin rajonal japin vlerësim për dimensionet e listuar që lidhen me këtë plan. Vlerësimi jepet në kontekstin se sa përfshihet ky plan në strategjinë sektoriale. Gjetjet paraprake tregojnë se vlerësimi për secilin aspekt është nën mesatare (në një vlerësim nga 1=*aspak* deri në 5=*plotësisht*).




Figura 15. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit C

Në tabelën në vijim jepen rezultatet vetëm për pyetjen C1 sipas qarqeve. Vihet re se vlerësimet në shkallën “Plotësisht” për përfshirjen në strategjinë sektoriale të ekonomisë si një instrument për zhvillimin rajonal, vijnë nga njësi administrative që janë në qarkun e Dibrës, Durrësit, Elbasanit, Fierit, Shkodrës dhe Tiranës. Për kontrast, vlerësimet “Aspak” për përfshirjen në strategjinë sektoriale të ekonomisë si një instrument për zhvillimin rajonal, vijnë nga njësi administrative që janë në qarkun e Beratit, Fierit, Korçës, Lezhës dhe Tiranës. Vetëm në qarqet Fier dhe Tiranë gjenden njësi administrative që japin vlerësime të kundërta, edhe “Aspak”, edhe “Plotësisht”.

Tabela 4. Rezultatet për pyetjen C1 sipas qarqeve

		Nëse po, ju lutem jepni shkallën e përfshirjes në strategjinë tuaj sektoriale: [të ekonomisë si një instrument për zhvillimin rajonal]				
		Aspak	Pak	As pak, as shumë	Shumë	Plotësisht
Në cilin qark banoni?	Berat	*	*			
	Dibër		*		*	*
	Durrës		*	*	*	*
	Elbasan			*	*	*
	Fier	*	*		*	*
	Gjirokastrë			*		
	Korçë	*		*	*	
	Kukës		*	*	*	
	Lezhë	*	*	*		
	Shkodër		*		*	*
	Tiranë	*		*	*	*
	Vlorë			*	*	

4.2.4 Seksioni D: Kufizimet për zhvillimin e brendshëm rajonal ekonomik

Më tej të profesionistëve dhe të mandatuarve nga njësitë vendore u kërkohet të japin vlerësimin lidhur me nivelin e kufizimeve për zhvillimin e brendshëm rajonal të njësisë.

Ashtu siç ilustron në grafik, dimensionin vlerësohet apo perceptohet si më kufizues për zhvillimin e brendshëm rajonal është oferta dhe kërkesa e ulët për produkte që prodhohen në rajon.




Figura 16. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit D

Një nga kufizimet e renditura më lartë lidhet me nivelin e informalitetit. I intervistuari pyetet se në çfarë shkalle e vlerëson ai nivelin e informalitetit si një element kufizues për zhvillimin e brendshëm rajonal ekonomik në njësinë administrative. Lidhur me nivelin e informalitetit si një kufizim të madh (plotësisht) për zhvillimin e brendshëm rajonal ekonomik ekspertët e NJA nxjerrin në pah se janë qarqet Dibër, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Lezhë, Shkodër dhe Tiranë.

Tabela 5. Rezultatet për pyetjen D8 sipas qarqeve

	Ju lutem përcaktoni nivelin e kufizimeve për zhvillimin e brendshëm rajonal ekonomik në NJA tuaj [Niveli i lartë informaliteti?]				
	Aspak	Pak	As pak, as shumë	Shumë	Plotësisht
Në cilin qark banoni?					
Berat	*	*	*	*	
Dibër		*	*	*	*
Durrës		*	*	*	*
Elbasan		*	*	*	*
Fier		*	*	*	
Gjirokastrë		*	*	*	*
ër		*	*	*	
Korçë	*	*	*	*	
Kukës		*	*	*	
Lezhë			*	*	*
Shkodër		*	*	*	*
Tiranë	*	*	*	*	*
Vlorë			*	*	

Për kontrast, përsëri referuar përgjigjeve të mbledhura nga anketimi, qarqet me njësi administrative që rezultojnë me nivelin më të ulët (*aspak*) të informalitetit si kufizues i zhvillimit ekonomik rajonal, janë Berat, Korça dhe Tirana. Qarku i Tiranës përballet me njësi administrative që japin edhe vlerësim të lartë edhe të ulët për informalitetin si një kufizues për zhvillimin e brendshëm rajonal ekonomik.

4.2.5 Seksioni E: Zona prioritare për rritje ekonomike rajonale

Seksioni E, ashtu siç është sqaruar diku tjetër, ka të bëjë me përgjigjet lidhur me zonat prioritare të cilat janë parashikuar për rritje ekonomike. Nga anketimi vihet re se përgjithësisht politika të rregullimit të tregut dhe menaxhimi i tij është parashikuar të mbështes rritjen ekonomike rajonale, mesatarja 3 nga 5 gjithsej. Nga ana tjetër, marrëveshjet institucione me bizneset rajonale vlerësohet se nuk është diçka që është parashikuar si prioritet në ndihmë të rritjes ekonomike.




Figura 17. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit E

Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e përgjigjeve të dhëna sipas qarqeve vetëm për pyetjen E1, e cila është “A ka rajoni juaj zona prioritare ndërhyrje të cilat janë parashikuar për rritje ekonomike rajonale? [Politika të rregullimit të tregut dhe menaxhimit të tij?]” Shenja * në qelizat e tabelës nënkupton se nga qarku përkatës është gjendur një intervistues që ka dhënë vlerësimin përkatës në krye të kolonës. Këtu bie në sy përqendrimi i përgjigjeve poshtë mesatares, poshtë opsionit “As pak, as shumë”, përsa kohë edhe shenjat * gjenden në tre kolonat e para të përgjigjeve të pyetjes E1. Më në detaje, në qarqet Berat, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë ka njësi administrative që i vlerësojnë se politikat e rregullimit të tregut dhe menaxhimit të tij janë parashikuar për rritjen ekonomike rajonale në nivelin më të ulët (*aspak*), ndërkohë që vlerësimi më i lartë (*plotësisht*) është dhënë nga njësitë administrative që janë në qarqet Berat, Kukës, Lezhë, Shkodër dhe Tiranë.

Tabela 6. Shpërndarja e përgjigjeve të pyetjes E1 sipas qarqeve

	A ka rajoni juaj zona prioritare nderhyrje te cilat jane parashikuar per rritje ekonomike rajonale? [Politika te regullimit te tregut dhe menaxhimit te tij?]				
	Aspak	Pak	As pak, as shumë	Shumë	Plotësisht
Në cilin qark banoni?					
Berat	*	*	*		*
Dibër		*	*	*	
Durrës	*	*	*	*	
Elbasan		*	*	*	
Fier	*	*	*		
Gjirokastrë	*	*	*		
Korçë	*	*	*		
Kukës		*	*		*
Lezhë	*	*	*		*
Shkodër	*	*	*		*
Tiranë	*	*	*		*
Vlorë	*		*	*	

4.2.6 Seksioni F dhe G

Në vijim të anketuarit japin përgjigje për pyetjen “A ka NJA juaj plan operacional të përcaktuar me aktivitete, buxhet për zonat e ndërhyrjes prioritare?” Siç edhe grafiku në vijim e paraqet, 3 nga 5 të intervistuar janë përgjigjur “Po” kësaj pyetje, ndërsa 2 nga 5 janë përgjigjur me “Jo”. Pra, 60% e të anketuarve kanë deklaruar se në njësinë e tyre administrative nuk ka plan operacional të përcaktuar me aktivitete, buxhet për zonat e ndërhyrjes prioritare. Për hir të së vërtetës, kjo nuk konsiderohet si një tregues i mirë për arritjen e objektivave operacionale nga ana e njësisë administrative. Mospasja e një plani të tillë operacional shoqërohet edhe me neglizhencën e këtyre njësive në kryerjen e detyrave të veta operacionale.




Figura 18. Paraqitja grafike e përgjigjeve për pyetjen: A ka njësia juaj një plan operacional të përcaktuar me aktivitete, buxhete për zonat e ndërhyrjes prioritare?

Grafiku në vijim jep shpërndarjen e përgjigjeve lidhur me pyetjen: A ka patur ndikim kriza ekonomike ne tregun e zhvillimit tuaj rajonal? Kjo konsiderohet si një pyetje që lidhet ngushtë me treguesit e njësive administrative dhe po ashtu edhe me treguesit makroekonomik të vendit. Rreth 64% e të anketuarve janë përgjigjur se kriza ekonomike ka patur shumë dhe plotësisht ndikim në

tregun e zhvillimit rajonal.³³ Me sa duket, personat që kanë dhënë këtë përgjigje kanë bërë një lidhje të fortë mes ecursisë ekonomike të ekonomisë së vendit në tërësi dhe të rajonit të tyre. Mesatarja e përgjigjeve të dhëna për këtë pyetje është 3.8 (minimumi është 1 dhe maksimumi është 5). Vlera 3.8 është shumë pranë vlerës 4 dhe shkon paralelisht edhe me shpërndarjen e përqindjeve që u komentuan më sipër. Për më shumë lidhur me këtë seksion, raporton grafiku në vijim.



Figura 19. Paraqitja grafike e përgjigjeve për pyetjen: A ka patur ndikim kriza ekonomike në tregun e zhvillimit tuaj rajonal?

4.2.7 Seksioni H: Koordinimi i strategjisë rajonale me strategjinë kombëtare

Më tej, punonjësve të njësive vendore u është kërkuar të japin vlerësimin e tyre lidhur me shkallën e koordinimit të strategjisë rajonale me strategjinë kombëtare. Janë bërë 4 pyetje për këtë aspekt, të cilat janë:

- A janë strategjitë tuaja rajonale të zhvillimit të koordinuara me strategjitë rajonale në nivel kombëtar?
- A janë të përfshirë aktoret lokal në hartimin, zbatimin e planeve sektoriale rajonale?
- A janë organizuar takime të posaçme me institucionet kombëtare për zhvillimin rajonal?
- A ekziston një komision përgjegjës për çështjet e zhvillimit rajonal?

Mesataret e tyre variojnë nga 2.2 deri në 2.7, të cilat tregojnë për një vlerësim të ulët lidhur me koordinimin e strategjisë rajonale me strategjitë e tjera. Në të katërtat pyetjet, dominon përgjigja “Pak” dhe pas saj vjen përgjigja “As pak, as shumë” dhe në ndonjë rast përgjigja “Aspak” renditet e dyta. Be në sy pjesa shumë e vogël e përgjigjeve të dhëna për opsionin “Plotësisht”. Kjo tregon se janë shumë pak njësi administrative që kanë bërë një koordinim të strategjive rajonale me ato kombëtare. Synimi është që strategjitë rajonale të koordinohen me ato në nivel kombëtar. Për më shumë lidhur me këtë referohuni te grafiku i mëposhtëm.

³³ Referuar paraqitjes grafike, 41% e të anketuarve kanë zgjedhur opsionin 4, ndërsa 23% e tyre kanë zgjedhur opsionin 5. Këto dy vlera konsiderohen të larta.




Figura 20. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit H

Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e përgjigjeve të dhëna sipas qarqeve vetëm për pyetjen H0, e cila është “Ju lutem, jepni shkallën e koordinimit të strategjisë rajonale me strategjinë kombëtare [A janë strategjitë tuaja rajonale të zhvillimit të koordinuara me strategjitë rajonale në nivel kombëtar?].” Shenja * në qelizat e tabelës nënkupton se nga qarku përkatës është gjendur një intervistues që ka dhënë vlerësimin përkatës në krye të kolonës. Këtu bie në sy përqendrimi i përgjigjeve poshtë mesatares, poshtë opsionit “Pak”, përse kohë edhe shenjat * gjenden në tre kolonat e para të përgjigjeve të pyetjes H0.

Tabela 7. Shpërndarja e përgjigjeve të pyetjes H0 sipas qarqeve

		Ju lutem, jepni shkallën e koordinimit të strategjisë rajonale me strategjinë kombëtare [A janë strategjitë tuaja rajonale të zhvillimit të koordinuara me strategjitë rajonale në nivel kombëtar?]				
		Aspak	Pak	As pak, as shumë	Shumë	Plotësisht
Në cilin qark banoni?	Berat	*	*	*	*	
	Dibër	*	*	*	*	*
	Durrës	*	*		*	*
	Elbasan		*	*		
	Fier	*	*	*	*	*
	Gjirokastrë	*	*	*	*	
	Korçë		*	*		
	Kukës		*	*	*	
	Lezhë	*	*	*	*	
	Shkodër	*	*	*	*	
	Tiranë	*	*	*	*	*
	Vlorë	*	*			

Më në detaje, në qarqet Berat, Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë ka njësi administrative që vlerësojnë se shkalla e koordinimit të strategjisë rajonale me strategjinë kombëtare në nivelin më të ulët (*aspak*), ndërkohë që vlerësimi më i lartë (*plotësisht*) është dhënë nga

njësitë administrative që janë në qarqet Dibër, Durrës, Fier dhe Tiranë. Ashtu siç edhe duket, në të njëjtin qark ka edhe njësi administrative që nuk e kanë bërë koordinimin e strategjisë rajonale me atë kombëtare, por ka edhe nga ata që e kanë koordinuar atë.

4.2.8 Seksioni I: Zhvillimin e dialogut

Një aspekt i veçantë që ka prekur pyetësi ishte edhe përcaktimi i shkallës për zhvillimin e dialogut me aktorët e tjerë për zhvillimin rajonal. Janë bërë 6 pyetje për këtë aspekt, të cilat janë:

- A zhvillohet dialog me sektorin privat për formulimin e planeve për zhvillimin rajonal?
- Po me përfaqësuesit e biznesit lokal?
- Po me shoqatat lokale/kombëtare?
- Po me përfaqësuesit e biznesit kombëtar?
- Po me individ lider komuniteti?
- Po me përfaqësues të botës akademike/universitete?

Mesataret e tyre variojnë nga 1.9 deri në 2.5, të cilat tregojnë për një vlerësim të ulët lidhur me zhvillimin e dialogut me aktor të tjerë. Në të gjashta pyetjet, dominon përgjigja “Aspak” dhe përgjigja “Pak”. Be në sy pjesa shumë e vogël e përgjigjeve të dhëna për opsionin “Plotësisht”. Kjo tregon se janë shumë pak njësi administrative që kanë zhvilluar një dialog me aktorët e tjerë lidhur me zhvillimin rajonal. Synimi është që planet për zhvillimin e rajonit të kalojnë në seanca dialogu edhe me aktorët e tjerë. Për më shumë lidhur me këtë, referohuni grafikut të mëposhtëm.




Figura 21. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit I

Tabela në vazhdim paraqet shpërndarjen e përgjigjeve të dhëna sipas qarqeve vetëm për pyetjen I0, e cila është “Ju lutem, përcaktoni shkallën për zhvillimin e dialogut [me sektorin privat për formulimin e planeve për zhvillimin rajonal]” Shenja * në qelizat e tabelës nënkupton se nga qarku përkatës është gjendur një intervistues që ka dhënë vlerësimin përkatës në krye të kolonës. Këtu bie në sy

përqendrimi i përgjigjeve tek opsionet “Pak” dhe “As pak, as shumë”, përsa kohë edhe shenjat * gjenden në kolonat me titull “Pak” dhe “As pak, as shumë” të përgjigjeve të pyetjes IO.

Më në thellësi, në qarqet Berat, Fier, Lezhë, Tiranë dhe Vlorë ka njësi administrative që vlerësojnë në nivelin më të ulët (*aspak*) shkallën e zhvillimit të dialogut me sektorin privat për formulimin e planeve për zhvillimin rajonal, ndërkohë që vlerësimi më i lartë (*plotësisht*) është dhënë nga njësitë administrative që janë në qarqet Elbasan dhe Tiranë. Ashtu siç edhe duket, në të njëjtin qark ka edhe njësi administrative që nuk e kanë bërë dialog me sektorin privat për formulimin e planeve për zhvillimin rajonal, por ka edhe nga qarqe që e kanë bërë këtë gjë.

Tabela 8. Shpërndarja e përgjigjeve të pyetjes IO sipas qarqeve

		Ju lutem, përcaktoni shkallën për zhvillimin e dialogut [me sektorin privat për formulimin e planeve për zhvillimin rajonal]				
		Aspak	Pak	As pak, as shumë	Shumë	Plotësisht
Në cilin qark banoni?	Berat	*	*	*		
	Dibër		*	*	*	
	Durrës		*	*	*	
	Elbasan		*	*	*	*
	Fier	*	*	*	*	
	Gjirokastrë		*	*		
	Korçë	*	*	*		
	Kukës		*	*	*	
	Lezhë	*	*	*	*	
	Shkodër		*	*	*	
	Tiranë	*	*	*	*	*
	Vlorë	*	*	*	*	

4.2.9 Seksioni J: Vështirësi të ndryshme

Një nga aspektet e pyetësorit është edhe shkalla e vështirësive për një sërë elementësh që prekin ecurinë e aktivitetit të njësive administrative. Janë bërë 7 pyetje për këtë aspekt, të cilat janë:

- A keni vështirësi në implementimin e politikave të zhvillimit rajonal?
- A keni vështirësi për fonde?
- A keni vështirësi për të marrë borxh si pushtet vendor?
- A ndihet mungesa e qartësisë nga politikat në nivel kombëtar?
- A ndihet mungesa e dakordësisë e pushtetit vendor dhe atij kombëtar?
- A ndihet mungesa e ekspertizës rajonale?
- A ndihet mungesa e specializimit në një sektor specifik sipas rajoneve?

Mesataret e tyre variojnë nga 3.1 deri në 3.9, të cilat tregojnë për një vlerësim të mesatar lidhur me zhvillimin e dialogut me aktor të tjerë. Në të gjashta pyetjet, dominon përgjigja “Shumë” e pasuar nga përgjigja “As pak, as shumë” dhe, në disa raste, edhe nga përgjigja “Plotësisht”. Në sy pjesë shumë e vogël e përgjigjeve të dhëna për opsionin “Aspak”. Kjo tregon se janë shumë pak njësi administrative që nuk kanë një vështirësi të parashtruar më sipër. Synimi është që këto vështirësi të jenë sa më të vogla dhe vlerësimi për to të jetë sa më i ulët. Për më shumë lidhur me këtë, referohuni grafikut të mëposhtëm.

Ju lutem, përcaktoni shkallën për vështirësitë e mëposhtme:




Figura 22. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit J

Tabela më poshtë paraqet shpërndarjen e përgjigjeve të dhëna sipas qarqeve vetëm për pyetjen J0, e cila është “Ju lutem, përcaktoni shkallën për vështirësitë e mëposhtme: [Vështirësia për fonde?]” Shenja * në qelizat e tabelës nënkupton se nga qarku përkatës është gjendur një intervistues që ka dhënë vlerësimin përkatës në krye të kolonës. Këtu bie në sy përqendrimi i përgjigjeve tek opsionet “Shumë” dhe “Plotësisht”, përsa kohë edhe shenjat * gjenden në kolonat me titull “Shumë” dhe “Plotësisht” të përgjigjeve të pyetjes J0.

Më konkretisht, në qarqet Berat, Fier, Lezhë dhe Tiranë ka njësi administrative që vlerësojnë në nivelin më të ulët (*aspak*) shkallën e vështirësisë së njësive administrative për fonde, ndërkohë që vlerësimi më i lartë (*plotësisht*) është dhënë nga të paktën një njësi administrative për secilin qark, përjashtuar qarkun e Fierit. Ashtu siç edhe duket, në të njëjtin qark ka edhe njësi administrative që nuk kanë vështirësi për fonde financiare, por ka edhe nga qarqe që e kanë di vështirësi këtë gjë.

Tabela 9. Shpërndarja e përgjigjeve të pyetjes J0 sipas qarqeve

		Ju lutem, përcaktoni shkallën për vështirësitë e mëposhtme: [Vështirësia për fonde?]				
		Aspak	Pak	As pak, as shumë	Shumë	Plotësisht
Në cilin qark banoni?	Berat	*	*	*	*	*
	Dibër			*	*	*
	Durrës			*	*	*
	Elbasan			*	*	*
	Fier	*	*		*	
	Gjirokastrë		*		*	*
	Korçë			*	*	*
	Kukës				*	*
	Lezhë	*			*	*
	Shkodër			*	*	*
	Tiranë	*	*	*	*	*
	Vlorë			*	*	*

4.2.10 Seksioni K: Sektori ekonomik

Një nga aspektet që ka prekur pyetësi është edhe se sa dakord janë përfaqësuesit e njësive administrative që sektorët e mëposhtëm t'i zhvillojnë në njësitë e tyre administrative. Kjo pyetje është bërë për këto 7 sektorë:

- Bujqësi;
- Pylltari;
- Peshkim;
- Industri/manifakture;
- Industri nxjerrëse, minerale;
- Turizëm.

Mesataret e tyre variojnë nga 2.6 deri në 4.1, të cilat tregojnë për një vlerësim të mesatar lidhur me zhvillimin e sektorëve. Në shumicën e alternativave (sektorëve), dominon përgjigja “Shumë” e pasuar nga përgjigja “As pak, as shumë” dhe, në disa raste, edhe nga përgjigja “Plotësisht”. Be në sy pjesa shumë e vogël e përgjigjeve të dhëna për opsionin “Aspak”, përjashtuar sektorin e “Peshkimit” dhe të “Industri nxjerrëse, minerale”. Le të përqendrohemi te sektori i “Bujqësisë”. Ky sektor ka marrë 36% të përgjigjeve në opsionin “Plotësisht” dhe 45% te përgjigjeve te opsioni “Shumë”. Kjo dëshmon për një orientim të qartë të zhvillimit të njësive administrative sipas sektorit të “Bujqësisë”.




Figura 23. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit K

Interesant është fakti se për sektorin e “Turizmit”, përgjigjet e përfaqësuesve të njësive administrative që kanë plotësuar pyetësin janë shpërndarë kështu: 4% e tyre mendojnë se nuk ka “Aspak” vend për të zhvilluar “Turizmin” në njësinë e tyre, 17% e tyre mendojnë se “Turizmi” duhet zhvilluar “Pak” në njësinë e tyre, 14% e tyre gjykojnë se ky sektor duhet zhvilluar “As pak, as shumë” në njësinë e tyre, ndërkohë që 26% dhe 39% e tyre gjykojnë se zhvillimi i këtij sektori duhet zhvilluar “Shumë” dhe “Plotësisht” në njësinë e tyre administrative. Gati e kundërta e këtyre

përgjigjeve është situata e sektorit të “Peshkimit”. Për më shumë lidhur me shpërndarjen e përgjigjeve për secilin sektor ekonomik, referohuni grafikut të mësipërm.

4.2.11 Seksioni L: Përfshirja në produktet turistike potenciale

Një nga aspektet që ka prekur pyetësi është edhe se në çfarë shkalle është e përfshirë njësia administrative në produktet turistike potenciale (qark/bashkinë). Kjo pyetje është bërë për këto 5 alternativa të mundshme:

- Argotizëm;
- Turizëm kulturor/fetar;
- Turizëm malor veror;
- Turizëm malor dimëror;
- Turizëm i rërës dhe detit.

Më poshtë ilustron paraqitja grafike e përgjigjeve të marra nga pyetësi për këtë pyetje, sipas 5 alternativave. Mesataret e tyre lëvizin nga 1.8 deri në 2.9, të cilat tregojnë për një vlerësim relativisht të ulët lidhur me zhvillimin e sektorëve. Në shumicën e alternativave (boshti vertikal në grafikë), dominon përgjigja “Pak” e pasuar nga përgjigja “Aspak” dhe, në disa raste, edhe nga përgjigja “As pak, as shumë”. Bie në sy pjesa shumë e vogël e përgjigjeve të dhëna për opsionin “Plotësisht”. Le të përqendrohemi te sektori i “Agroturizmit”. Kjo alternativë ka marrë 9% të përgjigjeve në opsionin “Plotësisht” dhe 22% të përgjigjeve te opsioni “Shumë”, 26% të përgjigjeve te opsioni “As pak, as shumë”, 35% te opsioni “Pak” dhe vetëm 7% te opsioni “Aspak”.




Figura 24. Shpërndarja e përgjigjeve të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit L

Interesant është fakti se për alternativën “Turizmi i rërës dhe detit”, përgjigjet e përfaqësuesve të njësive administrative që kanë plotësuar pyetësin janë shpërndarë kështu: 69% e tyre mendojnë se nuk ka “Aspak” vend për të zhvilluar këtë formë të turizmit në njësine e tyre, 11% e tyre mendojnë

se kjo formë e turizmit duhet zhvilluar “Pak” në njësinë e tyre, vetëm 1% e tyre gjejnë se kjo formë e turizmit duhet zhvilluar “As pak, as shumë” në njësinë e tyre, ndërkohë që 8% dhe 11% e tyre gjejnë se zhvillimi i kësaj forme të turizmit duhet zhvilluar “Shumë” dhe “Plotësisht” në njësinë e tyre administrative. Përqindja e lartë e përgjigjeve të opsioni “Aspak” janë të logjikshme, sepse jo të gjitha njësitë administrative mund ta ofrojnë këtë formë të turizmit. Një shpërndarje tjetër e këtyre përgjigjeve është situata e formës së zhvillimit të “Turizmit kulturor/fetar”. Për më shumë lidhur me shpërndarjen e përgjigjeve për secilin dimension, referohuni grafikut të mësipërm.

4.2.12 Seksioni M: Aktivitetet për të realizuar një potencial turizmi

Përveç pyetjeve të seksionit L, për të kuptuar mirë sektorin e turizmit, janë bërë edhe pyetjet e seksionit M, të cilat kanë këtë pyetje qendrore: Cilat janë sipas jush aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për të realizuar një potencial turizmi? Kjo pyetje është bërë për këto 7 alternativa të mundshme:

- Mbrojtja e mjedisit;
- Promovimi i produkteve rajonale;
- Promovimi i ushqimeve bio;
- Rritja e bashkëpunimit për menaxhimin e burimeve lokale;
- Zhvillimi i turizmit të unifikuar në të gjithë qarkun;
- Marketim më i mirë i produkteve;
- Rritja e aksesit në shërbime publike.




Figura 25. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit M

Më lartë ilustron paraqitja grafike e përgjigjeve të marra nga pyetësi për këtë pyetje, sipas 7 alternativave. Mesataret e tyre lëvizin nga 4.1 deri në 4.3, të cilat tregojnë për një vlerësim relativisht të lartë lidhur me aktivitete kryesore që duhen ndërmarrë për realizimin e një turizmi potencial. Në shumicën e alternativave (boshti vertikal në grafikë), dominon përgjigja “Plotësisht” e pasuar nga

përgjigja “Shumë”. Bie në sy pjesa shumë e vogël e përgjigjeve të dhëna për opsionin “Aspak”, “Pak” dhe “As pak, as shumë”. Le të përqendrohemi te “Mbrojtja e mjedisit”. Kjo alternativë ka marrë 51% të përgjigjeve në opsionin “Plotësisht” dhe 39% të përgjigjeve te opsioni “Shumë”, pjesa tjerë është ndarë mes opsioneve “Aspak”, “Pak” dhe “As pak, as shumë”. Siç duket, thuajse të gjitha njësitë administrative janë dakord që të gjitha aktivitetet e mësipërme të zhvillohen për të arritur një potencial turizmi. Për më shumë lidhur me shpërndarjen e përgjigjeve për secilin aspekt, referohuni grafikut të mësipërm.

4.2.13 Seksioni N dhe O: Zhvillimi i bujqësisë me kategoritë e saj

Te seksioni i pyetjeve K një nga sektorët e ekonomisë ishte Bujqësia. Këtu kërkohet që të shihet më në veçanti ky sektor me kategoritë e tij. Për të arritur këtë analizohen pyetjet e seksionit N dhe O të pyetësorit. Pyetjet e seksionit N lidhen kryesisht me shkallën e zhvillimit të aspekteve të bujqësisë në rajonin e intervistuesit. Katër pyetje lidhen me këtë seksion, të cilat janë:

- Prodhimet blegtorale;
- Prodhimet bujqësore;
- Peshkimi;
- Bletari.

Më poshtë ilustron paraqitja grafike e përgjigjeve të marra nga pyetësori për këtë pyetje, sipas 4 rasteve. Mesataret e tyre lëvizin nga 1.9 deri në 3.2 të cilat tregojnë për një vlerësim relativisht mesatar lidhur me aktivitete kryesore që duhen ndërmarrë për bujqësinë. Në shumicën e rasteve (boshti vertikal në grafikë), dominon përgjigja “Aspak” ose “Pak”. Bie në sy pjesa shumë e vogël e përgjigjeve të dhëna për opsionin “Plotësisht”. Le të përqendrohemi te “Prodhimet blegtorale”. Prodhimet blegtorale kanë marrë 4% të përgjigjeve në opsionin “Plotësisht” dhe 31% të përgjigjeve te opsioni “Shumë”, 37% e përgjigjeve te opsioni “As pak, as shumë”, pjesa tjerë është ndarë mes opsioneve “Aspak”, dhe “Pak”. Për më shumë lidhur me shpërndarjen e përgjigjeve për secilën kategori, referohuni grafikut të mëposhtëm.




Figura 26. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit N

Përveç pyetjeve të seksionit të më sipërm, për bujqësinë janë formuluar edhe pyetje të tjera. Në vijim analizohet shpërndarja e përgjigjeve për pyetjet e seksionit O të pyetësorit. Mesataret e tyre lëvizin nga 3.7 deri në 4.3, të cilat tregojnë për një vlerësim relativisht të lartë lidhur me aktivitete kryesore që duhen ndërmarrë për të realizuar një potencial bujqësor në kontekstin rural. Në shumicën e rasteve (boshti vertikal në grafikë), dominon përgjigja “Plotësisht” ose “Shumë”. Bie në sy pjesa shumë e vogël e përgjigjeve të dhëna për opsionin “Aspak”. Le të përqendrohemi te “Përmirësimi i aftësive profesionale për agrobujqësi”. Kjo kategori kanë marrë 17% të përgjigjeve në opsionin “Plotësisht” dhe 51% të përgjigjeve te opsioni “Shumë”, 20% e përgjigjeve te opsioni “As pak, as shumë”, pjesa tjetër është ndarë mes opsioneve “Aspak”, dhe “Pak”. Kategoritë e tjera kanë një peshë më të lartë te opsioni “Plotësisht”. Për më shumë lidhur me shpërndarjen e përgjigjeve për secilin këtë aspekt, referohuni grafikut të mëposhtëm.




Figura 27. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit O

4.2.14 Seksioni P: Produktet kryesore të SME

Mes të tjerave, te seksioni i pyetjeve K një nga sektorët e ekonomisë ishte Industria/manifaktura. Në këtë çështje të disertacionit kërkohet që të shihet më në veçanti ky sektor me kategoritë e tij. Për të arritur këtë analizohen pyetjet e seksionit P të pyetësorit. Pyetjet e seksionit P lidhen kryesisht me pyetjen: Cilat janë sipas jush produktet kryesore të SME-ve (ndërmarrje të vogla të mesme) në qarkun/bashkinë tuaj? Pesë raste lidhen me këtë seksion, të cilët janë:

- Zhvillimi i arsimit formimit profesional;
- Mbështetja financiare për sipërmarrësit e rinj;
- Ofrimi i trajnimeve specifike për menaxheret e rinj;
- Lehtësim i mundësive për investimeve që vijnë nga emigrantet;
- Krijimi i hapësirave për punësimin e të diplomuarave në këto biznese.

Më poshtë ilustron paraqitja grafike e përgjigjeve të marra nga pyetësi për këtë pyetje, sipas 5 rasteve. Mesataret e tyre lëvizin nga 2.8 deri në 3.3, të cilat tregojnë për një vlerësim relativisht mesatar lidhur me produktet kryesore të SME-ve në rajonin e njësisë administrative. Në shumicën e rasteve (boshti vertikal në grafikë), dominon përgjigja “Shumë” ose “As pak, as shumë”. Bie në sy shpërndarja thuajse e njëjtë mes përqindjes që zënë përgjigjet e dhëna për opsionin “Aspak” dhe “Plotësisht”. Le të përqendrohemi te “Zhvillimi i arsimit profesional”. Ky rast ka marrë 7% të përgjigjeve në opsionin “Plotësisht” dhe 33% të përgjigjeve te opsioni “Shumë”, 26% e përgjigjeve te opsioni “As pak, as shumë”, pjesa tjerë prej 33% është ndarë mes opsioneve “Aspak”, dhe “Pak”, respektivisht 9% dhe 24%. Për më shumë lidhur me shpërndarjen e përgjigjeve për secilën kategori, referohuni grafikut të mëposhtëm.




Figura 28. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit P

4.2.15 Seksioni Q: Potenciali i burimeve natyrore për zhvillimin lokal

Në vijim të logjikës së interpretimit të pyetjeve të seksioneve të pyetësorit të bëra më sipër, këtu analizohet seksioni i pyetjeve Q, që kanë të bëjnë me potencialin e burimeve natyrore për zhvillimin lokal. Për të arritur këtë analizohen pyetjet e seksionit Q të pyetësorit. Pyetjet e seksionit Q lidhen kryesisht me pyetjen: Cilat janë sipas jush aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për të realizuar një potencial të burimeve natyrore për zhvillimin lokal? Katër raste lidhen me këtë seksion, të cilët janë:

- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve;
- Përmirësimi i trajtimit të ujerave të zeza;
- Mbrojtja e lumenjve nga erozioni i shkaktuar nga njerëzit;
- Forcimi i ligjit për mbrojtjen e mjedisit.

Në vazhdim ilustron paraqitja grafike e përgjigjeve të marra nga pyetësi për këtë pyetje, sipas 4 rasteve të parashtruar. Mesataret e tyre lëvizin nga 4.1 deri në 4.3, të cilat tregojnë për një vlerësim

relativisht të lartë lidhur me aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për të realizuar një potencial të burimeve natyrore për zhvillimin lokal. Në shumicën e rasteve (boshti vertikal në grafikë), dominon përgjigja “Plotësisht” dhe “Shumë”. Dallohet lehtësisht shpërndarja thuajse e papërfillshme mes përqindjes që zënë përgjigjet e dhëna për opsionin “Aspak”, “Pak” dhe “As pak, as shumë”. Le të përqendrohemi te “Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve”. Ky rast ka marrë 38% të përgjigjeve në opsionin “Plotësisht” dhe 46% të përgjigjeve te opsioni “Shumë”, 8% e përgjigjeve te opsioni “As pak, as shumë”, pjesa tjetër prej 7% është ndarë mes opsioneve “Aspak”, dhe “Pak”, respektivisht 2% dhe 5%. Rasti i “Përmirësimit të ujërave të zeza” është një tematikë shumë aktuale në shumë njësi administrative, ndaj kërkon edhe vëmendjen e duhur edhe në analizë. Më shumë se gjysma e të anketuarve kanë thënë se janë “Plotësisht” dakord me përmirësimin e trajtimit të ujërave të zeza. Kjo shihet nga përqindja prej 53% në favor të këtij opsioni. Pas këtij renditet me përqindjen 29% opsioni “Shumë”. Opsionet e tjera të marra së bashku nuk e kapërcejnë dot as 18%. Për më shumë lidhur me shpërndarjen e përgjigjeve për secilën kategori, referohuni grafikut të mëposhtëm.




Figura 29. Shpërndarja e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetjeve të seksionit Q

Tabela më poshtë paraqet shpërndarjen e përgjigjeve të dhëna sipas qarqeve vetëm për pyetjen Q1, e cila është “Cilat janë sipas jush aktivitetet kryesore që duhet të ndërmerren për të realizuar një potencial të burimeve natyrore për zhvillimin lokal (Qarkun/bashkinë tuaj)? [Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve?]” Shenja * në qelizat e tabelës nënkupton se nga qarku përkatës është gjendur një intervistues që ka dhënë vlerësimin përkatës në krye të kolonës. Këtu bie në sy përqendrimi i përgjigjeve tek opsionet “Shumë” dhe “Plotësisht”, përse kohë edhe shenjat * gjenden në kolonat me titull “Shumë” dhe “Plotësisht” të përgjigjeve të pyetjes Q1.

Më konkretisht, vetëm në qarqet Berat dhe Vlorë ka njësi administrative që vlerësojnë në nivelin më të ulët (*aspak*) përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve si një aktiviteti që duhet të ndërmerret për realizimin e potencialit të burimeve natyrore për zhvillimin lokal, ndërkohë që vlerësimi më i lartë (*plotësisht*) është dhënë nga të paktën një njësi administrative për secilin qark, përjashtuar qarkun e

Korçës dhe të Kukësit. Në çdo qark ka njësi administrative që e gjykojnë si (*shumë*) të rëndësishëm përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve. Tabela në vijim jep një pamje më të qartë të kësaj që u tha këtu.

Tabela 10. Shpërndarja e përgjigjeve të pyetjes Q1 sipas qarqeve

	Cilat janë sipas jush aktivitetet kryesore që duhet të ndermerren për të realizuar një potencial e burimeve natyrore për zhvillimin lokal (Qarkun/ bashkinë tuaj)? [Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve?]				
	Aspak	Pak	As pak, as shumë	Shumë	Plotësisht
Në cilin qark banoni?	Berat *	*	*	*	*
	Dibër		*	*	*
	Durrës			*	*
	Elbasan			*	*
	Fier	*		*	*
	Gjirokastrë		*	*	*
	Korçë	*	*	*	
	Kukës			*	
	Lezhë		*	*	*
	Shkodër			*	*
	Tiranë	*	*	*	*
	Vlorë *			*	*

4.3 DISKUTIME MBI SEKTORËT PRIORITAR TË QARQEVE

Në dy tabelat në vijim ilustrohen sektorët prioritar sipas qarqeve. Vlerat në dy tabelat ndryshojnë nga njëra-tjetra, sepse në tabelën e parë jepen rezultatet e pyetjes “A ka rajoni juaj zona prioritare ndërhyrje të cilat janë parashikuar për rritje ekonomike rajonale?”, e cila lidhet me pyetjet 3 deri te 8 e seksionit E, ndërsa në tabelën e dytë tregohen rezultatet e pyetjes “Sa dakord jeni që sektorët e mëposhtëm t’i zhvillojnë në NJA tuaj?” Në një farë mënyre, tabela e parë raporton gjendjen *faktike*, ndërsa tabela e dytë raporton gjendjen *e dëshiruar*.

Le të analizohet tabela e gjendjes *faktike*. Qarku i Beratit ka zonë prioritarë *Turizmin*, pasi ka vlerën më të lartë mes sektorëve të tjerë.³⁴ Pas sektorit të turizmit, sektori i bujqësisë është konsideruar si ndikues të rritjes ekonomike rajonale të këtij qarku. Ashtu siç edhe mund të pritej, sektori i peshkimit konsiderohet si më i parëndësishmi për këtë qark. Qarku i Dibrës e mbështet rritjen ekonomike në sektorët e bujqësisë, të industrisë nxjerrëse, minerale dhe të pylltarisë. Qarku i Durrësit e mbështet rritjen ekonomike të rajonit mbi zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe të industrisë/manifakturës. Qarku i Elbasanit ka bujqësinë si sektor prioritar i parashikuar për rritjen ekonomike të rajonit. Sektori i bujqësisë është prioritar për rritjen ekonomike të qarkut të Fierit, i cili dallon qartësisht nga sektorët e tjerë. Qarku i Gjirokastrës ka parashikuar sektorin e turizmit dhe të bujqësisë si promotor të rritjes ekonomike rajonale. Qarku i Korçës ka sektorin e bujqësisë dhe të turizmit si kontribuues të rritjes ekonomike të rajonit në mënyrë të barabartë me njëri-tjetrin. Qarku i Kukësit ka vendosur pylltarinë si promotor të rritjes ekonomike rajonale. Sektori i turizmit është sektori prioritar i qarkut

³⁴ Simboli me kuadrate të vegjël synon të jap një pamje vizuale të madhësisë së shifrave në një kolonë, duke i renditur nga më i madhi të më i vogli. Pra, shifra më e madhe në një kolonë ka katër katrorët të hijezuar, ndërsa ajo më e vogla nuk ka asnjë ose ka vetëm një katror të hijezuar.

të Lezhës për rritjen ekonomike rajonale. Qarku i Shkodrës ka sektorin e turizmit dhe të bujqësisë si kontribuues të rritjes ekonomike rajonale. Qarku i Tiranës ka turizmin si sektor prioritar për mbështetjen e rritjes ekonomike rajonale dhe pas këtij sektori është sektori i industrisë/manifakturës. Rritja ekonomike rajonale e qarkut të Vlorës mbështet në sektorin e turizmit dhe të bujqësisë.

Tabela 11. Paraqitja e zhvillimit të sektorit sipas qarqeve, pyetja: A ka rajoni juaj zona prioritare ndërhyrje të cilat janë parashikuar për rritje ekonomike rajonale?

	Berat	Dibër	Durrës	Elbasan	Fier	Gjirokastrë	Korçë	Kukës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë
Bujqesi	2.5	3.2	3.5	3.9	3.6	2.6	2.9	3.3	3.4	3.4	2.4	3.0
Pylltari	2.1	3.0	2.3	3.3	2.6	2.4	2.3	4.0	3.3	3.0	2.0	2.8
Peshkim	1.3	2.1	2.0	1.4	2.1	1.0	2.4	1.5	3.4	2.6	1.7	2.4
Industri/manifakture	2.4	1.9	3.3	2.7	2.9	2.0	2.4	2.5	3.1	2.2	2.5	1.6
Industri nxjerrëse, minerale	1.9	3.2	1.2	2.7	2.9	1.4	1.9	2.8	2.0	2.0	1.7	2.8
Turizem	2.8	2.7	3.0	3.1	2.6	2.8	2.9	3.0	3.8	3.6	2.9	3.2

Në kontrast me gjendjen *faktike*, është evidentuar edhe gjendja *e dëshiruar*, sipas qarqeve në tabelën e mëposhtme. Qarku i Beratit mund të zhvillojë sektorin e turizmit,³⁵ të bujqësisë³⁶ dhe të industrisë/manifakturës. Qarku i Dibrës mund ta mbështesë rritjen ekonomike në sektorët e bujqësisë dhe pas tij në sektorin e pylltarisë. Për qarkun e Durrësit nuk ka ndonjë dallim midis gjendjes *faktike* dhe asaj *të dëshiruar*, përse kohë sektorët prioritar kanë mbetur të njëjtë: sektori i bujqësisë dhe i industrisë/manifakturës. Qarku i Elbasanit mund të ketë bujqësinë si sektor prioritar i parashikuar për rritjen ekonomike të rajonit, ashtu siç ishte në gjendjen *faktike*, mirëpo ai mund të zhvillojë edhe turizmin dhe industrinë/manifakturën. Sektori i bujqësisë ishte dhe mbetet sektori i dëshiruar prioritar për rritjen ekonomike të qarkut të Fierit, pra nuk ka dallime mes dy gjendjeve.

³⁵ Në fakt, ky ishte edhe në gjendjen *faktike*.

³⁶ Ky sektor në gjendjen *faktike*, renditej i dyti sipas rëndësisë së kontributit në rritjen ekonomike rajonale të qarkut të Beratit.

Tabela 12. Paraqitja e zhvillimit të sektorëve sipas qarqeve, pyetja: Sa dakord jeni që sektorët e mëposhtëm t'i zhvillonin në NJA tuaj?

	Berat	Dibër	Durrës	Elbasan	Fier	Gjirokastrë	Korçë	Kukës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë
Bujqesi	3.7	4.6	4.3	4.1	4.7	4.6	3.9	4.0	3.9	4.0	3.9	3.8
Pylltari	3.1	4.1	2.7	3.7	3.3	3.6	3.3	4.5	3.6	4.4	3.3	3.6
Peshkim	2.1	3.2	2.8	1.4	3.0	2.4	3.0	1.8	3.5	3.4	2.3	3.2
Industri/manifakturë	3.4	3.4	3.8	3.7	3.3	3.4	3.0	3.5	3.8	4.2	3.5	2.8
Industri nxjerrëse, minerale	2.8	3.9	1.3	2.7	2.9	1.8	2.4	2.8	3.1	3.0	2.4	2.8
Turizem	3.8	3.8	3.0	4.0	3.4	3.8	3.3	4.0	3.8	4.6	4.0	4.0

Qarku i Gjirokastrës mund të zhvillojë sektorin e bujqësisë dhe të turizmit, pak a shumë siç ishte parashtruar te gjendja faktike. Qarku i Korçës mund të zhvillojë sektorin e bujqësisë, ndërkohë që sektorët e turizmit dhe të pylltarisë konsiderohen si pasues të bujqësisë. Qarku i Kukësit përveç pylltarinë mund të zhvillojë edhe sektorët e bujqësisë dhe të turizmit. Sektori i bujqësisë, industrisë/manifakturës dhe turizmit mund të zhvillohen si sektori prioritarë të qarkut të Lezhës. Qarku i Shkodrës mund të zhvillojë sektorët e turizmit, të pylltarisë dhe të bujqësisë. Qarku i Tiranës mund të ketë turizmin dhe bujqësinë si sektor prioritar për mbështetjen e rritjes ekonomike rajonale dhe pas këtyre sektorëve është ai i industrisë/manifakturës. Rritja ekonomike rajonale e qarkut të Vlorës përveç turizmit mund ta mbështesë rritjen ekonomike edhe në sektorin e bujqësisë.

Në analizën krahasimre të zhvilluar për secilin qark dhe sektor në përputhje me paraqitjen e zhvillimit të sektorëve në gjendjen faktike dhe evidentimin e gjëndjes së dëshiruar vihet re se shumë qartë se sektorët të cilët aktualisht zhvillohen por dhe konfirmojnë fuqishëm zhvillimin në të gjitha qarqet janë i) bujqësi) turizmi iii) manifaktura (sektor të evidentuar me ngjyrë të verdhë).

Tabela 9/1/2: Diferencat midis zhvillimit aktual dhe atij te pritur sipas secilit qark

Sektoret	Berrat Ishte /behet		Dibër Ishte /behet		Durrës Ishte /behet		Elbasan Ishte /behet		Fier Ishte /behet		Gjirokastra Ishte /behet	
Bujqesi	2.5	3.7	3.2	4.6	3.5	4.3	3.9	4.1	3.6	4.7	2.6	4.6
Pylltari	2.1	3.1	3	4.1	2.3	2.7	3.3	3.7	2.6	3.3	2.4	3.6
Peshkim	1.3	2.1	2.1	3.2	2	2.8	1.4	1.4	2.1	3	1	2.4
Industri/manif	2.4	3.4	1.9	3.4	3.3	3.8	2.7	3.7	2.9	3.3	2	3.4

Ind/minerale	1.9	2.8	3.2	3.9	1.2	1.3	2.7	2.7	2.9	2.9	1.4	1.8
Turizem	2.8	3.8	2.7	3.8	3	3	3.1	4	2.6	3.4	2.8	3.8

Sektoret	Korce Ishte /behet		Kukes Ishte /behet		Lezha Ishte /behet		Shkod Ishte /behet		Tirana Ishte /behet		Vlora Ishte /behet	
Bujqesi	2.9	3.9	3.3	4	3.4	3.9	3.4	4	2.4	3.9	3	3.8
Pylltari	2.3	3.3	4	4.5	3.3	3.6	3	4.4	2	3.3	2.8	3.6
Peshkim	2.4	3	1.5	1.8	3.4	3.5	2.6	3.4	1.7	2.3	2.4	3.2
Industri/ manif	2.4	3	2.5	3.5	3.1	3.8	2.2	4.2	2.5	3.5	1.6	2.8
Ind/minerale	1.9	2.4	2.8	2.8	2	3.1	2	3	1.7	2.4	2.8	2.8
Turizem	2.9	3.3	3,0	4	3.8	3.8	3.6	4.6	2.9	4	3.2	4

4.4 CRONBACH ALPHA – BESUESHMËRIA

Besueshmëria e variablave vlerësohet përmes testit Cronbach alpha. Paketa e programit kompjuterik SPSS ka një komandë të veçantë për këtë test.³⁷ Në vijim janë vlerësuar besueshmëritë për grupet e variablave.

Kujtoj se grupi i parë është seksioni B: Ekonomia pjese e strategjisë rajonale të zhvillimit (për NJA tuaj), dhe përbëhet nga këto variabla:

- Keni ju një plan apo strategji për zhvillimin rajonal?
- Nëse po, strategjia juaj e përfshin ekonomin si një instrument për zhvillimin rajonal?
- Strategjia/ plani i zhvillimit rajonal përfshijnë shtyllat kryesore të rritjes ekonomike?
- Strategjia/plani i zhvillimit rajonal i referohet ekonomisë, por nuk përcakton qartë rrugët e rritjes ekonomike rajonale?
- Strategjia/ plani i zhvillimit rajonal nuk i referohet instrumentit të rritjes ekonomike?

Përmes analizës së besueshmërisë kërkohet që të shihet se sa përgjigjet e marra nga 4 pyetjet e fundit korrelojnë me njëri-tjetrin. Përfshihet pyetja e parë nga kjo analizë, sepse ajo është dikotomike. Logjika sugjeron që, nëse është marrë një përgjigje e caktuar për një pyetje, atëherë pritet që edhe përgjigja e dhënë për një pyetje tjetër të po këtij grupi është shumë pranë përgjigjes së pyetjes së parë. Nëse plotësohet ky kusht, atëherë mund të themi se dy variablat matin të njëjtën gjë dhe besueshmëria mes tyre është e lartë. Në thelb, testi Cronbach alpha mat këtë shkallë besueshmërie.

Më poshtë, tabela *Case Processing Summary* raporton për numrin e pyetësorëve të përfshirë në vlerësimin e testit Cronbach alpha për Seksionin B. Siç edhe duket, numri i rasteve të përfshirë nga analiza është 0.

Case Processing Summary		N	%
Cases	Valid	95	100.0
	Excluded ^a	0	.0
	Total	95	100.0

a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.

Tabela më e rëndësishme e testit të besueshmërisë është *Reliability Statistics*, pasi ajo raporton për shkallën e besueshmërisë brenda një numri të caktuar variablash. Shihet se për të matur besueshmërinë e këtij faktori janë përdorur 4 pyetje dhe koeficienti Cronbach Alpha del 0.774. Konsideruar parashtrimet për koeficientin e besueshmërisë të Kreu i Metodave dhe procedurave të kërkimit, mund të thuhet se 4 pyetje matin të njëjtën gjë. Numri 0.774 raporton për një nivel të pranueshëm të konsistencës mes pyetjeve. Kjo do të thotë se Seksioni B matur prej variablave që

³⁷ Analyze/Reliability.

kanë një konsistencë të pranueshme mes njëri-tjetrit, dhe si rrjedhojë përfundimet e nxjerra prej këtij seksioni janë të besueshme.

Reliability Statistics

Cronbach's Alpha	N of Items
.774	4

Tabela *Item-Total Statistics* informon mbi nivelin e koeficientit të besueshmërisë Cronbach alpha, nëse ndonjëri prej variablave largohet nga grupi. Shihet se largimi i pyetjes “Strategjia/ plani i zhvillimit rajonal nuk i referohet instrumentit të rritjes ekonomike?” jep një koeficient më të lartë, 0.800.

Item-Total Statistics

	Scale Mean if Item Deleted	Scale Variance if Item Deleted	Corrected Item-Total Correlation	Cronbach's Alpha if Item Deleted
[Nese po, strategjia juaj e perfshin ekonomin si nje instrument per zhvillimin rajonal ?]	7.76	7.462	.610	.703
[Strategjia/ plani i zhvillimit rajonal perfshijne shtyllat kryesore te rritjes ekonomike?]	7.84	6.943	.681	.662
[Strategjia/plani i zhvillimit rajonal i referohet ekonomise, por nuk percakton qarte rruget e rritjes ekonomike rajonale?]	8.09	7.704	.616	.701
[Strategjia/ plani i zhvillimit rajonal nuk i referohet instrumentit te rritjes ekonomike?]	8.39	8.623	.415	.800

Në të njëjtën logjikë është vepruar edhe me Seksionin C, matur përmes katër variablave. Më poshtë, tabela *Case Processing Summary* raporton për numrin e pyetësorëve të përfshirë në vlerësimin e testit Cronbach alpha për Seksionin C. Siç edhe duket, numri i rasteve të përjashtuar nga analiza është 28.

Case Processing Summary

		N	%
Cases	Valid	67	70.5
	Excluded ^a	28	29.5
	Total	95	100.0

a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.

Reliability Statistics

Cronbach's Alpha	N of Items
.821	5

Koeficienti Cronbach alpha për këto katër variabla rezulton të jetë 0.821. Ky është një nivel i mirë i besueshmërisë. Kjo nënkupton se konsistenca mes përgjigjeve të marra nga 5 pyetje është e pranueshme për të nënkuptuar se matin të njëjtën gjë.

Në mënyrë të përmblëdhur, tabela në vijim ilustron për rezultatin e këtij koeficienti për secilin seksion pyetjesh të përfshira në pyetësor. I vetmi seksion që shfaq probleme me besueshmërinë e matjes është seksioni K, pasi koeficienti rezulton 0.654, i cili është poshtë vlerës 0.7 që konsiderohet si niveli minimal i pranueshëm për besueshmërinë e përgjigjeve dhe matjen e të njëjtit konstrukt.

Seksioni	Cronbach's Alpha	Numri i pyetjeve
B	0.827	5
C	0.821	5
D	0.842	9
E	0.793	8
H	0.870	4
I	0.903	6
J	0.884	7
K	0.654	6
L	0.724	5
M	0.937	7
N	0.759	4
O	0.916	7
P	0.943	5
Q	0.836	4

Analiza e besueshmërisë rend të përforcojë idenë se pyetjet që janë përdorur për të matur një gjë të caktuar (seksionet) kanë një konsistencë të pranueshme. Kjo do të thotë se të intervistuarit e kanë plotësuar pyetësin me vetëdije të plotë dhe kanë qenë të kujdesshëm në dhënien e përgjigjeve, duke mos dhënë përgjigje apriori. Kjo është një gjetje me shumë vlerë, e cila i hap rrugë analizës së thelluar të problemit përmes metodave më të komplikuar, me synimin për të reduktuar numrin e madh të variablave dhe për të kuptuar se, sa dhe cilët janë faktorët e zhvillimit të rajoneve.

4.5 ANALIZA SIPAS BASENEVE UJORE

Një nga format e zhvillimit të territorit është ajo që mbështet mbi basenet ujore. Në Shqipëri, në maj të vitit 2016 është miratuar një Vendim i Këshillit të Ministrave mbi këto basene. Ky vendim ka bërë ndarjen e territorit vetëm mbi basenet ujore, pa marrë në konsideratë edhe faktorët tjerë. Kështu, nuk mund të shkojë në një basen ujqor Pogradecin dhe Shkodrën. Ndaj mendohet se është e logjikshme që ky vendim të modifikohet pak në funksion të realitetit. Konsideruar eksperiencën e punës në këtë fushë, njohjen e problemit prej kohësh, gjykohet si e arsyeshme që ndarja e territorit të bëhet sipas baseneve ujore si në vijim:

- 1) Baseni ujqor Drin-Bunë me qarqe Shkodër, Kukës, Lezhë;
- 2) Baseni ujqor i Matit me qarqun e Dibrës;
- 3) Baseni ujqor Ishëm-Erzen me qarqet Tiranë dhe Durrës;
- 4) Baseni ujqor i Shkumbinit me qarqun e Elbasanit;
- 5) Baseni ujqor Seman-Vjosë me qarqet Fier, Berat, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastër.

Synimi është që të shihet bëhet një dallim mbi *ekzistencën e sektorit prioritar, i cili është parashikuar për rritje ekonomike dhe se cili sektor duhet që të zhvillohen në një zonë të caktuar*. Këtë dallim e gjejmë përmes krahasimit të përgjigjeve të dhëna në pyetësin tonë lidhur me Seksionin E dhe Seksionin K.

Për të arritur këtë, fillimisht është koduar një variabël i veçantë sipas baseneve ujore, ku me 1 është shënuar baseni ujqor Drin-Bunë, me 2 baseni ujqor i Matit, me 3 baseni ujqor Ishëm-Erzen, me 4 baseni ujqor i Shkumbinit dhe me 5 Baseni ujqor Seman-Vjosë. Ky variabël është koduar me emrin *Baseni*.

Siç edhe kuptohet, ky është një variabël kategorik. Pas kodimit të baseneve ujore është ekzekutuar analiza faktoriale sipas baseneve ujore për grupin e pyetjeve të Seksionit E dhe K të pyetësorit. Analiza faktoriale do të përcaktojë për secilin basen faktorin që kontribuon në rritjen ekonomike dhe se cili faktor duhet që baseni të përqendrohet për zhvillimin ekonomik. Në vijim trajtohet ky krahasim sipas baseneve ujore të diskutuar më lartë.

4.5.1 Baseni ujq Drin-Bunë

Analiza faktoriale mund të evidentojë edhe sektorët që çojnë në zhvillimin e një baseni ujq. Siç është diskutuar edhe te kapitulli i metodave dhe procedurave, analiza faktoriale nxjerr faktorët kyç të një fenomeni ekonomik. Në këtë rast, analiza faktoriale evidenton sektorët prioritar të rritjes ekonomike të një baseni ujq.

Në tabelën në vijim jepet një krahasim i përgjigjeve të marra ndërmjet situatës aktuale (*fakt*) dhe situatës që synohet (*perspektiva* apo *pritja*). Secila situatë ka faktorët e grupuar sipas algoritmit të analizës faktoriale, sektorët e secilit faktor dhe përqindja e variacionit të faktorit pas rrotullimit.³⁸ Të njëjtën pamje ka edhe situata perspektivë apo e pritur: faktori, sektori dhe variacioni. Në situatën aktuale (*fakt*), në dy grupe janë grupuar faktorët e zhvillimit ekonomik të një baseni ujq: faktori 1 dhe faktori 2. Faktori 1 kompozohet nga 5 sektorë, të cilët sipas madhësisë së ndikimit janë: *Industri/manufakturë*, *Turizëm*, *Peshkim*, *Bujqësi* dhe *Pylltari*. Ky faktor, i përbërë nga 5 sektorë, e ka përqindjen e variacionit 56.78%. Faktori 2 kompozohet vetëm nga sektori *Industri nxjerrëse, minerale*. Ky e ka përqindjen e variacionit prej 19.517%. Shuma e dy përqindjeve të faktorëve është 76.297%. Këto dy faktorë apo komponentë shpjegojnë një masë të madhe të variacionit të përgjithshëm. Komponentët e tjerë i ka përjashtuar analiza faktoriale, mbështetur në kriterin e vlerave të veta. Sipas kësaj analize rezulton se sektori *Industri/manufakturë* përbën sektorin më të rëndësishëm prioritar që kontribuon në rritjen ekonomike të basenit ujq Drin-Bunë. Sektori më pak i rëndësishëm rezulton të jetë sektori *Pylltari*. Nga ana tjetër, sektori *Industri nxjerrëse, minerale* konsiderohet si një sektor i rëndësishëm së veçantë, i ndryshëm nga sektorët e tjerë meqë është edhe pjesë e faktorit apo komponentit të dytë. Vetëm ky sektor ka përqindjen e variacionit pas rrotullimit me metodën ortigonale Varimax prej gati 20%, në një kohë që 5 sektorët e tjerë e kanë rreth 57%.³⁹ Si përfundim, sektorët më të rëndësishëm për rritjen ekonomike aktuale të basenit ujq Diber-Bunë janë *Industri/manufakturë* dhe *Industri nxjerrëse, minerale*.

Tabela 13. Krahasimi i rezultateve të analizës faktoriale mes situatës fakt dhe asaj të pritura lidhur me sektorin prioritar të basenit ujq Drin-Bunë

Fakt			Pritet		
Faktori	Sektori	Variacioni	Faktori	Sektori	Variacioni
1	Industri/manifakture	56.780	1	Bujqësi	30.520
	Turizëm			Industri nxjerrëse, minerale	
	Peshkim			Pylltari	

³⁸ Metoda e rrotullimit e përdorur në këtë disertacion është VARIMAX, e cila nxjerr edhe numrin e faktorëve.

³⁹ Një pasqyrim më i plotë i kësaj analize gjendet te *Aneksi: Analiza faktoriale – Baseni ujq Drin-Bunë (1): Fakt*.

Bujqësi			Turizëm		
Pylltari			Industri/manifakture		
2	Industri nxjerrëse, minerale	19.517	3	Peshkim	23.936
Total		76.297	84.560		

Por çfarë ndodh me sektorët prioritar për basenin ujq Drin-Bunë kur flitet për prioritetet në të ardhme? A mbetet e njëjta shpërndarje e sektorëve siç ishte për situatën aktuale (*fakt*)? Po përqindja e variacioneve pas rrotullimit, a është e njëjtë? Për t'i dhënë përgjigje kësaj, në anën e djathtë të tabelës së mësipërme jepen përgjigjet e analizës faktoriale. Mbështetur në raportimet e analizës faktoriale, baseni ujq Drin-Bunë duhet t'i ndajë sektorët në 3 komponentë apo faktorë. Faktori i parë përbëhet nga sektori *Bujqësi, Industri nxjerrëse, minerale dhe Pylltari*; faktori i dytë kompozohet nga sektori *Turizëm dhe Industri/manifakture*; faktori i tretë përbëhet vetëm nga sektori i *Peshkimit*. Përqindja e variacionit të faktorit të parë pas rrotullimit është 30.52%, e faktorit të dytë 30.104% dhe e faktorit të tretë është 23.936%. Nga kjo kuptohet se, perspektiva e zhvillimit të sektorëve për basenin Drin-Bunë është kthimi i sektorit të *Bujqësisë* në prioritarë për rritjen ekonomike, të pasuar nga *Industria nxjerrëse, minerale*. Po ashtu, ky sektor kërkon që të nxjerrë si sektor prioritar *Turizmin dhe Peshkimin*, meqë udhëheqin faktorët përkatës.⁴⁰

Midis rezultateve të analizës faktoriale të situatës *fakt* dhe asaj që *pritet* gjenden ndryshime të mëdha, si në kuptimin e faktorëve, ashtu edhe në përqindjen e variacionit të secilit faktor apo komponent. Në total, variacioni i dy faktorëve për situatën *fakt* pas rrotullimit me procedurën varimax është 76.297%, ndërkohë që për situatën që *pritet* është 84.56%. deri diku pritej që rritja e numrit të komponentëve apo faktorëve do të çonte në një përqindje më të lartë të variacionit. Diferenca e përqindjeve të variacioneve mes dy situatave është 8.263% (= 84.56% – 76.297%).

Tabela në vijim ilustron një analizë më të thelluar për basenin ujq Drin-Bunë, duke u përqendruar vetëm te një sektor. Te tabela e mësipërme u dha krahasimi midis situatës *fakt* dhe asaj të *pritur*. Po ashtu, u evidentua se situata e *pritur* shpjegohej nga tre faktor, ku faktori i parë udhëhiqej nga sektori i *Bujqësisë*. Meqë kërkohet që të zhvillohet sektori i *Bujqësisë*, atëherë është e udhës të mendohet lidhur me zhvillimin e nënsektorëve të këtij sektori. Për të krijuar një ide më të plotë lidhur me këtë synim na vijnë në ndihmë pyetjet lidhur me nënsektorët e *Bujqësisë*. Për këtë, integrohen në analizën faktoriale pyetjet N1, N2 dhe N4 si dhe O1, O2, O3, O4 dhe O5, të cilat lidhen me sektorin e mësipërm dhe përfaqësojnë aspekte të tij. Rezultatet e analizës faktoriale për pyetjet e mësipërme janë përmbledhur në mënyrë sintetike në tabelën e mëposhtme. Dallohet se sektori bujqësor kompozohet nga dy faktorë. Faktori i parë kompozohet nga *Përmirësimi i infrastrukturës së tregut të produkteve rajonale, Promovimi i produkteve bio, Rritja e lidhjes ndërmjet turizmit dhe përpunimit të produkteve bujqësore, Përmirësimi i nivelit të subvencioneve bujqësore dhe Përmirësimi i aftësive profesionale për agrobujqësi*. Të gjithë së bashku, ata kanë një përqindje të variacionit pas rrotullimit varimax prej 37.461%.⁴¹ Dimensionin *Përmirësimi i infrastrukturës së tregut të produkteve rajonale* konsiderohet si më i rëndësishmi për sektorin e *Bujqësisë* të basenin ujq Drin-Bunë. Kjo do të thotë se për këtë basen ujq kërkohet një përmirësim i infrastrukturës së tregut të produkteve rajonale,

⁴⁰ Një pamje më të detajuar mund ta gjeni te Aneksi: Analiza faktoriale – Baseni ujq Drin-Bunë (1): Pritet.

⁴¹ Rezultatet e plota të kësaj analize jepen te Aneksi: Analiza faktoriale – Baseni ujq Drin-Bunë (1): Sektori Bujqësor.

madje është më i rëndësishmi për zhvillimin e *Bujqësisë*. Faktori apo komponenti tjetër *Prodhimet blegtorale*, *Prodhimet bujqësore* dhe *Bletari* dhe përqindja e variacionit të tyre është 28.196%. Prodhimet blegtorale konsiderohen si më të rëndësishme për këtë faktor, dhe nënkupton se baseni ujqor Drin-Bunë duhet të përqendrohet në këto prodhime.

Tabela 14. Rezultatet e analizës faktoriale për sektorin e Bujqësisë për basenin ujqor Drin-Bunë

Faktori	Nënspektori	Variacioni
1	Përmirësimi i infrastrukturës së tregut të produkteve rajonale	37.461
	Promovimi i produkteve bio	
	Rritja e lidhjes ndërmjet turizmit dhe përpunimit të produkteve bujqësore	
	Përmirësimi i nivelit të subvencioneve bujqësore	
	Përmirësimi i aftësive profesionale për agrobujqësi	
2	Prodhimet blegtorale	28.196
	Prodhimet bujqësore	
	Bletari	
Total		65.657

4.5.2 Baseni ujqor i Matit

Ashtu siç u veprua për evidentimin e sektorit prioritar të rritjes ekonomike të basenit ujqor Drin-Bunë, ashtu është vepruar edhe për basenin ujqor të Matit. Ky basen ujqor përbëhet vetëm nga qarku i Dibrës, i cili përmbledh disa njësi administrative.

Në tabelën në vijim jepet një krahasim i përgjigjeve të marra ndërmjet situatës aktuale (*fakt*) dhe situatës që synohet (*perspektiva* apo *pritja*) për basenin ujqor të Matit. Secila situatë ka faktorët e grupuar sipas algoritmit të analizës faktoriale, sektorët e secilit faktor si dhe përqindja e variacionit të faktorit pas rrotullimit me procedurën varimax. Të njëjtën pamje ka edhe situata perspektivë apo e pritur: faktori, sektori dhe përqindja e variacionit.

Për basenin ujqor të Matit, në situatën aktuale (*fakt*), në dy grupe janë grupuar faktorët e zhvillimit ekonomik të këtij baseni: faktori 1, faktori 2 dhe faktori 3. Faktori 1 kompozohet nga 2 sektorë, të cilët sipas madhësisë së ndikimit janë: *peshkimi* dhe *Turizmi*. Ky faktor, i përbërë nga 2 sektorët, e ka përqindjen e variacionit 35.11%. Faktori 2 kompozohet nga dy sektorë *Bujqësi* dhe *Pylltari*. Ky e ka përqindjen e variacionit në vlerën 25.931%. faktori i tretë kompozohet nga dy sektorët e tjerë të mbetur, që janë *Industri/manufakturë* dhe *Industri nxjerrëse, minerale*. Përqindja e variacionit të këtyre faktorëve është gati aq sa e faktorit të dytë, konkretisht 25.214%. Shuma e tre përqindjeve të variacionit të faktorëve është 86.255%. Këto tre faktorë apo komponentë shpjegojnë një masë të madhe të variacionit të përgjithshëm. Komponentët e tjerë i ka përjashtuar analiza faktoriale, mbështetur në kriterin e vlerave të veta. Sipas kësaj analize rezulton se sektori *Peshkim* përbën sektorin më të rëndësishëm prioritar që kontribuon në rritjen ekonomike të basenit ujqor të Matit. Sektori më pak i rëndësishëm rezulton të jenë sektorët *Turizëm*, *Pylltari* dhe *Industri nxjerrëse, minerale*. Nga ana tjetër, sektorët *Bujqësi* dhe *Industri/manufakturë* konsiderohen si sektorë të një rëndësie të veçantë, të ndryshëm nga sektorët e tjerë meqë udhëheqin edhe faktorët apo komponentit

përkatës.⁴² Si përfundim, sektorët më të rëndësishëm për rritjen ekonomike aktuale të basenit uxor të Matit janë *Peshkimi, Bujqësia dhe Industri/manifakturë*.

Tabela 15. Krahassimi i rezultateve të analizës faktoriale mes situatës fakt dhe asaj të pritura lidhur me sektorin prioritar të basenit uxor të Matit

Fakt			Pritet		
Faktori	Sektori	Variacioni	Faktori	Sektori	Variacioni
1	Peshkim	35.110	1	Bujqësi	48.996
	Turizëm				
2	Bujqësi	25.931		Industri/manifakturë	
	Pylltari			Industri nxjerrëse, minerale	
3	Industri/manifakturë	25.214		Pylltari	
	Industri nxjerrese, minerale		2	Peshkim	27.027
Total		86.255	76.023		

Por çfarë ndodh me sektorët prioritar për basenin uxor të Matit kur flitet për prioritetet në të ardhme, perspektivë? A mbetet e njëjta shpërndarje e sektorëve siç ishte për situatën aktuale (*fakt*)? Po përqindja e variacioneve pas rrotullimit, a është e njëjtë? Për t'i dhënë përgjigje kësaj, në anën e djathtë të tabelës së mësipërme jepen përgjigjet e analizës faktoriale për këtë basen uxor. Mbështetur në raportimet e analizës faktoriale, baseni uxor i Matit duhet t'i ndajë sektorët në 2 komponentë apo faktorë, ndryshe nga situata aktuale. Faktori i parë përbëhet nga sektori *Bujqësi, Turizëm, Industri/manifakturë, Industri nxjerrëse, minerale dhe Pylltari*. Faktori i dytë kompozohet vetëm nga sektori *Peshkim*, në ngjashmëri me basenin uxor Drin-Bunë. Përqindja e variacionit të faktorit të parë pas rrotullimit është gati 50% (konkretisht 48.996%). Faktori i dytë ka një përqindje të variacionit pas rrotullimit prej 27.027%. Nga kjo kuptohet se, perspektiva e zhvillimit të sektorëve për basenin uxor të Matit është kthimi i sektorit të *Bujqësisë* në prioritare për rritjen ekonomike. Po ashtu, ky basen uxor kërkon që të nxjerrë si sektor prioritar *Peshkimin*, meqë ky udhëheq faktorin e dytë.⁴³

Për basenin uxor të matit, midis rezultateve të analizës faktoriale të situatës *fakt* dhe asaj që *pritet* gjenden ndryshime të mëdha, si në kuptimin e faktorëve, ashtu edhe në përqindjen e variacionit të secilit faktor apo komponent. Në total, variacioni i dy faktorëve për situatën *fakt* pas rrotullimit me procedurën varimax është 86.255%, ndërkohë që për situatën që *pritet* është 76.023%. Deri diku pritej që ulja e numrit të komponentëve apo faktorëve do të çonte në një përqindje më të vogël të variacionit. Diferenca e përqindjeve të variacioneve mes dy situatave është 10.232% (= 86.255% – 76.023%).

Tabela në vijim ilustron një analizë më të theluar për basenin uxor të Matit, duke u përqendruar vetëm te një sektor. Te tabela e mësipërme u dha krahasimi midis situatës *fakt* dhe asaj të *pritur*. Po ashtu, u evidentua se situata e *pritur* shpjegohej nga dy faktor, ku faktori i parë udhëhiqej nga sektori

⁴² Një pasqyrim më i plotë i kësaj analize gjendet te Aneksi: Analiza faktoriale – Baseni uxor i Matit (2): Fakt.

⁴³ Një pamje më të detajuar mund ta gjeni te Aneksi: Analiza faktoriale – Baseni uxor i Matit (2): Pritet.

i *Bujqësisë*. Meqë kërkohet që të zhvillohet sektori i *Bujqësisë*, atëherë është e udhës të mendohet lidhur me zhvillimin e nënsektorëve të këtij sektori. Për të krijuar një ide më të plotë lidhur me këtë synim na vijnë në ndihmë pyetjet lidhur me nënsektorët e *Bujqësisë*. Për këtë, integrohen në analizën faktoriale pyetjet N1, N2 dhe N4 si dhe O1, O2, O3, O4 dhe O5, të cilat lidhen me sektorin e mësipërm dhe përfaqësojnë aspekte të tij.

Rezultatet e analizës faktoriale për pyetjet e mësipërme janë përmbledhur në mënyrë sintetike në tabelën e mësipërme. Dallohet se sektori bujqësor kompozohet nga katër faktorë. Faktori i parë kompozohet nga *Rritja e lidhjes ndërmjet turizmit dhe përpunimit të produkteve bujqësore, Përmirësimi i aftësive profesionale për agrobujqësi dhe Promovimi i produkteve bio*. Të gjithë së bashku, ata kanë një përqindje të variacionit pas rrotullimit varimax prej 29.701%.⁴⁴

Dimensioni *Rritja e lidhjes ndërmjet turizmit dhe përpunimit të produkteve bujqësore*, në ndryshim nga baseni ujqor Drin-Bunë, konsiderohet si më i rëndësishmi për sektorin e *Bujqësisë* të basenit ujqor i Matit. Kjo do të thotë se për këtë basen ujqor kërkohet një koordinim i turizmit me përpunimin e produkteve bujqësore, madje është më i rëndësishmi për zhvillimin e *Bujqësisë*. Faktori apo komponenti i dytë kompozohet nga *Përmirësimi i infrastrukturës së tregut të produkteve rajonale dhe Prodhimet bujqësore*. Përqindja e variacionit të tyre është 20.831%. Përmirësimi i infrastrukturës së tregut të produkteve rajonale konsiderohen si më i rëndësishëm për këtë faktor, dhe nënkupton se baseni ujqor i Matit duhet të përqendrohet në këtë aspekt.

Tabela 16. Përmbledhja e rezultateve të analizës faktoriale për sektorin e *Bujqësisë* për basenin ujqor të Matit

Faktori	Nënsektori	Variacioni
1	Rritja e lidhjes ndërmjet turizmit dhe përpunimit të produkteve bujqësore	29.701
	Përmirësimi i aftësive profesionale për agrobujqësi	
	Promovimi i produkteve bio	
2	Përmirësimi i infrastrukturës së tregut të produkteve rajonale	24.287
	Prodhimet bujqësore	
3	Bletari	20.831
	Prodhimet blegtorale	
4	Përmirësimi i nivelit të subvencioneve bujqësore	16.422
Total		91.241

Faktori i tretë përbëhet vetëm nga dy dimensione të sektorit ekonomik të *Bujqësisë*, të cilët janë: *Bletari* dhe *Prodhimet blegtorale*. Përqindja e variacionit për këto dy dimensione është 20.831%. Faktori i katërt dhe i fundit kompozohet vetëm nga një dimension që është *Përmirësimi i nivelit të subvencioneve bujqësore*. Ky është një aspekt shumë kritik për bujqësinë e këtij baseni ujqor. Mbështetja përmes subvencioneve merr një rëndësi të veçantë për bujqësinë e këtij baseni ujqor, meqë konsiderohet si një nga më të dobët mes baseneve të tjera ujqore. Vetëm ky dimension e ka

⁴⁴ Rezultatet e plota të kësaj analize jepen te Aneksi: Analiza faktoriale – Baseni ujqor i Matit (2): Sektori Bujqësor.

përqindjen e variacionit 16.422%, e cila konsiderohet si një masë e lartë. Të katër faktorët e mësipërm çojnë në 91.241% të përqindjes së variancës.

4.5.3 Baseni ujqor Ishëm-Erzen

Ashtu siç u veprua për evidentimin e sektorit prioritar të rritjes ekonomike të basenit ujqorë Drin-Bunë dhe atij të Matit, ashtu është vepruar edhe për basenin ujqor Ishëm-Erzen. Ky basen ujqor përbëhet vetëm nga qarqet e Tiranës dhe të Durrësit, i cili përmbledh disa njësi administrative.

Në tabelën në vazhdim jepet një krahasim i përgjigjeve të marra ndërmjet situatës aktuale (*fakt*) dhe situatës që synohet (*perspektiva* apo *pritja*) për basenin ujqor Ishëm-Erzen. Secila situatë ka faktorët e grupuar sipas algoritmit të analizës faktoriale, sektorët e secilit faktor si dhe përqindja e variacionit të faktorit pas rrotullimit me procedurën varimax. Të njëjtën pamje ka edhe situata perspektivë apo e pritur: faktori, sektori dhe përqindja e variacionit.

Për basenin ujqor Ishëm-Erzen, në situatën aktuale (*fakt*), në dy grupe janë grupuar faktorët e zhvillimit ekonomik të këtij baseni: analiza faktoriale ka evidentuar vetëm një faktor për këtë situatë. Faktori 1 kompozohet nga 6 sektorë, të cilët sipas madhësisë së ndikimit janë: *Peshkim*, *Pylltari*, *Bujqësi*, *Industri nxjerrëse*, *minerale*, *Turizëm* dhe *Industri/manifakturë*. Ky faktor, i përbërë nga 6 sektorët, e ka përqindjen e variacionit 55.614%. Shuma e përqindjeve të variacionit të faktorëve përkon me vetë vlerën e përqindjes së variacionit të faktorit të parë, që është 55.614%. Ky faktor apo komponent shpjegon një masë të madhe të variacionit të përgjithshëm. Komponentët e tjerë i ka përjashtuar analiza faktoriale, mbështetur në kriterin e vlerave të veta. Sipas kësaj analize rezulton se sektori *Peshkim* përbën sektorin më të rëndësishëm prioritar që kontribuon në rritjen ekonomike të basenit ujqor Ishëm-Erzen. Sektori më pak i rëndësishëm rezulton të jenë sektorët *Industri/manifakturë* dhe *Turizëm*. Nga ana tjetër, sektorët *Peshkimit* dhe *Pylltaria* konsiderohen si sektorë të një rëndësie të veçantë, të ndryshëm nga sektorët e tjerë meqë udhëheqin edhe faktorin apo komponentin përkatës.⁴⁵ Si përfundim, sektorët më të rëndësishëm për rritjen ekonomike aktuale të basenit ujqor Ishëm-Erzen janë *Peshkimi*, *Pylltaria* dhe *Bujqësia*.

Por çfarë ndodh me sektorët prioritar për basenin ujqor Ishëm-Erzen kur flitet për prioritetet në të ardhme, perspektivë? A mbetet e njëjta shpërndarje e sektorëve siç ishte për situatën aktuale (*fakt*)? Po përqindja e variacioneve pas rrotullimit, a është e njëjtë? Për t'i dhënë përgjigje kësaj, në anën e djathtë të tabelës së mësipërme jepen përgjigjet e analizës faktoriale për këtë basen ujqor. Mbështetur në raportimet e analizës faktoriale, baseni ujqor Ishëm-Erzen duhet t'i ndajë sektorët në 2 komponentë apo faktorë, ndryshe nga situata aktuale, e cila kishte vetëm një faktor. Faktori i parë përbëhet nga sektori *Pylltari*, *Bujqësi* dhe *Peshkim*. Faktori i dytë kompozohet nga sektorët *Industri/manifakturë*, *Turizëm* dhe *Industri nxjerrëse*, *minerale*. Përqindja e variacionit të faktorit të parë pas rrotullimit është 30% (konkretisht 31.612%). Faktori i dytë ka një përqindje të variacionit pas rrotullimit prej 24.396%. Nga kjo kuptohet se, perspektiva e zhvillimit të sektorëve për basenin ujqor Ishëm-Erzen është kthimi i sektorit të *Pylltarisë* në sektor prioritar për rritjen ekonomike të basenit ujqor. Ky sektor, pasohet nga *Bujqësia*, e cila renditet e dyta te komponenti apo faktori i parë.

⁴⁵ Një pasqyrim më i plotë i kësaj analize gjendet te Aneksi: *Analiza faktoriale – Baseni ujqor Ishëm-Erzen (3): Fakt*.

Tabela 17. Krahasoni mes vlerave fakt dhe atyre të pritura lidhur me sektorin prioritar të basenit ujqor Ishëm-Erzen

Fakt			Pritet		
Faktori	Spektori	Variacioni	Faktori	Spektori	Variacioni
1	Peshkim	55.614	1	Pylltari	31.612
	Pylltari			Bujqësi	
	Bujqësi			Peshkim	
	Industri nxjerrëse, minerale		2	Industri/manifakture	24.396
	Turizëm			Turizëm	
	Industri/manifakture			Industri nxjerrëse, minerale	
Total		55.614	56.008		

Po ashtu, ky basen ujqor kërkon që të nxjerrë si sektor prioritar *Industrinë/manifakturën*, meqë ky udhëheq faktorin e dytë.⁴⁶ Fill pas këtij sektori vjen sektori i *Turizmit*, i cili justifikohet shumë sidomos me faktin se pjesë e këtij baseni ujqor është bregdeti i Durrësit, qyteti i Krujës dhe qyteti i Tiranës. Në situatën *pritet* është bërë një evidentim i një faktori shumë të rëndësishëm për këtë basen ujqor: sektori *Industri/manifakturë*. Kujtoj se pjesë e këtij sektori është zhvillimi i biznesit privat. Biznesi privat përbën edhe kontributorin më të madh në rritjen ekonomike të këtij baseni ujqor. Numri i madh i bizneseve që veprojnë në këtë basen ujqor, krahasuar me basenet e tjera ujqore, justifikon edhe kalimin e këtij sektori si prioritar. Përqendrimi te ky sektor ekonomik pritet të fuqizojë rritjen ekonomike të basenit ujqor të Ishëm-Erzenit.

Për basenin ujqor Ishëm-Erzen, midis rezultateve të analizës faktoriale të situatës *fakt* dhe asaj që *pritet* gjenden ndryshime të mëdha, si në kuptimin e faktorëve, ashtu edhe në përqindjen e variacionit të secilit faktor apo komponent. Në total, variacioni i dy faktorëve për situatën *fakt* pas rrotullimit me procedurën varimax është 55.614%, ndërkohë që për situatën që *pritet* është 56.008%. Deri diku pritej që rritja e numrit të komponentëve apo faktorëve do të çonte në një përqindje më të lartë të variacionit. Diferenca e përqindjeve të variacioneve mes dy situatave është shumë e vogël, 0.394% (= 56.008% – 55.614%).

Tabela në vijim ilustron një analizë më të thelluar për basenin ujqor Ishëm-Erzen, duke u përqendruar vetëm te një sektor. Te tabela e mësipërme u dha krahasimi midis situatës *fakt* dhe asaj të *pritur*. Po ashtu, u evidentua se situata e *pritur* shpjegohej nga dy faktor, ku faktori i dytë udhëhiqej nga sektori i *Industri/manifakturë*. Meqë kërkohet që të zhvillohet sektori ekonomik *Industri/manifakturë*, atëherë është e udhës të mendohet lidhur me zhvillimin e dimensioneve të këtij sektori. Për të krijuar një ide më të plotë lidhur me këtë synim na vijnë në ndihmë pyetjet lidhur me dimensionet e sektorit *Industri/manifakturë*. Për këtë, integrohen në analizën faktoriale pyetjet P1, P2, P3, P4 dhe P5 si dhe Q1, Q2, Q3 dhe Q4, të cilat lidhen me sektorin e mësipërm dhe përfaqësojnë dimensionet apo aspekte të tij.

⁴⁶ Një pamje më të detajuar mund ta gjeni te Aneksi: Analiza faktoriale – Baseni ujqor Ishëm-Erzen (3): Pritet.

Tabela 18. Përmbledhja e rezultateve të analizës faktoriale për sektorin e Industri/manufakturë për basenin ujqor Ishëm-Erzen

Faktori	Nësektori	Variacioni
1	Mbështetja financiare për sipërmarrësit e rinj	44.506
	Krijimi i hapësirave për punësimin e të diplomuarave në këto biznese	
	Ofrimi i trajnimeve specifike për menaxheret e rinj	
	Lehtësim i mundësive për investimeve që vijnë nga emigrantet	
	Zhvillimi i arsimit formimit profesional	
2	Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve	27.518
	Përmirësimi i trajtimit të ujërave të zeza	
	Mbrojtja e lumenjve nga erozioni i shkaktuar nga njerëzit	
	Forcimi i ligjit për mbrojtjen e mjedisit	
Total		72.024

Rezultatet e analizës faktoriale për pyetjet e mësipërme janë përmbledhur në mënyrë sintetike në tabelën e mëposhtme. Dallohet se sektori bujqësor kompozohet nga dy faktorë. Faktori i parë kompozohet nga *Mbështetja financiare për sipërmarrësit e rinj*, *Krijimi i hapësirave për punësimin e të diplomuarave në këto biznese*, *Ofrimi i trajnimeve specifike për menaxheret e rinj*, *Lehtësim i mundësive për investimeve që vijnë nga emigrantet* dhe *Zhvillimi i arsimit formimit profesional*. Të gjithë së bashku, ata kanë një përqindje të variacionit pas rrotullimit varimax prej 44.506%.⁴⁷ Dimensioni *Mbështetja financiare për sipërmarrësit e rinj* konsiderohet si më i rëndësishmi për sektorin e *Industri/manufakturës* të baseni ujqor Ishëm-Erzen. Kjo do të thotë se për këtë basen ujqor kërkohet një mbështetje financiare për sipërmarrësit e rinj, madje është më i rëndësishmi për zhvillimin e sektorit ekonomik *Industri/manufakturës*. Menjëherë pas këtij dimensionit renditet *Krijimi i hapësirave për punësimin e të diplomuarave në këto biznese*.

Faktori apo komponenti tjetër kompozohet nga dimensionet apo aspektet si: *Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve*, *Përmirësimi i trajtimit të ujërave të zeza*, *Mbrojtja e lumenjve nga erozioni i shkaktuar nga njerëzit* dhe *Forcimi i ligjit për mbrojtjen e mjedisit*. Përqindja e variacionit të tyre është 27.518%. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve konsiderohen si aspekti më i rëndësishëm për këtë faktor, dhe nënkupton se baseni ujqor Ishëm-Erzen duhet të përqendrohet në këtë problematikë. Dimensioni tjetër që e pason këtë aspekt është shumë i ngjashëm me këtë, konkretisht *Përmirësimi i trajtimit të ujërave të zeza*. Pra, në këtë basen ujqor kërkohet që vëmendja të përqendrohet te përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve dhe te përmirësimi i trajtimit të ujërave të zeza, që deri duku përfaqësojnë aspekte të ngjashme. Të dy faktorët e mësipërm kanë një përqindje totale të variancës prej 72.024% (= 44.506 + 27.518).

⁴⁷ Rezultatet e plota të kësaj analize jepen te Aneksi: Analiza faktoriale – Baseni ujqor Ishëm-Erzen (3): Sektori Industri/manufakturë.

4.5.4 Baseni ujour i Shkumbinit

Ashtu siç u veprua për evidentimin e sektorit prioritar të rritjes ekonomike të basenit ujourë Drin-Bunë, atij të Matit dhe të basenit ujour Ishëm-Erzen, ashtu është vepruar edhe për basenin ujour të Shkumbinit. Ky basen ujour përbëhet vetëm nga qarku i Elbasanit, i cili përmbledh disa njësi administrative.

Në tabelën në vijim jepet një krahasim i përgjigjeve të marra ndërmjet situatës aktuale (*fakt*) dhe situatës që synohet (*perspektiva* apo *pritja*) për basenin ujour të Shkumbinit. Secila situatë ka faktorët e grupuar sipas algoritmit të analizës faktoriale, sektorët e secilit faktor si dhe përqindja e variacionit të faktorit pas rrotullimit me procedurën varimax. Të njëjtën pamje ka edhe situata perspektivë apo e pritur: faktori, sektori dhe përqindja e variacionit.

Për basenin ujour të Shkumbinit, në situatën aktuale (*fakt*), në dy grupe janë grupuar faktorët e zhvillimit ekonomik të këtij baseni: faktori 1, faktori 2 dhe faktori 3. Faktori 1 kompozohet nga 3 sektorë, të cilët sipas madhësisë së ndikimit janë: *Industri/manifaktura*, *Peshkim* dhe *Pylltari*. Ky faktor, i përbërë nga 3 sektorët, e ka përqindjen e variacionit 33.291%. Faktori 2 kompozohet nga dy sektorë *Bujqësi* dhe *Industri nxjerrëse, minerale*. Ky e ka përqindjen e variacionit në vlerën 27.663%. Faktori i tretë kompozohet vetëm nga sektori i mbetur, që është *Turizmi*. Përqindja e variacionit e këtij faktori është gati aq sa e faktorit të dytë, konkretisht 26.669%. Shuma e tre përqindjeve të variacionit të faktorëve është 87.623%. Këto tre faktorë apo komponentë shpjegojnë një masë të madhe të variacionit të përgjithshëm. Komponentët e tjerë i ka përjashtuar analiza faktoriale, mbështetur në kriterin e vlerave të veta. Sipas kësaj analize rezulton se sektori *Industri/manifaktura* përbën sektorin më të rëndësishëm prioritar që kontribuon në rritjen ekonomike të basenit ujour të Shkumbinit. Sektori më pak i rëndësishëm rezulton të jenë sektorët *Peshkim* dhe *Pylltari*. Nga ana tjetër, sektorët *Bujqësi* dhe *Turizmi* konsiderohen si sektorë të një rëndësie të veçantë, të ndryshëm nga sektorët e tjerë meqë udhëheqin edhe faktorët apo komponentit përkatës.⁴⁸ Si përfundim, sektorët më të rëndësishëm për rritjen ekonomike aktuale të basenit ujour të Shkumbinit janë *Industri/manifaktura*, *Bujqësia* dhe *Turizmi*.

Por çfarë ndodh me sektorët prioritar për basenin ujour të Shkumbinit kur flitet për prioritetet në të ardhme, perspektivë (*pritet*)? A mbetet e njëjta shpërndarje e sektorëve siç ishte për situatën aktuale (*fakt*)? Po përqindja e variacioneve pas rrotullimit, a është e njëjtë? Për t'i dhënë përgjigje kësaj, në anën e djathtë të tabelës së mësipërme jepen përgjigjet e analizës faktoriale për këtë basen ujour. Mbështetur në raportimet e analizës faktoriale, baseni ujour i Shkumbinit duhet t'i ndajë sektorët në 2 komponentë apo faktorë, ndryshe nga situata aktuale, e cila kishte 3 faktorë. Faktori i parë përbëhet nga sektori *Bujqësi*, *Peshkim* dhe *Industri/manifaktura*. Faktori i dytë kompozohet nga sektorët *Turizëm*, *Industri nxjerrëse, minerale* dhe *Pylltari*. Përqindja e variacionit të faktorit të parë pas rrotullimit është 40% (konkretisht 41.263%). Faktori i dytë ka një përqindje të variacionit pas rrotullimit prej 34% (konkretisht 34.273%). Nga kjo kuptohet se, perspektiva e zhvillimit të sektorëve për basenin ujour të Shkumbinit është kthimi i sektorit të *Bujqësisë* në sektor prioritar për rritjen ekonomike të basenit ujour. Ky sektor, pasohet nga *Peshkimi*, i cila renditet i dyti te komponenti apo faktori i parë.

⁴⁸ Një pasqyrim më i plotë i kësaj analize gjendet te *Aneksi: Analiza faktoriale – Baseni ujour i Shkumbinit (4): Fakt*.

Tabela 19. Krahasoni mes vlerave fakt dhe atyre të pritura lidhur me sektorin prioritar të basenit ujqor të Shkumbinit

Fakt			Pritet		
Faktori	Sektori	Variacioni	Faktori	Sektori	Variacioni
1	Industri/manifakture	33.291	1	Bujqësi	41.263
	Peshkim			Peshkim	
	Pylltari			Industri/manifakture	
2	Bujqësi	27.663	2	Turizëm	34.273
	Industri nxjerrëse, minerale			Industri nxjerrëse, minerale	
3	Turizëm	26.669			
Total		87.623	75.536		

Po ashtu, ky basen ujqor kërkon që të nxjerrë si sektor prioritar *Turizëm*, meqë ky udhëheq komponentin apo faktorin e dytë.⁴⁹ Fill pas këtij sektori vjen sektori i *Industri nxjerrëse, minerale*, i cili justifikohet shumë sidomos me faktin se pjesë e këtij baseni ujqor është Elbasani dhe Librazhdi. Në situatën *pritet* është bërë një evidentim i një faktori shumë të rëndësishëm për këtë basen ujqor: sektori *Bujqësia*. Kujtoj se pjesë e këtij sektori është zhvillimi i blegtorisë dhe bujqësisë. Ky basen ka kushte të përshtatshme për ta zhvilluar këtë sektor.

Për basenin ujqor të Shkumbinit, midis rezultateve të analizës faktoriale të situatës *fakt* dhe asaj që *pritet* gjenden ndryshime të mëdha, si në kuptimin e faktorëve, ashtu edhe në përqindjen e variacionit të secilit faktor apo komponent. Në total, variacioni i dy faktorëve për situatën *fakt* pas rrotullimit me procedurën varimax është 87.623%, ndërkohë që për situatën që *pritet* është 75.536%. Deri diku pritej që rritja e numrit të komponentëve apo faktorëve do të çonte në një përqindje më të lartë të variacionit. Diferenca e përqindjeve të variacioneve mes dy situatave është shumë e vogël, 12.087% (= 87.623% – 75.536%).

Tabela në vijim ilustron një analizë më të thelluar për basenin ujqor të Shkumbinit, duke u përqendruar vetëm te një sektor. Te tabela e mësipërme u dha krahasimi midis situatës *fakt* dhe asaj të *pritur*. Po ashtu, u evidentua se situata e *pritur* shpjegohej nga dy faktor, ku faktori i parë udhëhiqej nga sektori i *Bujqësisë*. Meqë kërkohet që të zhvillohet sektori ekonomik *Bujqësia*, atëherë është e udhës të mendohet lidhur me zhvillimin e dimensioneve të këtij sektori. Për të krijuar një ide më të plotë lidhur me këtë synim na vijnë në ndihmë pyetjet lidhur me dimensionet e sektorit të *Bujqësisë*. Për këtë, integrohen në analizën faktoriale pyetjet N1, N2 dhe N4 si dhe O1, O2, O3, O4 dhe O5, të cilat lidhen me sektorin e mësipërm dhe përfaqësojnë dimensionet apo aspekte të tij.

Tabela 20. Përmbledhja e rezultateve të analizës faktoriale për sektorin e Bujqësisë për basenin ujqor të Shkumbinit

Faktori	Nësektori	Variacioni
---------	-----------	------------

⁴⁹ Një pamje më të detajuar mund ta gjeni te Aneksi: Analiza faktoriale – Baseni ujqor i Shkumbinit (4): Pritet.

1	Prodhimet blegtorale	44.099
	Prodhimet bujqësore	
	Rritja e lidhjes ndërmjet turizmit dhe përpunimit të produkteve bujqësore	
	Përmirësimi i aftësive profesionale për agrobujqësi	
	Bletari	
2	Përmirësimi i nivelit të subvencioneve bujqësore	33.144
	Promovimi i produkteve bio	
	Përmirësimi i infrastrukturës së tregut të produkteve rajonale	
Total		77.243

Rezultatet e analizës faktoriale për pyetjet e mësipërme janë përmbledhur në mënyrë sintetike në tabelën e mëposhtme. Dallohet se sektori bujqësor kompozohet nga dy faktorë. Faktori i parë kompozohet nga *Prodhimet blegtorale*, *Prodhimet bujqësore*, *Rritja e lidhjes ndërmjet turizmit dhe përpunimit të produkteve bujqësore*, *Përmirësimi i aftësive profesionale për agrobujqësi* dhe *Bletari*. Të gjithë së bashku, ata kanë një përqindje të variacionit pas rrotullimit varimax prej 44.099%.⁵⁰ Dimensionin *Prodhimet blegtorale* konsiderohet si më i rëndësishmi për sektorin e *Bujqësisë* të basenit ujor i Shkumbinit. Kjo do të thotë se për këtë basen ujor kërkohet që zhvillimi i bujqësisë të përqendrohet te prodhimet blegtorale, madje është më i rëndësishmi për zhvillimin e sektorit ekonomik të Bujqësisë. Menjëherë pas këtij dimensionit renditet *Prodhimet bujqësore*.

Faktori apo komponenti tjetër kompozohet nga dimensionet apo aspektet si: *Përmirësimi i nivelit të subvencioneve bujqësore*, *Promovimi i produkteve bio* dhe *Përmirësimi i infrastrukturës së tregut të produkteve rajonale*. Përqindja e variacionit të tyre është 33.144%. Përmirësimi i nivelit të subvencioneve bujqësore konsiderohen si aspekti më i rëndësishëm për këtë faktor, dhe nënkupton se baseni ujor i Shkumbinit duhet të përqendrohet në këtë problematikë. Dimensionin tjetër që e pason këtë aspekt është *Promovimi i produkteve bio*, i cili shkon shumë përshtat me dimensionin e fundit të përfshirë në këtë komponentë që është: *Përmirësimi i infrastrukturës së tregut të produkteve rajonale*. Pra, në këtë basen ujor kërkohet që vëmendja të përqendrohet te përmirësimi i nivelit të subvencioneve bujqësore dhe te Promovimi i produkteve bio. Të dy faktorët e mësipërm kanë një përqindje totale të variancës prej 77.243% (= 44.099% + 33.144%).

4.5.5 Baseni ujor Seman-Vjosë

Ashtu siç u veprua për evidentimin e sektorit prioritar të rritjes ekonomike të basenit ujorë Drin-Bunë dhe atij të Matit dhe Ishëm-Erzenit, ashtu është vepruar edhe për basenin ujor Seman-Vjosë. Ky basen ujor përbëhet vetëm nga qarqet e Fier, Berat, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë, i cili përmbledh disa njësi administrative.

Në tabelën në vazhdim jepet një krahasim i përgjigjeve të marra ndërmjet situatës aktuale (*fakt*) dhe situatës që synohet (*perspektiva* apo *pritja*) për basenin ujor Seman-Vjosë. Secila situatë ka faktorët e grupuar sipas algoritmit të analizës faktoriale, sektorët e secilit faktor si dhe përqindja e variacionit

⁵⁰ Rezultatet e plota të kësaj analize jepen te Aneksi: Analiza faktoriale – Baseni ujor i Shkumbinit (4): Sektori Bujqësi.

të faktorit pas rrotullimit me procedurën varimax. Të njëjtën pamje ka edhe situata perspektivë apo e pritur: faktori, sektori dhe përqindja e variacionit.

Për basenin ujqor Seman-Vjosë, në situatën aktuale (*fakt*), në dy grupe janë grupuar faktorët e zhvillimit ekonomik të këtij baseni: analiza faktoriale ka evidentuar 2 faktorë për këtë situatë. Faktori 1 kompozohet nga 4 sektorë, të cilët sipas madhësisë së ndikimit janë: *Bujqësi*, *Pylltari*, *Industri/manufakturë* dhe *Industri nxjerrëse, minerale*. Ky faktor, i përbërë nga katër sektorët, e ka përqindjen e variacionit 41.648%. Faktori 2 kompozohet vetëm nga sektorët *Turizëm* dhe *Peshkim*. Ky e ka përqindjen e variacionit prej 22.004%. Shuma e dy përqindjeve të faktorëve është 63.652%. Këto dy faktorë apo komponentë shpjegojnë një masë të madhe të variacionit të përgjithshëm. Komponentët e tjerë i ka përjashtuar analiza faktoriale, mbështetur në kriterin e vlerave të veta. Sipas kësaj analize rezulton se sektori *Bujqësi* përbën sektorin më të rëndësishëm prioritar që kontribuon në rritjen ekonomike të basenit ujqor Seman-Vjosë. Sektori më pak i rëndësishëm rezulton të jetë sektori *Industri nxjerrëse, minerale*. Nga ana tjetër, sektori *Turizëm* konsiderohet si një sektor i rëndësishëm së veçantë, i ndryshëm nga sektorët e tjerë meqë është edhe pjesë e faktorit apo komponentit të dytë. Vetëm ky sektor dhe ai i *Peshkimit* e kanë përqindjen e variacionit pas rrotullimit me metodën ortigonale Varimax prej 22%, në një kohë që 4 sektorët e tjerë e kanë rreth 42%.⁵¹ Si përfundim, sektorët më të rëndësishëm për rritjen ekonomike aktuale të basenit ujqor Seman-Vjosë janë sektorët *Bujqësi* dhe *Turizëm*.

Por çfarë ndodh me sektorët prioritar për basenin ujqor Seman-Vjosë kur flitet për prioritetet në të ardhme, perspektivë (*pritet*)? A mbetet e njëjta shpërndarje e sektorëve siç ishte për situatën aktuale (*fakt*)? Po përqindja e variacioneve pas rrotullimit, a është e njëjtë? Për t'i dhënë përgjigje kësaj, në anën e djathtë të tabelës së mëposhtme jepen përgjigjet e analizës faktoriale për këtë basen ujqor. Mbështetur në raportimet e analizës faktoriale, baseni ujqor Seman-Vjosë duhet t'i ndajë sektorët në 2 komponentë apo faktorë, ashtu siç ishte te situata aktuale (*fakt*), e cila kishte dy faktorë. Faktori i parë përbëhet nga sektori *Bujqësi*, *Industri nxjerrëse, minerale*, *Industri/manufakturë* dhe *Pylltari*. Faktori i dytë kompozohet nga sektorët *Turizëm* dhe *Peshkim*. Përqindja e variacionit të faktorit të parë pas rrotullimit është 40% (konkretisht 41.302%). Faktori i dytë ka një përqindje të variacionit pas rrotullimit prej 23.791%. Nga kjo kuptohet se, perspektiva e zhvillimit të sektorëve për basenin ujqor Seman-Vjosë është përqendrimi te sektori i *Bujqësi* në sektor prioritar për rritjen ekonomike të basenit ujqor. Ky sektor, pasohet nga *Industri nxjerrëse, minerale*, e cila renditet i dyti te komponenti apo faktori i parë. Ky sektor merr rëndësi të veçantë sidomos pas vendimit për ndërtimin e TAP-it, i cili kalon në këtë basen ujqor.

Po ashtu, ky basen ujqor kërkon që të evidentojë si sektor prioritar *Turizmin*, meqë ky udhëheq faktorin e dytë.⁵² Fill pas këtij sektori vjen sektori i *Peshkimit*, i cili justifikohet shumë sidomos me faktin se pjesë e këtij baseni ujqor është bregdeti i Vlorës, Delvinës dhe Sarandës. Në situatën *pritet* është bërë një evidentim i faktorit të dytë shumë të rëndësishëm për këtë basen ujqor: sektori *Turizëm*. Kujtoj se pjesë e këtij sektori është zhvillimi i biznesit privat i llojit të shërbimeve apo të hoteleri-turizmit. Numri i madh i bizneseve që veprojnë në këtë basen ujqor, krahasuar me basenet e tjera ujore, justifikon edhe kalimin e këtij sektori si prioritar. Përqendrimi te ky sektor ekonomik pritët të fuqizojë rritjen ekonomike të basenit ujqor të Seman-Vjosës.

⁵¹ Një pasqyrim më i plotë i kësaj analize gjendet te *Aneksi: Analiza faktoriale – Baseni ujqor Seman-Vjosë (5): Fakt*.

⁵² Një pamje më të detajuar mund ta gjeni te *Aneksi: Analiza faktoriale – Baseni ujqor Seman-Vjosë (5): Pritet*.

Tabela 21. Krahësimi mes vlerave fakt dhe atyre të pritura lidhur me sektorin prioritar të basenit ujqor Seman-Vjqosë

Fakt			Pritet		
Faktori	Spektori	Variacioni	Faktori	Spektori	Variacioni
1	Bujqësi	41.648	1	Bujqësi	41.302
	Pylltari			Industri nxjerrëse, minerale	
	Industri/manifakturë			Industri/manifakturë	
	Industri nxjerrëse, minerale			Pylltari	
2	Turizëm	22.004	2	Turizëm	23.791
	Peshkim			Peshkim	
Total		63.652			65.093

Për basenin ujqor Seman-Vjqosë, midis rezultateve të analizës faktoriale të situatës *fakt* dhe asaj që *pritet* gjenden ndryshime të vogla, si në kuptimin e renditjes së sektorëve brenda një faktori, ashtu edhe në përqindjen e variacionit të secilit faktor apo komponent. Në total, variacioni i dy faktorëve për situatën *fakt* pas rrotullimit me procedurën varimax është 63.652%, ndërkohë që për situatën që *pritet* është 65.093%. Diferenca e përqindjeve të variacioneve mes dy situatave është e vogël, 1.441% (= 65.093% – 63.652%).

Tabela në vijim ilustron një analizë më të thelluar për basenin ujqor Seman-Vjqosë, duke u përqendruar vetëm te një sektor. Te tabela e mësipërme u dha krahasimi midis situatës *fakt* dhe asaj të *pritur*. Po ashtu, u evidentua se situata e *pritur* shpjegohej nga dy faktor, ku faktori i dytë udhëhiqej nga sektori i *Turizmit*. Meqë kërkohet që të zhvillohet sektori ekonomik *Turizëm*, atëherë është e udhës të mendohet lidhur me zhvillimin e dimensioneve të këtij sektori. Për të krijuar një ide më të plotë lidhur me këtë synim na vijnë në ndihmë pyetjet lidhur me dimensionet e sektorit *Turizëm*. Për këtë, integrohen në analizën faktoriale pyetjet L1, L2, L3, L4 dhe L5, të cilat lidhen me sektorin e mësipërm dhe përfaqësojnë dimensionet apo aspekte të tij.

Rezultatet e analizës faktoriale për pyetjet e mësipërme janë përmbledhur në mënyrë sintetike në tabelën e mëposhtme. Dallohet se sektori i *Turizmit* kompozohet nga dy faktorë. Faktori i parë kompozohet nga *Turizëm malor veror*, *Turizëm kulturor/fetar*, *Turizëm malor dimëror* dhe *Agroturizëm*. Të gjithë së bashku, ata kanë një përqindje të variacionit pas rrotullimit varimax prej 54.886%.⁵³ Dimensioi *Turizëm malor veror* konsiderohet si më i rëndësishmi për sektorin e *Turizmit* te baseni ujqor Seman-Vjqosë. Kjo do të thotë se për këtë basen ujqor kërkohet që zhvillimi i turizmit të përqendrohet te turizmi malor veror, madje është më i rëndësishmi për zhvillimin e sektorit ekonomik të *Turizmit*. Menjëherë pas këtij dimensionit renditet *Turizëm kulturor/fetar*.

Faktori apo komponenti tjetër kompozohet nga vetëm nga dimensionit apo aspekti i *Turizëm i rrës dhe detit*. Përqindja e variacionit të tij është 20.895%. Pra, në këtë basen ujqor kërkohet që vëmendja e

⁵³ Rezultatet e plota të kësaj analize jepen te Aneksi: Analiza faktoriale – Baseni ujqor i Seman-Vjqosë (5): Sektori Turizmi.

zhvillimit të turizmit të përqendrohet te *Turizëm i rërës dhe detit*. Pse ky dimension është evidentuar si komponent më vete? Përgjigja është shumë e thjeshtë: turizmi i rërës dhe detit merr jetë vetëm në disa zona të basenit ujor të Seman-Vjosës. Të dy faktorët e mësipërm kanë një përqindje totale të variancës prej 75.781% (= 54.886% + 20.895%).

Tabela 22. Përmbledhja e rezultateve të analizës faktoriale për sektorin e Bujqësisë për basenin ujor Seman-Vjosë

Faktori	Nënsektori	Variacioni
1	Turizëm malor veror	54.886
	Turizëm kulturor/fetar	
	Turizëm malor dimëror	
	Agroturizëm	
2	Turizëm i rërës dhe detit	20.895
Total		75.781

4.6 PËRMBLEDHJE MBI BASENET UJORE

Tabela në vijim jep një përmbledhje të kombinimit të sektorëve me basenet ujore. Kombinimi i tyre është shënuar me një kod në formën e raportit s/f , ku s nënkupton pozicionin e sektorit ekonomik brenda një faktori, ndërsa f -ja i referohet faktorit në të cilin ndodhet ky sektor. Le të themi, numri 2/1 nënkupton se për atë basen ujor, ky sektor ekonomik është renditur si sektori i dytë ($s = 2$) në faktorin e parë ($f = 1$). Ngjyra e verdhë synon të tërheqë vëmendjen drejt sektorëve prioritar të faktorit të parë për çdo basen ujor. Është përdorur ngjyrë tjetër për ato kombinime që janë 1/2 dhe ngjyrë tjetër për kombinimin 1/3, me synimin për të bërë dallime mes tyre (Për më shumë shiko tabelën në vijim).

Tabela 23. Përmbledhja e rezultateve të analizës faktoriale për sektorin e Bujqësisë për basenin ujor Drin-Bunë

Sektori	Baseni ujor				
	Drin-Bunë	Mat	Ishëm-Erzen	Shkumbin	Seman-Vjosë
Bujqësi	1/1	1/1	2/1	1/1	1/1
Pylltari	3/1	5/1	1/1	3/2	4/1
Peshkim	1/3	1/2	3/1	2/1	2/2
Industri/manifakture	2/2	3/1	1/2	3/1	3/1
Industri nxjerrëse, minerale	2/1	4/1	3/2	2/2	2/1
Turizëm	1/2	2/1	2/2	1/2	1/2

Si përfundim, sektori ekonomik i bujqësisë kërkohet të jetë prioritar në basenet ujore të Drin-Bunës, Matit, Shkumbinit dhe të Seman-Vjosës. Sektori ekonomik i pylltarisë kërkohet nga intervistuesit që të jetë sektor prioritar për basenin ujor Ishëm-Shkumbin. Këto dy sektor ekonomik rezultojnë të jenë të parët në faktorin e parë të nxjerrë nga analiza faktoriale. Kjo do të thotë se rëndësia e tyre perceptohet shumë e lartë për basenet përkatëse, meqë janë pozicionuar edhe si udhëheqësit e faktorëve apo komponentit të parë.

Kombinime interesante janë edhe ata që kanë kodet $1/f$, për f të ndryshme nga 1, sepse për rastin kur $f = 1$, merren rezultatet e mësipërme. Kur $f = 2$ shihet se sektori ekonomik i peshkimit rezulton të jetë sektori që udhëheq faktorin e dytë të basenit ujor të Matit. Pra, baseni ujor i Matit kërkohet që të zhvillojë sektorin ekonomik të bujqësisë dhe të peshkimit. Ky sektor ekonomik kërkohet të ketë rëndësi të veçantë për basenin ujor Drin-Bunë, meqenëse ka rezultuar të jetë udhëheqësi i komponentin apo faktorit të tretë për këtë basen ujor (1/3, ku $s = 1$ dhe $f = 3$). Baseni ujor Drin-Bunë ka mundësitë dhe kushtet e përshtatshme për ta zhvilluar këtë sektor ekonomik. Në këtë aspekt kontribuojnë burimet ujore të shumta që e përshkojnë këtë basen ujor. Është rasti i liqenit të

Shkodrës, ujëmbledhësit e Fierzës, Komanit dhe Ulzës dhe sidomos lumi Buna, të cilët përbëjnë burimin kryesor për të peshkuar dhe për ta zhvilluar këtë sektor ekonomik.

Sektori i industrisë/manufakturës kërkohet të konsiderohet si sektor prioritar i basenit ujor Ishëm-Erzen, meqë ky sektor udhëheq komponentin apo faktori e dytë. Rikujtoj se ky sektor lidhet ngushtë me përfaqësimin e bizneseve. Në të vërtetë, numri më i madh i bizneseve në Shqipëri gjenden në këtë basen ujor. Kjo mund të çojë në justifikimin e këtij rezultati për këtë basen ujor.

Sektori ekonomik i turizmit kërkohet të nxirret si sektor i veçantë i rritjes ekonomike i baseneve ujore të Drin-Bunës, Shkumbinit dhe të Seman-Vjosës. Logjika e mbështet këtë përfundim të marrë nga analiza faktoriale, pasi këto basene ujore kanë kapacitete të vërteta për ta zhvilluar një sektor të tillë ekonomik.

KREU 5

PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

5.1 PËRFUNDIME

Analiza empirike i bën jehonë zhvillimit të rajoneve në Shqipëri sipas baseneve ujore. Një nga përfundimet apo konkluzionet më të vlefshme të këtij studimi është se për zhvillimin e rajoneve, politikat publie duhet përqendrohen te sektorët prioritar.

Për secilin rajon evidentohet shkalla prioritare e sektorëve ekonomikë. Në katër nga pesë basenet ujore kërkohet që sektori i bujqësisë duhet të udhëheqë zhvillimin ekonomik të basenit përkatës.

Në tre nga pesë basene ujore, tregohet se sektori i turizmit kërkon një vëmendje të veçantë për zhvillimin ekonomik, sepse udhëheq një komponentë të veçantë.

Sektori i ekonomisë industri/manufakturë merr një rol të rëndësishëm për basenin ujqor Ishëm-Erzen. Në këtë basen shtrihet Durrësi dhe Tirana, vende ku numri i bizneseve është shumë i madh dhe sipas analizës empirike tregohet se ata mund të çojnë në rritje ekonomike.

Në analizën krahsimore të zhvilluar për secilin qark dhe sektor në përputhje me paraqitjen e zhvillimit të sektorëve në gjëndjen faktike dhe evidentimin e gjëndjes së dëshiruar vihet re se shumë qartë se sektorët të cilët aktualisht zhvillohen por dhe konfirmojnë fuqishëm zhvillimin në të gjitha qarqet janë i) bujqësi) turizmi iii) manifaktura.

Bazuar në analizën studimore te rajoneve vihet re që:

- **Infrastruktura ekonomike (p.sh.,manifaktura,bizneset/parqet industriale).** Ashtu si qendrat më të rëndësishme ekonomike rajonale, polet e rritjes kanë tendencë të jenë punëdhënësit kryesore në rajon. Zhvillimi i infrastrukturës ekonomike në polet e rritjes, në përputhje me dinamikat e qarta, në fund të fundit do të sjellë përfitime jo vetëm për polet e rritjes, por për rajonin në tërësi
- **Infrastruktura e shërbimeve publike.** Në Shqipëri një pjesë e madhe e popullsisë vazhdon të ketë akses të ulët në infrastrukturën rrugore , ujqin e rrjedhshëm, kanalizime, gaz, ngrohje, apo edhe energjinë elektrike. Shumica e njerëzve me akses të ulët në shërbimet publike jetojnë në zonat e vogla urbane dhe në zonat rurale. Shumicën e kohës këto njësi nuk kanë fonde për të financuar/bashkë-financuar më shumë investimet e nevojshme në shërbimet publike. Për këtë arsye mund të konsiderohet më e përshtatshme të përcaktohen përparësitë e këtyre investimeve në nivel rajonal, bazuar në: mjetet e disponueshme, nevojatë përcaktuara qartë, dhe qëndrueshmërinë aktuale të investimeve të tilla. Në mënyrë të ngjashme, projekte

të mëdha rehabilitimi janë më të nevojshme në polet e rritjes, por mund të kenë një ndikim që shkon përtej vetëm qendrave urbane.

- **Infrastruktura e ndërlidhjes rajonale.** Masivizimi dhe urbanizimi ekonomik janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e një rajoni, dhe rajonet duhet të kenë pushtetin që të përcaktojnë dhe zbatojnë projekte të ndërlidhjes infrastrukture që kanë rëndësi rajonale. Investimet në rrugët nacionale dhe rajonale duhet të bëhen në mënyrë të integruar dhe strategjike, për të mundësuar rritjen e aksesit të njerëzve në lehtësira (p.sh., punë, shëndetësi, arsim, kulturë) dhe për të mundësuar një akses më të gjerë në qendrat ekonomike dinamike.
- **Infrastruktura turistike /kulturore.** Qëdrat më të mëdha të banuara (kryesisht bashkitë e nivelit të parë) shpesh grumbullojnë numrin më të madh të siteve kulturore në rajon dhe përfshijnë disa vende të trashëgimisë që janë karakteristike për kulturën e gjithërajonit. Rrjedhimisht, ruajtja dhe rehabilitimi i këtyre vendeve mund të jetë me rëndësi kritike për rajonin. Turizmi është një tjetër fushë me një rëndësi rajonale, dhe zhvillimi i tij duhet të jetë i integruar dhe i bazuar në një qasje rajonale.

5.2 REKOMANDIME

Kërkohet që njësitë përgjegjëse të hartimit të politikave strategjike të zhvillimit në bazë të rajonit, të konsiderojnë gjetjet e këtij studimi, sepse këtu evidentohen edhe sektorët prioritar të secilit basen ujor. Konsideromi i përfundimeve të këtij studimi çon në argumentimin e strategjisë përkatëse mbi baza empirike.

Rrjedhimisht, përcaktimi i zonave funksionale zhvillimore sipas ndarjes administrative territoriale dhe krijimi i nje strukture qeverisjes përkatëse per Shqipërinë është shumë e rëndësishme. Si rezultat, sfida kryesore për Shqipërinë në kontekstin e metabolizmit rajonal bazuar ne orientimet e BE –së është zhvillimi dhe zbatimi i programeve të integruara.

Rritje të ofertës publike qoftë në rritje të cilësisë së shërbimeve shumë të rëndësishme të tilla si ujësjellësat dhe kanalizimet, infrastruktura rrugore, transporti publik, menaxhimi i integruar mbetjeve por edhe të kapacitetit investues vendor si në vlerë absolute të investimit ashtu edhe në rritjen e efijencës së investimeve publike vendore.

Rritje të efijencës së përdorimit të parave publike si rezultat i mundësisë për të planifikuar zona të reja zhvillimi atje ku ka potencial dhe për të kufizuar zhvillimet në zona ku kostoja e shtetit është tepër e lartë përkundrejt ruajtjes së vlerave historike apo traditës së zonës.

Hapësirën e nevojshme për të krijuar skema ekonomike të zhvillimit të biznesit të vogël dhe të mesëm si dhe një klimë më miqësore ndaj tij, në një harmozim të kërkesës për konsum dhe punësim me ofertën tregtare të orientuar nga sektori publik vendor.

- **Autoriteti i Auditimit** - Agjencia për Auditimin e Sistemit të Zbatimit të Programeve të Bashkimit Evropian, përgjegjëse për auditimin e menaxhimit dhe përdorimit të fondeve të BE-së.

- Fondi Kombëtar (NF): autoriteti qendror i ngritur si thesar në vendet përfituese nëpërmjet të cilit kanalizohen fondet e para-aderimit. Ai organizon dhe menaxhon llogaritë bankare, paraqet kërkesën për fonde nga komisioni Evropian, siguron transfertat e fondit në strukturat operacionale apo përfituesit finalë dhe është përgjegjës para NAO-s (NF është njësi organizative brenda Ministrisë së Financës)

- **Përfituesit** - në varësi të programit operativ, përfituesit e mundshëm paraqesin kërkesën e tyre për projekt propozimeve të financuara nga instrumentet strukturore të BE-së. Ata janë përgjegjës për zbatimin e projekteve të tyre në të cilat është zbatuar procedura e veçantë e prokurimi publik (në lidhje me furnizimin e pajisjeve, kryerjen e punëve ose ofrimi i shërbimeve - në varësi të aktivitetëve të projektit).

Skema e Strukturës Institucionale për Fondet Strukturore

Politika e Kohezionit ka një **Autoritet Menaxhues** (Ministrinë së Zhvillimit Rajonal dhe Fondeve të BE-së), një **Autoritet Pagues** (Ministrinë e Financave) dhe një **Institucion Kontrolli Financiar** të pavarur (Ministria e Financave, Zyra e mbikëqyrjes së buxhetit)



⁵⁶ Para-aderimit: Kordinimi kombëtar IPA, CODEF

		Zhvillimi Rajonal		
Programet Operacionale		Komponenti IPA IIIa Transporti ⁵⁷	Komponenti IPA IIIb Ambienti ⁵⁸	Komponenti IPA IIIb Konkurueshmëria Rajonale ⁵⁹
Autoriteti Menaxhues		Ministria e Punëve Detare, Transportit dhe Infrastrukturës (MSTI) ⁶⁰ <i>Drejtoria e Zhvillimit Rajonal të Integruar</i>	Ministria e Mjedisit dhe Mbrojtjes së Natyrës (MENP) ⁶¹ <i>Drejtoria e Objekteve infrastrukturore strategjike</i>	Ministria e Ekonomisë (ME) <i>Drejtoria për Konkurueshmërinë dhe Investimet</i> <i>Sektori i Konkurueshmërisë</i>
Strukturat e Ndërmjetme	Niveli I	HŽ Infrastruktura (www.hzn.hr/HZI nfrastruktura)	Environment Protection and Energy Efficiency Fund (www.gfzoeu.hr), Hrvatske vode (www.voda.hr)	Central Financing and Contracting Agency (CFCA www.safu.hr)
	Niveli II	Agjensitë Qendrore Financiare dhe Kontraktuese (CFCA www.safu.hr)		

Autoriteti Certifikues
Fondi Kombëtar (NF)
brenda Ministrisë së Financave

Autoriteti i Auditimit
Autoriteti Kombëtar i Auditit
(institucion i pavarur, brenda Ministrisë së Financave)

Agjensitë e Zhvillimit Rajonal:

Në nivel kombëtar, MRDEUF⁶² vepron si **institucioni koordinues për** çështjet e zhvillimit rajonal. Në nivel rajonal dhe lokal, qarqet dhe qytetet e mëdha kanë krijuar agjencitë e zhvillimit duke

⁵⁷Transport Operational Programme – Priority Axis 2 (Upgrading Croatia’s Inland Waterway System in Croatia) and Priority Axis 3 (Technical Assistance)

⁵⁸Priority Axis 3 (Technical Assistance)

⁵⁹ Priority Axis 1 (Improvement of the developmental potential of less developed areas), Priority Axis 2 (Enhancing the competitiveness of Croatian economy, Priority Axis 3 (Technical Assistance)

⁶⁰ MSTI - Ministry of Maritime Affairs, Transport and Infrastructure

⁶¹ MENP - Ministry of Environmental and Nature Protection. Më parë: MEPPC - Ministry of Environmental Protection, Physical Planning & Construction

përfshirë qendrave të mbështetjes së sipërmarrjes, qendra të teknologjisë, inkubatorë biznesi dhe biznese të tjera.

Agjencitë e Zhvillimit Rajonal (RDAs) në Kroaci (Razvojne Agencije u RH), synojnë të promovojnë zhvillimin ekonomik të rajoneve në përputhje me planet dhe strategjitë si dhe të koordinojë planet dhe strategjitë e politikave të zhvillimit rajonal në nivel kombëtar dhe implementimin e tyre në nivel më të ulët.

Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Fondeve të BE-së është institucioni lider i Zhvillimit Rajonal, e ndihmuar nga **Agjencia e Zhvillimit Rajonal** (ARR www.arr.hr) e cila koordinon projektet e zhvillimit rajonal duke vendosur dhe ruajtur kontaktet me aktorët e tjerë, ofrimin e asistencës teknike. Agjencia për Zhvillimin Rajonal⁶³ është një institucion i rëndësishëm në implementim pjesën e politikës së zhvillimit rajonal të juridiksionit kroat të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe Fondeve të BE-së (MRDEUF).

Pas një auditimi të suksesshëm, Agjencia ARR është akredituar nga Komisioni Evropian dhe çertifikuar si **institucion zbatues dhe autoritet kontraktues për komponentin IPA IIb i cili përfshin programin e bashkëpunimit ndër-kufitar**.

ARR përbëhet nga trupat e Këshillit Drejtues të Agjencisë dhe drejtori i Agjencisë. Bordi drejtues përbëhet nga tre anëtarë (struktura e ARR, figura 2)

Një numër agjencish rajonale janë themeluar dhe akredituar për të nxitur zhvillimin rajonal (shih aneks tabela 1).

Roli dhe Detyrat e Agjencisë së Zhvillimit të Qarkut (AZhQ)

Kuadri ligjor për Zhvillimin Rajonal parashikon që AZhQ-të (Agjencitë e Zhvillimit të Qarkut) të bëhen institucionet kyçe të zhvillimit ekonomik në nivel rajonal (NUTS 3 dhe ku është e përshtatshme NUTS 2) si dhe do të luajnë një rol kyç në realizimin e SZhQ⁶⁴, të NSRD, si dhe programeve Evropiane të Fondit Struktural në nivel qarku dhe ndër-qarkor.

Të 21 qarqet në Kroaci, duke përfshirë qytetin e Zagrebit kanë krijuar tashmë një AZhQ. Në shumicën e rasteve roli kryesor i AZhQ është zbatimi i SZHQ, pavarësisht edhe pse disa AZhQ kanë gjithashtu një funksion më të gjerë në koordinimin e zhvillimit ekonomik në qark, duke përdorur, burimet lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ka një variacion të larmishëm në kapacitetin e AZhQ-ve të matur me numrin dhe ekspertizën e stafit, dhe burimeve financiare të disponueshme për kostot e tyre të funksionimit.

Detyrat për të cilat AzhQ-ja është përgjegjëse mund të grupohen në 3 kategori:

1. funksionet ligjore që garanton ligji për zhvillimin rajonal, pjesë e përgjegjësisë nën NSRD. Për të siguruar dhe për të marrë akreditimin, duhet që AZhQ--të të rekrutojnë dhe të sigurojnë një staf të mjaftueshëm të kualifikuar dhe të trajnuar për të kryer detyrat efektivisht. AZhQ i jep ndihmë Qarkut në përgatitjen e SZHQ. SZHQ do të jetë dokumenti kryesor i planifikimit për zhvillimin e qëndrueshëm social – ekonomik të qarkut. AZhQ mund të ndihmojë Qarkut në përgatitjen e SZHQ, në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Partneritetit të Qarkut. Në

⁶² MRDEUF - Ministry of Regional Development and EU Funds (Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Fondeve të BE-së)

⁶³ Themeluar me Rregulloren për krijimin e Agjencisë për Zhvillimin Rajonal të Republikës së Kroacisë (OG 155/08), 24 prosinca viti 2008.

⁶⁴ Në nivel NUTS III – nivel qarku, janë themeluar agjencitë e zhvillimit rajonal. Gjithashtu dokumentet e zhvillimit rajonal të quajtura programe operacionale rajonale janë përgatitur dhe disa prej tyre janë përmirësuar në strategji të zhvillimit të qarkut/rajonat në nivel NUTS III.

- marrëveshje me Këshillin, AZhQ mund të jetë përgjegjëse për përgatitjen e SZhQ. AZhQ duhet të jetë në përputhje të plotë me Udhëzimet Kombëtare të Investimeve Sektoriale.
2. aktivitetin e zhvillimit ekonomik që një AZhQ mund të kryejë në marrëveshje me qarkun ose institucione klientë të tjera. AZhQ promovon qarkut si një vend për investime private, zhvillim biznesi dhe turizmi, jep mbështetje për sipërmarrësit dhe NVM-ve, promovon thithjen e investime të nevojshme të huaja dhe vendase. Është pikë informacioni për shërbimet kombëtare dhe ndërkombëtare të financimit, sigurimin e financimit të NVM-ve /inovacionit përmes fondit të garancisë dhe kapitaleve sipërmarrjes; ndërtimi i kapacitetit institucional, rrjeteve të sektorit publik, biznesit dhe kërkimit shkencor, transferimin e teknologjisë, komercializimin e risisë dhe zhvillimi i infrastrukturës të lidhur me biznesin.
 3. aktivitete komerciale që një AZhQ mund të ndërmarrë përsëri me marrëveshjen e Qarkut në mënyrë që të gjenerojnë të ardhura, por jo fitim.
 - ndërmarrja e studimeve të fizibilitetit ose puna e zhvillimit të projektit për promovuesit e projekteve dhe palëve të tjera për sa kohë që kjo nuk do të çojë në konflikt interesi në lidhje me detyrat e tjera të AZhQ-së
 - përgatitja e kërkesave për mbështetje financiare nga burimet e financimit kombëtar ose ndërkombëtar
 - organizimin e ngjarjeve të biznesit, konferenca, etj në ambiente të qarkut
 - promovimin dhe implementimin e projekteve ose në nivelin e qarkut ose në bashkëpunim me një grupi qarqesh fqinj.

AZhQ duhet të kryejnë veprimtari komerciale/tregtare në normat e tregut, duke paguar me vlerë të plotë kostot ekonomike të stafit, si dhe shpenzimet e përgjithshme reale të organizimit/funksionimit. Përveç kësaj, duke ditur se AZhQ do të jetë një agjenci jo-fitim prurëse, ajo duhet të sigurojë që çdo e ardhur e tepërt është investuar në aktivitetet e zhvillimit të AZhQ-së.

Procesi i Akreditimit për AZhQ

MRDFËM përmes ARD është përgjegjëse për akreditimin e AZhQ-së në konsultim me ministrinë e tjera. **Vetëm një AZhQ-së akreditohet** për qarkun. Akreditimi është një njohje zyrtare që organizata plotëson standardet e kërkuara institucionale dhe dëshiron të marrë përgjegjësi të caktuara në këmbim të financimeve dhe mbështetjeve të tjera praktike nga qeveria. Akreditimi njeh AZhQ si përfaqësuese zyrtare të atij qarku, dhe e bën AZhQ eligible për mbështetje financiare nga MRDFËM në bazë të marrëveshjeve të cituara më poshtë. AZhQ është përgjegjëse për kryerjen e detyrave të përcaktuara në NSRD në qarkun e tij dhe duhet që të vazhdojë të përmbushë kriteret e akreditimit për të ruajtur statusin e saj.

Procesi i akreditimit do të jetë si më poshtë:

- ARD në emër të MRDFËM i kërkon çdo Qarku t'i propozojë një AZhQ për akreditim .
- Qarkut do të japë provat e kërkuar nga AZhR për të mundësuar që AZhQ-së të vlerësohet sipas kriterëve të mëposhtme:
 - që AZhQ është themeluar si një kompani publike jo-fitimprurëse në nivelin e qarkut;
 - që njësia rajonale e vetëqeverisjes e ka themeluar ose ka miratuar themelimin e AZhQ;
 - që vetëqeverisjes rajonale është e angazhuar për të siguruar mbështetje financiare AZhQ së për të plotësuar ndonjë grant nga Ministria;
 - që Partneriteti i Qarkut është konsultuar nga njësia rajonale e qeverisjes në lidhje me krijimin e AZhQ dhe e përshtypjet e saj janë marrë parasysh;
 - që AZhQ është kompletuar në mënyrë adekuate dhe me staf kompetent dhe pajisje.

Qarkut gjithashtu siguron të dhëna për kualifikimin e stafit ekzistues të AZhQ dhe një plan buxheti 3 vjeçar në një format që do të ofrohen nga AZhR. AZhR organizon trajnime dhe mbështetje për të adresuar ndonjë çështje të veçantë të identifikuar në procesin e vlerësimit. AZhR gjithashtu rezervon të drejtën për të lëshuar një akreditim të përkohshme vazhdimësi e të cilit është i varur nga përmbushja e disa kushteve në një afta të përcaktuar. Për shembull në qoftë se vlerësimi fillestar tregon se një AZhQ nuk plotëson asnjë nga standardet e kërkuara, AZhR do të diskutojë çështjen me AZhQ dhe Qarkut dhe do të pajtohen në një plan veprimi që do të mundësojë AZhQ për të arritur standardet e nevojshme.

Pasi AZhQ gjykohet se ka përmbushur me sukses standardet, AZhR në emër të Ministrisë do të dërgojë një letër akreditimit të AZhQ dhe administratës së qarkut që konfirmon statusin e akredituar të AZhQ dhe përcakton marrëveshjet për akreditimin e vazhdueshme dhe mbështetjen financiare.

Kontributi Financiar i AZhQ

Në mënyrë që të ndihmojë zhvillimin e AZhQ dhe për të siguruar që ata të mund të kontribuojnë për qëllimet e NSRD, qeveria jep mbështetje financiare për shpenzimet e tyre vjetore dhe kostot fillestare të themelimit. Grupi i punës ndër-Ministror ka rënë dakord që MRDFEM përmes ARD do të jetë përgjegjës për financimin e këtyre kostove operative.

Ministria ka një zë më vete në buxhet për mbështetje të AZhQ -së. Shuma të veçanta do të mbahet përsëri për të bashkë-financuar koston e konsulencës së jashtme për të ndihmuar në përgatitjen e SZHQ -së , dhe për të financuar ndonjë trajnim sistematik dhe zhvillim nevojash të identifikuar për AZhQ. Këto fonde do të ndahen në bazë të një të marrëveshje të veçantë. Kontributi i Ministrisë së Financave për shpenzimet e operimit të AZhQ do të bëhen në përputhje me një formulë të bazuar në Indeksin e Zhvillimit të Qarkut , dhe do të reduktohet me kalimin e kohës. Ajo do të jetë e rëndësishme për të drejtuar burimet jo vetëm për aty ku janë të nevojshme, por në sasi të mjaftueshme për të siguruar një nxitje reale për të AZhQ për të kërkuar akreditimin.

Probleme në menaxhimin e fondeve të BE-së

Raportet vjetore të auditit financiar nga Gjykatë Europiane e Auditit në mënyrë të vazhdueshme kanë konstatuar se kapaciteti i prokurimeve dhe anti-korrupsioni është një nga parregullsitë kryesore të vendeve anëtare në menaxhimin e fondit të kohezionit.⁶⁵

Auditi i projekteve vlerëson se projektet për ngritjen e kapaciteteve fokusohen vetëm tek autoritetet qendrore dhe shumë e kufizuar tek institucionet rajonale.⁶⁶ Ky fakt vjen edhe si rezultat i krijimit me vonesë të Agjencive Rajonale të Zhvillimit.⁶⁷ Pavarësisht prioritetëve më imediatë, rëndësia e krijimit të Agjencive Rajonale të Zhvillimit qëndron në faktin se krijimi i tyre sa më shpejt i bën ato operacionale dhe të përgatitura për fondet Strukturore.

Problematikat e Kroacisë janë më afër situatës së Shqipërisë dhe vlen të merren parasysh gjatë hartimit të dokumenteve strategjike. Në veçanti mungesa e kapaciteteve në nivel vendor duhet të adresohet nëpërmjet instrumenteve dhe alternativave të efektshme. Ndërtimi i ekspertizës në nivel vendor kërkon kohë dhe mund të sjellë humbje të fondeve deri në arritjen e nivelit optimal të tyre.

⁶⁵Shih paragrafin 4.18–4.20 të raportit vjetor të Gjykatës për vitin fiskal 2009 (OJ C 303, 9.11.2010, fq. 1). Një nga dy burimet kryesorë të gabimeve është mosrespektimi i rregullave të prokurimit publik ‘*serious failures to respect public procurement rules*’.

⁶⁶European Union, (2011) Has EU assistance Improved Croatia’s Capacity to Manage Post-accession Funding? Special Report No 14, European Court of Auditors. F. 30

⁶⁷Ad Hoc Report No. R/ZZ/SF/0813, 11 February 2009, f.25

Futja e elementit të konkurrencës në nivel sektori dhe shteti në IPA II vë në rrezik jo vetëm sektorët më pak të përgatitur por dhe vendin në tërësi duke rialokuar fondet në shtete të tjera me efektivë në përthithje. Për këtë arsye kapacitete ekzistuese të cilat gëzojnë eksperiencë si FSHZH apo agjenci të tjera publike, duhet të marrin më shumë përgjegjësi e të udhëheqin procesin e përthithjes së fondeve IPA. Gjithashtu përfshirja e sektorit privat (siç shtjellohet në rastin e mëposhtëm në Austri) në zbatimin e IPA-s është një alternativë e mundshme që do të zbusë mangësitë ekzistuese dhe kompensoje kapacitetet e munguara në sektorin publik.

5.3.1.1 Rasti i Austrisë, Burgenlandi

Burgenland është rajoni lindor i Austrisë, dhe ka qenë rajoni më i varfër ndër nëntë landet austriake. Burgenland është shumë i vogël (284.000 banorë) krahasuar me standardet evropiane. Përveç zonë së Eisenstadt (kryeqytetit të Burgenland) dhe distriktit të Mattersburg të cilat kanë një afërsi me infrastrukturën e transportit ndërkombëtar (aeroporti i Vjenës dhe ai i Bratislavës, autostrada Vjenë-Budapest dhe Vjenë-Grac) pjesa tjetër e Burgenland është tejet periferike. Ka karakteristikat e një zonë rurale me një sektor bujqësor të fragmentuar dhe problemet më të mëdha të këtij rajoni kanë qenë mungesa e vendeve të punës, prodhimtari e ulët, mangësi në infrastrukturën moderne të biznesit (p.sh. parqet e biznesit, mungesa e institucioneve të arsimit të lartë dhe lehtësira në kërkim dhe zhvillim) dhe qasje jo e favorshme në dhe brenda rajonit e cila rezultonte në emigracion jashtë rajonit.

Pesë vjet mbas rënies së murit të Berlinit, Burgenland-i u miratua si një zonë nën Objektivin 1 për financim nga fondet rajonale të BE-së. Ky ishte një avantazh i cili bashkoj përpjekjet në nivel politik dhe mobilizoi aktorët në nivel kombëtar dhe rajonal për ta kthyer rajonin e Burgenland-it nga një “zonë e vdekur kufitare” në një “rajon të integruar dinamik të Evropës Qendrore”.⁶⁸ Krahas reduktimit të pabarazisë rajonale dhe ndryshimeve substanciale në nivel mirëqenie me mesataren e BE-së (atëherë 15 vende anëtare) u synuar edhe krijimi i vendeve të punës si dhe një rritje në normat e pjesëmarrjes.

Miratimi i politikës rajonale të BE solli ndryshime të rëndësishme dhe risi edhe në sistemin e qeverisjes në rajonin e Burgenland-it. Për përgatitjen dhe miratimin e politikës së kohezionit të BE-së dhe të financimit për Objektivin 1, Burgenlandi ndërmori një sërë masash të cilat ishin jo vetëm domosdoshmëri për arritjen e objektivave të politikës së kohezionit por edhe asaj rajonale të brendshme:

- Për përgatitjen në financimin e Objektivit 1, u zhvilluan një sërë konceptesh strategjike, përfshirë edhe një program të ri të zhvillimit hapësinor dhe planet zhvillimore sektoriale për turizmin dhe biznesin.
- Ndryshimet institucionale përfshijnë krijimin e dy agjencive: Agjencia e Zhvillimit Ekonomik (EIBAG) dhe Menaxhimit Rajonal të Burgenland-it (RMB). EIBAG është përgjegjës për mbështetjen e zhvillimit financiar, ndërsa RMB është agjenci zhvillimi për Burgenland, të cilat marrin rolin e Autoritetit Menaxhues.
- Procesi i programimit paraqet gjithashtu një risi. U ra dakort në nivel rajonal të Burgenland-it dhe në nivel federal për një program të integruar zhvillimi.
- Qasja financiare për Objektivin 1 kërkonte zhvillim ndër-dikasterial dhe ndër-sektorial. U krijuan mekanizmat e koordinimit midis qeverisë federale dhe rajonit të Burgenland-it, për të mundësuar zhvillimin e strategjive ndërsektoriale dhe përzgjedhjen e projekteve. U vendos koordinimi i agjencive federale dhe shtetërore për përgatitjen dhe zbatimin e programeve dhe përzgjedhja e projekteve
- Zhvillimi i programit strategjik u hartua në kuadrin e Axsendës 2000 dhe përgatitjes për zgjerimin e BE-së në Evropën Lindore.

⁶⁸ Në fillim qeveria federale Austriake nuk ishte entuziaste ndaj synimit të qeverisë së Burgenland-it për tu përfshirë nën Objektivin 1, kjo pasi qeveria federale ndjehej e shqetësuar për reputacionin e Austrisë dhe së dyti mendohej se qeveria federale do të duhej të kontribuonte më pak në se Burgenland-i do të ishte pjesë e Objektivit 2. Lobimi i elitave politike të Burgenland-i pranë Komisionit Evropian si aktor kryesor i fondeve ishte i suksesshëm.

Strategjia e zhvillimit rajonal ishte në thelb një ‘strategji e zhvillimit ekonomik’ dhe fazat e ERDF ishin konsistente në objektivat dhe prioritetet tematike me disa përshtatje në qasjen e politikave për të tre periudhat e programit ERDF. Fillimisht qasja ishte e përqendruar në heqjen e barrierave për industrinë, tregtinë dhe turizmin duke kaluar më pas në një qasje të orientuar drejt risisë/inovacionit. Në linjë edhe me programet operacionale është synuar zhvillimi i (infra)strukturës, ndritja e kapaciteteve dhe bashkëpunimi (netëorking). Një qasje e tre faza është ndjekur përmes (infra) zhvillimit të strukturës, netëorking, dhe zhvillimit të aftësive, sipas Programeve Operative.

Edhe pse aksesimi në Fondet Strukturore dhe në veçanti ato të ERDF zgjeruar ndjeshëm burimet financiare të disponueshme për Burgenland, gjithmonë financimi shtesë kombëtar dhe rajonal ishte në dispozicion në veçanti për shkak të sistemit federal austriak. Prandaj, financimi në programet e BE-së ka qenë i fokusuar në projekte investimesh më të mëdha dhe kapitali-intensiv, ndërsa projekte të vogla (p.sh. në ngritje (start-up) biznesi) janë mbështetur ekskluzivisht nga skemat kombëtare. Në periudhën e dytë dhe të tretë rritja e kompleksitetit të fondeve të BE-së ka çuar gjithnjë e më shumë në një zhvendosje të projekteve me rrezik të lartë në drejtim të financimit të brendshëm (p.sh. për R&D në kompani)

Dokumenti i Vetëm i Programimit (SPD) të ndihmës

Reforma komunitare për fondet strukturore e vitit 1993 përfshin: i) thjeshtëzimin e procesit të programimit ku një shtet anëtar paraqet një Dokument të Vetëm Programimi (Single Programming Document - SPD) i cili bazohet në prioritetet kombëtare dhe rajonale dhe përmban një përshkrim të detajuar të situatës aktuale në rajon (pabarazitë dhe potencialin e zhvillimit), një përshkrim të strategjisë më të përshtatshme për arritjen e objektivave të përcaktuara si dhe të dhëna dhe mënyrën e përdorimit të fondeve; ii) periudha e programimit u bë gjashtë vjet (1994-1999); iii) dhe theksi u vendos në vlerësimin e programit *ex ante* dhe *ex post*.

Përgatitjet e Burgenland për **Dokumentin e Vetëm Programor** (Single Programming Document - SPD) u bazuan në “konceptin rajonal ekonomik” (*Regionalwirtschaftliche Konzepte*) i cili ishte hartuar që prej vitit 1991 në përputhje me rekomandimin e ÖROK (Austrian Conference for Regional Planning) të cilat theksonin nevojat dhe zhvillimet specifike të secilit rajon/lander si dhe vunë shtyllat kryesore të adresimit të mjeteve financiare. Koncepti ekonomik i Burgenland-it përqendrohej kryesisht në ‘Projekte Drejtuese - lead project’, risitë në shumë fusha të cilat do të mund të inkurajonin investimet e mëtejshme private. Kjo strategji u mor si bazë për programimin e programit të Objektivit 1.

Në korrik 1994 qeveria e Burgenland-it ra dakord në temat prioritare të financimit si dhe akset e zhvillimit që duhet të ndiqte politika e zhvillimit rajonal të ishin të bazuara në dallimet strukturore të rajonit. Qëllimi politik ishte për të përpunuar një “program të madh i cili të mund të sillte një ndryshim të konsiderueshëm në zhvillimin ekonomik të landit dhe ta kthente atë në një ‘rajon me jetë’ (*zum Land Leben*). Në bazë të këtij vendimi, drafti i parë u redaktuar nga një grup i vogël zyrtarësh të lartë të administratës së Burgenland-it, nën-ndësit e saj ishin “zyra evropiane dhe statistikat” (*Stabstelle Europabüro und Statistik*), Shërbimi Ekonomik i Burgenlandit AG (*Wirtschaftsservice Burgenland AG, WIBAG*) dhe drejtori i organizatës së turizmit të Burgenlandit. Më 20 dhjetor 1994 drafti iu dorëzuar qeverisë federale për të negociuar planin indikativ/tregues të financimit (buxheti i cili do të bashkë-financohej nga Landi dhe qeveria Federale). Pasi qeveria federale dhe e Burgenlandit rënë dakord për SDP-në ajo u dorëzua te Komisioni Evropian më 26 prill për tu vlerësuar nga ekspertë të pavarur të kontraktuar nga *DG Regio*. Kritikën kryesore të komisionit kishin të bënin kryesisht me ndryshimet rrënjësore në lidhje me prioritetet e vendosura në draftin

fillestar, proporcioni i alokimit të fondeve (shumica e projekteve ishin nën ERDF dhe vetëm 14% të alokuara për burimet njerëzore), Shërbimi i Tregut të Punës, që kishte kryesuar grupin e punës në sektorin e punësimit ishte injoruar ndaj komisioni kërkoj rritjen në 16%. Pas modifikimeve të fundit, strategjia e ndërhyrjes për programin e Objektivit 1 të rajonit të Burgenland-it ishte më e mira e përgatitur në të gjithë Austrinë. SPD e Burgenland-it u miratua më 16 nëntor 1995, 70% e SPD Burgenland sponsorizohej nga ERDF-ja, 14% nga EAGG dhe 16% nga ESF.

Për sa i përket përmbajtjes, periudha e parë e programimit SPD identifikoi dobësitë strukturore: 1) agrikultura: prodhimi i fragmentuar, punësi i pjesshëm part-time, marketing apo përpunim i pazhvilluar, lojë-skill aftësi/kompetenca të ulëta, rritje e konkurrencës nga vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore; 2) sektori i ndërtimit dhe industria e tekstilit: humbje e vendeve të punës sidomos në industrinë e tekstileve; 3) në fushën e shërbimeve, Burgenlandi kishte mangësi të mëdha strukturore në sektorin e turizmit sidomos për shkak të kapaciteteve të vogla të ndërmarrjeve, mesatarisht me 33 shtretër; 4) tregu i punës karakterizohej një shkallë e ulët e kualifikimit të fuqisë punëtore.

Për këtë, SDP-ja e vitit 1995 adresoj në strategji:

- Krijimin e një rajoni të Evropës-qendrore me një zhvillim të fortë dinamik në fushat e industrisë, tregtisë, turizmit dhe bujqësisë.
- Reduktimin e pabarazisë ekonomike dhe sigurimin e një standardi jetese homogjen në të gjithë rajonin e Burgenlandit

Këto synime u detajuan më tej në prioritete dhe masat konkrete si dhe indikatorë të matshëm.

Menaxhimi i Fondeve Strukturore në Austri

Përpara aderimit të Austrisë në BE ka patur një debat intensiv mbi nevojën e përshtatjes të modelit ekzistues kombëtar të politikës rajonale austriake (të ashtu-quajtur “politika e planifikimit të bashkëpunimit hapësinor) me sistemin e Fondeve Strukturore të BE-së. Me pranimin e Austrisë në BE, qeveria federale dhe ajo e Landeve ranë dakord që zbatimi i programeve të reja të Fondeve Strukturore Programeve të bëhej në bazë të instrumenteve dhe strukturave ekzistuese kombëtar të ngritura për politikën strukturore/rajonale, politikën e tregut të punës dhe politikën bujqësore.

Një document i përgatitur nga zyrtarë të Kancelarisë Federale numëron më shumë se 100 njësi administrative në nivel Evropian dhe kombëtar të përfshira në procesin e zbatimit dhe 26 organe të ndryshme monitorimit janë ngritur për 32 dokumentet e programimit rajonal të miratuara në periudhën e programimit 1995-1999.

I gjithë procesi i zbatimit të Fondeve Strukturore të BE në Austri ishte kompleks. Kjo strukturë e përgjithshme shumë komplekse e përgjegjësi administrative karakterizohet nga dy tipare të përbashkëta (shih tabelën më poshtë)


- së pari, përgjegjësia e përgjithshme financiare dhe administrative për secilin nga tre Fondet Strukturore të BE-së i atribuohet **një Ministrie Federale të veçantë** (*fondskorrespondierendes Ministria*) e cila ka përgjegjësis buxhetore vis - à - vis Ministrisë Federale të Financave dhe Bashkimit Evropian.
- së dyti, për shkak të natyrës së veçantë të ndërhyrjeve të Fondeve Strukturore dhe shpërndarjes Federale të kompetencave në Austri, **kordinimi** në lidhje me programet është kryer ose nga **Ministria për fondin-përkatës në bashkëpunim me Landerin-përkatës** (objektivi 1, 2, 5b) ose vetëm nga ministria për fondin-përkatës (rasti i objektivit 3,4 dhe 5a)

Tabela 24: Menaxhimi i fondeve strukturore të BE-së në Austri

Objektivat	Institucionet përgjegjëse për administrimin e fondeve strukturore të BE-së (Ministria për Fondin Përkates)			Koordinimi i programeve
	Kancelaria Federale (BKA)	Ministria Federale e Bujqësisë (BMLF)	Ministria Federale e Punësimit (BMAGS)	
Objektivi 1	BKA	BMLF	BMAGS	Qeveria e Landit/ Kancelaria Federale
Objektivi 2	BKA		BMAGS	Qeveria e Landit/ Kancelaria Federale
Objektivi 3			BMAGS	Ministria Federale e Punësimit (BMAGS)
Objektivi 4			BMAGS	Ministria Federale e Punësimit (BMAGS)
Objektivi 5a		BMLF		Ministria Federale e Bujqësisë (BMLF)
Objektivi 5b	BKA	BMLF	BMAGS	Qeveria e Landit/ Kancelaria Federale
Fondi Strukturor	ERDF	EAGGF	ESF	

Figura 30 Skema e Menaxhimit të Fondeve Strukturore të BE-së

Detyra	Kordinimi	Programet	Monitorimi dhe Kontrolli financiar
Niveli			



Për shkak të strukturës së Shtetit Federal, përgjegjësitë në fushën e politikës së brendshme të zhvillimit rajonal janë ndarë midis qeverisë kombëtare, Landit dhe autoriteteve lokale. Para aderimit në Bashkimin Evropian, u vendos një bashkëpunim intensive në fushën e politikës rajonale midis të tri niveleve të Qeverisjes. Qeveritë e Landeve përgatitën strategjitë ekonomike, program të politikës së zhvillimit hapësinor dhe plane zhvillimi nën-rajonale në bashkëpunim me organizata specifike të zhvillimit rajonal (Regional managements). Kancelaria Federale (Bundeskanzleramt, BKA) me ndihmën e ‘Konferencës austriake për planifikim hapësinor’ (Österreichische Raumordnungskonferenz, ÖROK) koordinon politikat në nivele të ndryshme, një platformë për bashkëpunim reciprok, e cila mbledh së bashku përfaqësues nga autoritetet e të gjitha niveleve dhe partnerët socialë.

Mobilizimi i mjeteve financiare për politikën Austriake të zhvillimit rajonal dhe detyrat për të menaxhuar këto fonde është shpërndarë midis nivelit federal dhe Lëndit. Për të bashkërenduar përdorimin e mjeteve financiare në këtë sistem kompleks, janë vendosur kontakte intensive midis departamenteve të ndryshme të financimit në nivel federal dhe në atë të Landit.

Forma jo-formale:

ÖROK - ‘Konferenca austriake për planifikim hapësinor’ (Österreichische Raumordnungskonferenz): bashkërendimin e çështjeve të politikës rajonale të BE-së me politika kombëtare rajonale.

Platformë koordinimi dhe sekretariat i përbashkët për MCs

Në nivel politik: Konferencë

Në nivel administrative: Komitete / dhe grupe pune

Procesi i partneritetit vertikal

Komisioni Evropian - Kancelaria Federale - Landit

Transferimi i Informacionit në lidhje me çështje të politikës rajonale të BE-së dhe dialogu me Komisionin Evropian mbahet nga Kancelaria Federale

Kancelaria Federale: detyrën e koordinimit (platformë informacioni, bashkërendimi dhe negociatave) midis Komisionit dhe Landit në procesin vertikal të partneritetit

Komitetet Monitoruese (MCs): mbikëqyrje e vazhdueshme e zbatimit të programeve

Ndihmohen nga “Njësitë e koordinimit” në nivel Landi

Kancelaria Federale dhe "Ministritë e Fondet - përkatëse" (përsa i përket zbatimit financiar)

Një sekretariat i përbashkët i MCs është vendosur në zyrat e ÖROK

ÖROK nën-komisioni për Ekonomi Rajonale (ÖROK-Unterausschuß Regionalwirtschaft): koordinon MCs e Programeve (Programm-Begleitausschüsse) (në nivel Landi për secilin Objektivi) informohen nga ÖROK për rregullat e zbatimit në lidhje me monitorimin financiar, procedurat e vlerësimit, publikimit, administrimit të fondeve për asistencës teknike, etj. “Takime të përbashkëta” (Gemeinsame Sitzungen) të MCs të Programeve për çdo objektiv janë të planifikuara.

Ministritë përgjegjëse-të-fondeve: Koordinimi Vertical midis të tre Fondeve Strukturore dhe përfituesve finalë

Kancelaria Federale (BKA) përgjegjës për financimin ERDF

Ministrinë Federale e Punës, Shëndetit dhe Çështjeve Sociale (BMAGS) për ESF;

Ministria Federale e Bujqësisë dhe Pyjeve (BMLF) për EAGGF

Ministritë përgjegjëse-të-fondeve mbledhin raporte të rregullta mbi zbatimin e programit, të hartuar nga agjencitë financuese në nivel Federale ose Landi. Ato hartojnë raporte agregate në lidhje me nivelin e zbatimit të programit për Fondin strukturor përkatës. Këto raporte pastaj shërbejnë Komitetin Monitorues MCs dhe ‘zyrës së koordinimit të Programit’ si një burim i plotë dhe i azhurnuar informacioni.

Koordinimi për çështje financiare bëhet në procedurës së bashkëpunimit vertikal.

Koordinimi për çështjet që kanë të bëjnë me përzgjedhjen e projektit dhe financimin e projektit në nivel masash të caktuar të programit bëhet midis aktorëve publikë dhe privatë (autoriteteve Federale ose Landit, partnerëve privatë) kryesisht nëpërmjet ‘kontakteve joformale’. disa ‘komisione vlerësimi’ në kuadër të programeve të Ministrisë Federale të Ekonomisë Publike dhe Transportit (RIP dhe RIF program) janë përdorur, megjithatë praktika austriakë nuk e ka parashikuar krijimin e organeve të reja formale koordinuese për përzgjedhjen e projekteve.

Qeveria lokale e Burgenland-it i bëri thirrje organizatave lokale, SME-ve dhe grupeve të interesit që ‘kushdo që kishte ide për projekte të cilat mund të financoheshin nën Objektivin 1 të dorëzonin


propozimet e tyre'. Paralelisht u ngritën 7 grupe pune, kryesisht të përbërë nga zyrtarë të lartë të Landit, akademikë/specialistë të WIFO, të cilët do të elaboronin/përpunonin masat e projektit. Partnerët socialë ishin të përfshirë vetëm nëpërmjet mekanizmit të konsultimit.

Figura 31 Përgjegjësitë jo-formale të menaxhimit të Fondeve Strukturore të BE-së



Figura 32 Struktura formale e menaxhimit të Fondeve Strukturore të BE-së

Komisioni Evropian



Strukturat zbatuese për masat e ERDF-së të Objektivit 1 në Burgenland Në nivel landi:

Njësitë administrative të Landeve në Austri kryejnë në të njëjtën kohë edhe administrimin e kompetencave kombëtare (*Mittelbaren Sistemi der Bundesverwaltung* - Sistem administrimi i tërthortë).

Në administratën e Burgenland, nuk u krijua asnjë departament i veçantë i cili do të duhej të merrej me zbatimin e fondeve të ardhshëm të BE-së. Landi preferoj të ristrukturonte strukturat ekzistuese administrative dhe organizative si dhe të adoptonte numrin dhe kualifikimet e stafit të këtyre strukturave. Organizimi i menaxhimit të financimit varionte/ndryshonte në varësi të llojit të Fondeve Strukturore. Për të gjitha detyrat të cilat nuk iu deleguan palëve të treta ka qënë përgjegjësi e njësitë administrative brenda administratës së Landit të cilat u përfshinë në përzgjedhjen e projekteve dhe procesin e miratimit, në mobilizimin për mbështetje financiare dhe në kontrollin e ecurisë së projekteve respektive.

Megjithatë brenda administratës së Burgenlandit u krijua një njësi e veçantë e quajtur “Zyra Evropiane dhe e statistikave” (Stabsstelle Europabüro und Statistik) e cila kishte për detyrë të siguronë një koordinim të përgjithshëm midis aktorëve të ndryshëm të përfshirë në administrimin e programit të Objektivit 1.

Zyra Evropiane dhe e statistikave” (Stabsstelle Europabüro und Statistik). Kjo njësi ishte përfshirë plotësisht në përgatitjen e dokumentit të programit të Objektivit 1. Dhe ishte përgjegjëse për raportimin në nivelet federale dhe evropiane, për hartimin e raporteve vjetore mbi progresin e zbatimit të programit, për mbikëqyrjen e respektimit të rregullave të përcaktuara në dokumentin e programit, për përpunimin e tabelave aktuale financiare dhe për zbatimin e asistencës teknike. Së fundi, ajo siguroi informacion të brendshëm dhe trajnimin për departamentet e tjera të ngjashme të qeverisë së Landit.

Krahasuar me situatën mjaft komplekse në rajonet/landet e tjera austriake, shkalla e fragmentimit në Burgenland ishte e kufizuar për sa i përket instrumenteve të financimit të përfshira në zbatimin e masave të ERDF-së të Objektivit 1. Arsyeja kryesore ishte se Burgenlandi kishte vendosur për të ri-organizuar instrumentet e veta të financimit rajonale duke krijuar një aktor të vetme (**Shërbimin Ekonomik AG të Burgenlandit - WIBAG**)⁶⁹ Në kuadër të ndërhyrjeve të ERDF për programin e Objektivit 1 (1995-1999), WIBAG ishte e ngarkuar me zbatimin masave mbështetëse për çështjet e ekonomisë dhe turizmit bazuar në dy kontratat e kujdestarisë në korrik 1994 dhe shkurt 1995. WIBAG ngriti dy ‘Komisione vlerësimi’ (Beurteilungskommissionen), një për çështjet ekonomike dhe një për turizmin. Detyrat e të cilave ishin të miratonin projektet e paraqitura dhe të organizonin likuiditetin e tyre. Prandaj WIBAG ishte përgjegjës i përgjithshëm për vlerësimin fillestar të projekteve, vendim-marrësi mbi normën e bashkë-financimit, pagesave të pretenduara dhe atyre aktuale, kontrollin periodik të projekteve, kontrollin përfundimtar të projekteve individuale si dhe kontrollin e një përdorim adekuat të financimeve.

Aktorët e tjerë të përfshirë në menaxhimin e Objektivit 1, kryesisht kanë qënë struktura të ndryshme këshillimore të cila siguronin mbështetje të njësitë të ndryshme administrative brenda Burgenland dhe asistencë teknike për aplikantët e projektit.

⁶⁹ Bazuar në ligjin e Landeve mbi zhvillimin ekonomik (Landes-Öirtschaftsfördergesetz, WiföG), dy ndërmarrjet publike aktive në fushën e zhvillimit ekonomik u shkrinë në një të vetme (në korrik 1994) të quajtur *Shërbimi Ekonomik AG i Burgenlandit* – ‘Öirtschaftsservice Burgenland AG’, WIBAG. Sipas ligjit mbi zhvillimin ekonomik të landit, WIBAG u ngarkua të kujdesej në zbatimin e masave të veçanta mbështetëse të tilla si vlerësimin fillestar, zbatimin apo kontrollin e subvencioneve jo të rimbursueshme si dhe në mbulimin e kolateralit.

Më i rëndësishmi i këtyre strukturave këshillimore është ‘Menaxhimi Rajonal Burgenlandit’ (**Regionalmanagement Burgenland GesmbH, RMB**) i cili ka përfituar mbështetje financiare nga buxheti i ndihmës teknike 1995 – 1999, për të gjitha aktivitetet e veta. Si të gjitha axhensitë e tjera të menaxhimit rajonale në Austria, detyrat e përgjithshme të RMB-së ishin lehtësimi i kontakteve midis promovuesve të projekteve dhe autoriteteve kompetente të administrimit të financimeve, sigurimi i mbështetjes teknike për projektet (për shembull orientimet e para lidhur me projektin, ndihmesa për të gjetur këshilla tepër specifike, orientimi i aktorëve në lidhje me strukturat administrative të financimit, zgjidhja e konflikteve). Aktivitete të tjera të RMB ishin përqendruar në sigurimin e informacionit dhe publicitetin e popullsisë së Burgenland, organizimin e ngjarjeve specifike dhe ofrimin e ndihmës për SME-të.

Në maj të vitit 2000, një zyrë shtesë e RMB-së u hap në pjesën jugore të Burgenland (në qendrën e teknologjisë Pinkafeld). Detyra kryesore e kësaj zyre të re të RMB është të sigurojë informacion mbi Evropën dhe këshillim për mundësitë e mbështetjes, të menaxhojë rezervat natyrore, të japi këshilla mbi zhvillimin e projekteve dhe të bashkërendisë projektet. Përveç kësaj, RMB-së iu besuar menaxhimi i procesit të rishikimit të programit të ri të Objektivit 1 2000-2006. ,224

Në janar të vitit 1997, RMB punësoi një person të veçantë për këshillim rreth ESF.

Brenda Burgenland, RMB është duke vepruar si njësi e brendshme e rajonit në monitorimin e ERDF-së. Njësia RMB e monitorimit kryen elaborimin dhe aktualizimin e të dhënave të projekteve në nivel rajonal/landi dhe për sistemin e monitorimit në nivel Federal për llogari të fondit ERP. Të dhënat e pagesave të departamentit rajonal/landerit për financa dhe llogaridhënies (departamenti III) mblidhen në bazë mujore dhe të dhëna të tjera projektsh të lidhura me rajonin/landin mblidhen normalisht në cdo 3-muaj. Në lidhje me projektet-WiBAG, monitorimi aktualisht kryej në bazë ditore, ditë për ditë. Gjatë takimit të 4-të të MCs në dhjetor të vitit 1997, u vendos që sistemi i monitorimit i RMB-së, në bazë të një projekti pilot, të mblidhte informacion edhe për tregues të tjera (p.sh. investimet e huaja direkte, vlerësimi specifik gjinor i punësimit të krijuar në fillim dhe në fund të një projekti, Natyrën inovative të projektit).

Të dhënat e paraqitura në raportet e progresit nga RMB mbulonin kryesisht dimensionin financiar të programit (të dhëna të agreguar për angazhimin dhe normat e pagesës për Fondet dhe nivelin e masave), por edhe një përmbledhje të arritjeve kryesore materiale (të dhëna të agreguara shumë të përgjithshme për vendet e reja të punës të krijuar dhe ato ekzistuese të ruajtura; në numrin e ndërmarrjeve të mbështetura ose në shtretërit e rinj të shtuar etj).

Vlerësimi i WiBAG dhe RMB në menaxhimin e fondeve të BE-së

RMB

Një nga faktorët kryesore mbi: i) efektivitetin e zbatimit të programeve ishte edhe sistem i mirë i strukturave mbështetëse teknike (RMB); ii) kapacitetit për të menaxhuar programin, ishte mbështetja e vlefshme nga njësitë e ndihmës, si RMB

Vlerësimi: Ka patur përmirësime. Aktivitete pilot lidhur me zgjerimin e të dhënave të monitorimit që do të mblidheshin nga RMB.⁷⁰

WiBAG

Një nga aspektet më të rëndësishme që ndikuan pozitivisht ose negativisht në një zbatim efektive të ndërhyrjeve-ERDF ishte: Strategjia për tu mbështetur mbi strukturat ekzistuese të mbështetjes dhe

⁷⁰ Stumm T, 2002, ” Ex-Post evaluation of Objective 1, 1994-1999 – National Report Austria” , fq. 130

financimit në Austria me siguri mund të konsiderohet si një aspekt shumë pozitiv në fillim. Në rastin e Burgenlandit, krijimi i një instrumenti të vetëm mbështetës për zhvillimin ekonomik (WiBAG) ishte sigurisht një avantazh shtesë, edhe pse aktorët rajonalë duhet të ambientoheshin me përdorimin e metodave të reja të ndërhyrjes në kuadër të fondeve strukturore.⁷¹

Zbatimi. U zhvilluan përmirësime jo të rëndësishme në strukturat formale të zbatimit në nivel federal, kryesisht për shkak të ndarjes formale të kompetencave të përfshira në kushtetutën Federale. Strukturat e zbatimit në nivel të Landi janë tashmë shumë të përqendruar (p.sh. EIBAG si aktori i vetëm dhe komitet bashkërendimi për fonde specifike).

Së fundmi, nisur nga nevoja e reformave strukturore në administratë si masa për të kapërcyer krizën, Landi i Burgenland-it po shqyrton shkrirjen në një të WIBAG-së dhe RMB-së. Deri në vitin 2015 Burgenland duhet përsëri të ketë një buxhet të balancuar - e cila është vendosur në mbledhjen e qeverisë vitin 2011.

⁷¹ Intervistë me Kancelarinë Federale (BKA).Stumm T, 2002, " Ex-Post evaluation of Obejctive 1, 1994-1999 – National Report Austria", fq. 76

